

“Botimi i këtij dokumenti është përgatitur me përkrahje të Bashkimit Evropian. Ky dokument është hartuar në kuadër të Projektit të Binjakëzimit në arsim dhe përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e hartuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”

Udhërrëfytyesi për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen për sistemin arsimor parauniversitar në Kosovë

Programi i Binjakëzimit për mbështetjen e zbatimit të Planit
Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011 – 2016 (Binjakëzimi
Nr. KS 11 IB OT 02)



Përmbajtja

SHKURTESAT

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Hyrje.....	8
2. Qëllimet e udhërrëfyesit.....	11
3. Diversiteti dhe gjithëpërfshirja në arsim.....	12
4. Zhvillimi i sistemit të arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë.....	14
4.1. Korniza ligjore për zhvillimin e sistemit të arsimit gjithëpërfshirës në Republikën e Kosovës.....	15
4.2. Regjistrimi në nivele të ndryshme në arsimin parauniversitar të Kosovës në vitin 2013 -2014 dhe 2014 -2015.....	21
4.3. Nivelet e arsimit që kanë nevojë për vëmendje të veçantë.....	29
4.4. Sistemet mbështetëse për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës.....	37
4.4.1. Struktura dhe funksionimi i shërbimeve mbështetëse për nxënësit me NVA në sistemin arsimor në Kosovë.....	38
4.4.2. Mbështetje për nxënësit e komuniteteve pakicë.....	58
4.4.3. Parandalimi i braktisjes së shkollës dhe fëmijët jashtë shkollës.....	72
4.4.4. Promovimi i barazisë gjinore në arsim.....	76
4.5. Trajnimi i mësimdhënësve.....	82
5. Sfidat me të cilat ballafaqohen shkollat e Kosovës në zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës.....	86
6. Rekomandime të kombinuara.....	93
Shtojca 1 Konceptet themelore.....	105
Shtojca 2 Traktatet dhe deklaratat ndërkombëtare të njohura nga Republika e Kosovës.....	107
Shtojca 3 Udhëzimet Administrative për arsimin gjithëpërfshirës dhe me nevoja të veçanta.....	112
Shtojca 4 Projektet për zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë.....	128
Shtojca 5 Standardet për shkollat mike për fëmijët në Kosovë.....	129
Shtojca 6 Indeksi për gjithëpërfshirjen në Kosovë.....	131
Shtojca 7 Detyrat e zyrtarëve të DKA-ve, mësimdhënësve, mësimdhënësve mbështetës, edukatorëve mbështetës, asistentëve dhe instruktorëve të shkollave për arsim gjithëpërfshirës.....	132
Shtojca 8 Ligjet kryesore përkatëse për ofrimin e arsimit për pakicat, përfshirë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që përvijojnë obligimet ligjore për zyrtarët komunal.....	135
Shtojca 9 Institucionet qendrore dhe vendore që janë përgjegjëse për arsimimin e pakicave në Kosovë.....	138
Shtojca 10 Nevojat për trajnim në arsimin gjithëpërfshirës.....	143



Shkurtesat

ABGj	Agjencia për Barazi Gjinore
ZKQMDNj	Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore
PVGTP	Plani i Veprimit i Grupit Teknik Punues për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
BSFK	Balkan Sunflowers Kosova
AKIGjSh	Program Trajnues për Asistentët në Klasë dhe Instruktorët e Gjuhës së Shenjave
PATH	Programi për Arsim Themelor
KK	Këshilli i Komuniteteve
KKK	Këshilli Konsultativ i Komuniteteve
ShMF	Shkolla Mike për Fëmijë
QK	Qendrat e Kompetencave
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KDIK	Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve
OShC	Organizatata e Shoqërisë Civile
DPEP	Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar
DAVN	Divizioni për Arsim me Nevoja të Veçanta
QEÇMK	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë
VLKH	Vlerësimi i Leximit në Klasë të Hershme
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
BE	Bashkimi Evropian
FSDEK	Programi Finlandez për Mbështetje të Sektorit të Arsimit në Kosovë
FSIESK	Programi Finlandez për Mbështetje të Sistemit të Arsimit Gjithëpërf shirës në Kosovë
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH)
AL	Arsimi i Lartë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
KDNIISC	Këshilli Drejtues Ndërinstitucional për Zbatimin e Planit të Veprimit
TI	Teknologjia e Informacionit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AKPAGj	Asociacioni Kosovar për Promovimin e Arsimit Gjithëpërfshirës
PZhAK	Programi për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
FKShH	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
QAK	Qendra për Arsim në Kosovë
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
QM	Qendra Mësimore
KK	Kuvendi Komunal
PKV	Plani Komunal i Veprimit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Jo-qeveritare



ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
OBEZh	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
ZK	Zyra e Kryeministrit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mos-regjistrimit
PZhSh	Plani Zhvillimor i Shkollës
NVA	Nevoja të Veçanta Arsimore
KDSh	Këshilli Drejtues i Shkollës
DShEGj	Drejt Shkollës Efektive për të Gjithë
TT	Trajnimi i Trajnerëve
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional



Përmbledhje Ekzekutive

Programi i Binjakëzimit për mbështetjen e zbatimit të Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011 - 2016 (Shtojca 3), financuar nga Bashkimi Evropian dhe implementuar nga Omnia, Autoriteti i Përbashkët i Arsimit në Rajonin e Espoo-s në Finlandë, në partneritet me KulturKontakt Austria të Austrisë, ka filluar në mars të vitit 2014. Qëllimi i përgjithshëm i programit është rritja e cilësisë së arsimit parauniversitar në Kosovë, inkurajimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe nxitja e diversitetit kulturor, dialogut dhe bashkëpunimit. Qëllimi i programit është të përmirësojë cilësinë dhe rëndësinë e arsimit nëpërmjet zbatimit të Kornizës së re të Kurrikulës së Kosovës (KKK), ngritjes së kapaciteteve të edukatorëve, implementimit të masave për sigurimin e cilësisë në arsim dhe mbështetjes për sigurimin e pajisjeve përkatëse shkollore të dorëzuara dhe të instaluar në shkolla në mënyrë korrekte.

Gjithëpërfshirja është një nga parimet kryesore të Kornizës së re të Kurrikulës së Kosovës. Udhërrëfyeni për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në arsimin parauniversitar në Kosovë është njëri nga aktivitetet e Programit të Binjakëzimit në mbështetjen e zbatimit të KKK-së. Udhërrëfyeni e konsideron gjithëpërfshirjen si ofrim të arsimit për të gjithë fëmijët në shkollat e tyre fqinje dhe mjedise të njëjta mësimore dhe gatishmëri për të përmbushur dhe për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme të nxënësve në klasë.

Qëllimet e udhërrëfyesit janë: 1) të analizojë se si korniza ligjore dhe strukturat mbështetëse, të ndërhuara për arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë, janë duke funksionuar; 2) të ofrojë një pasqyrë të gjendjes së fëmijëve me nevoja të ndryshme në sistemin arsimor aktual në Kosovë; 3) të analizojë sfidat me të cilat shkollat e zakonshme përballen në zhvillimin



e një shkolle gjithëpërfshirëse; 4) të nxjerrë në pah fushat që kanë nevojë për vëmendje të veçantë në promovimin e arsimit gjithëpërfshirës; 5) të ofrojë rekomandime se si të vazhdohet në zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës; dhe të ofrojë udhëzime për shkollat dhe mësimdhënësit se si të fillojnë zhvillimin e shkollës dhe klasave të tyre për t'u bërë gjithëpërfshirëse.

Udhërrëfyesi fokusohet në arsimin parauniversitar, nga arsimi parashkollor deri te arsimi i mesëm i lartë. Kosova ka treguar vullnet dhe përkushtim të madh për zhvillimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës që ofron arsim cilësor për të gjithë qytetarët. Kjo është treguar gjatë dhjetë viteve të fundit, kur është zhvilluar kuadri ligjor për sistemin e arsimit. Si rezultat i kësaj, ka shumë ligje që aspirojnë, udhëzime administrative dhe strategji kombëtare që ofrojnë strukturën për sistemin e ri arsimor. Pavarësisht këtyre përpjekjeve pozitive, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe fëmijët e familjeve me prejardhje të varfër socio-ekonomike kanë mbetur grupet më të rrezikuara për segregacion, braktisje, madje edhe përjashtim. Udhërrëfyesi analizon se si sistemi i arsimit në Kosovë është duke iu përgjigjur këtyre nevojave të ndryshme.

Procesi drejt gjithëpërfshirjes në arsim ka qenë dhe është kërkuar për të gjitha palët e të dy niveleve, atij qendror dhe lokal. Niveli qendror ka krijuar një kornizë me cilësi të lartë për arsimin, dhe komunave u është dhënë autoriteti për të zbatuar ligjet e reja, udhëzimet administrative dhe strategjitë me planet e veprimit. Sfida kryesore në nivel qendror duket të jetë mungesa e komunikimit ndërmjet divizioneve të ndryshme në MASHT dhe në mes të ministrive të tjera. Me qëllim të krijimit të arsimit dhe shoqërisë gjithëpërfshirëse, komunikimi midis sektorëve të ndryshëm është i nevojshëm. Komunitetet kanë përgjegjësi të formojnë trupa punues në kuadër të DKA-ve, grupe punuese për përgatitjen e veprimeve dhe shumë plane të tjera. Sfidat me të cilat përballen komunitetet janë të lidhura me mungesën e financave dhe burimeve njerëzore për zbatimin e kësaj politike.

Gjatë 15 vjetëve të fundit, ka pasur pilot projekte të ndryshme (Shtojca 3) në Kosovë nga donatorë dhe organizata të ndryshme për të përmirësuar cilësinë e sistemit arsimor, dhe si rezultat, ka shumë praktika të mira të mësuara, mjete, instrumente dhe materiale të prodhuara për përdorim në sistemin e arsimit. Megjithatë, duket se shumë prej aktiviteteve të projekteve të ndryshme nuk e kanë qëndrueshmërinë pas përfundimit të tyre. MASHT-i duhet të forcojë koordinimin dhe vlerësimin e projekteve në mënyrë që përvojat më të mira të vihen në praktikë.

Angazhimi i të gjithë stafit të shkollës dhe anëtarëve të komunitetit në mirëpritjen e të gjithë fëmijëve në shkollë është shumë i rëndësishëm. Mësimdhënësi në klasë është personi më i rëndësishëm për të bërë punë në arsimin gjithëpërfshirës. Njohuritë, aftësitë dhe veçanërisht qëndrimet e mësimdhënësve tregojnë se sa i suksesshëm do të jetë zbatimi i politikës në nivelin bazë. Mësimdhënësit duhet të jenë të trajnuar dhe ata kanë nevojë për gjithë mbështetjen e drejtorisë së shkollës dhe të anëtarëve të komunitetit.

Udhërrëfyesi përmban shumë informacione nga burime të ndryshme dhe referenca që lidhen me zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë gjatë 15 viteve të fundit. Prandaj, ky dokument shërben si material burimor për programet e trajnimit që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë.



1. Hyrje

Ky udhërrëfyes është një nga rezultatet e Programit të Binjakëzimit për mbështetjen e zbatimit të Planit Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë 2011 - 2016 (Binjakëzimi Nr. KS 11 IB OT 02). Projekti trevjeçar ka filluar në mars të vitit 2014 dhe është i financuar nga Bashkimi Evropian. Objektivi i përgjithshëm i programit është rritja e cilësisë së arsimit parauniversitar në Kosovë, inkurajimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe promovimi i diversitetit kulturor, dialogut dhe bashkëpunimit. Qëllimi i programit është të përmirësojë cilësinë dhe rëndësinë e arsimit nëpërmjet zbatimit të kurrikulës së re dhe të modernizuar (KKK) që filloi në vitin 2011, ndërtimin e kapaciteteve të edukatorëve, zbatimin e masave për sigurimin e cilësisë në arsim dhe mbështetjen për sigurimin e pajisjeve relevante shkollore, duke përfshirë dërgimin dhe instalimin e tyre në mënyrë të duhur. Komponentët e programit janë si më poshtë:

Komponenti 1: Zhvillimi i kurrikulës dhe zbatimi i saj në klasë

Komponenti 2: Sigurimi i cilësisë në arsim

Komponenti 3: Pajisjet shkollore

Kuadri strategjik "Arsimi dhe Trajnimi 2020" (ET 2020) i Komisionit Evropian parashikon objektiva strategjike për bashkëpunimin evropian në arsim dhe trajnim. Një nga objektivat e ET 2020 është promovimi i barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive. Politika arsimore dhe aftësuese duhet t'u mundësojë të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga rrethanat e tyre personale, sociale apo ekonomike, të fitojnë dhe të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për punësim dhe të nxisin të mësuarit e mëtejshëm, qytetarinë aktive dhe dialogun ndërkulturor. Sistemet e arsimit dhe aftësimit duhet të



synojnë që të gjithë nxënësit, përfshirë edhe ata me prejardhje të pafavorshme, ata me nevoja të veçanta dhe imigrantët, ta përfundojnë arsimimin e tyre dhe, për t'i adresuar pabarazitë, të jenë sisteme arsimore më efikase, por në të njëjtën kohë më gjithëpërfshirëse dhe të barabarta, të cilat ofrojnë qasje në arsimim të cilësisë së nevojshme. (Komisioni Evropian.)

Sipas Komisionit Evropian, pavarësisht faktit se politikat e arsimit dhe aftësimin duhet t'u mundësojnë të gjithë qytetarëve të përfitojnë nga arsimi cilësor, pabarazitë vazhdojnë në sistemet arsimore evropiane. Ekzistojnë dallime të mëdha midis vendeve në shkallën në të cilën ndikon prejardhja familjare në rezultatet e të nxënësve. Nxënësit me prejardhje të varfër socio-ekonomike kanë performancë më të dobët në shkollë se sa moshatarët e tyre në të gjitha vendet e BE-së. Fëmijët nga familjet e imigrantëve, fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe fëmijët rom janë ndër grupet më të prekura. (Komisioni Evropian.)

Sfidat me të cilat Kosova përballlet janë veçanërisht ato në ofrimin e arsimit cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, dhe fëmijët me prejardhje nga familjet e varfra socio-ekonomike. Me gjithë përpjekjet e bëra nga Qeveria e Kosovës në përgatitjen e infrastrukturës ligjore për të siguruar arsim cilësor për të gjithë, këto grupe kanë mbetur më të rrezikuara për segregacion, performancë të dobët, ndjekje të ulët dhe të parregullt të shkollës, braktisje, madje edhe përjashtim.

Kosova është e përkushtuar për zhvillimin e sistemit të arsimit gjithëpërfshirës i cili është përcaktuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016. Një nga parimet kryesore të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (2011) është gjithëpërfshirja e cila "i referohet të drejtës së çdo fëmije të ketë qasje të barabartë në arsim cilësor".

Ky dokument përshkruan situatën aktuale në lidhje me zhvillimin e gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor në Kosovë. Ai analizon kornizën e politikave për arsimin gjithëpërfshirës, strukturat ekzistuese për funksionimin e shërbimeve mbështetëse në sistemin arsimor. Dokumenti përshkruan sfidat me të cilat përballen shkollat dhe mësimdhënësit në Kosovë kur fillojnë të punojnë për gjithëpërfshirje. Dokumenti jep rekomandime në mënyrë që sistemi të bëhet më gjithëpërfshirës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka filluar pilotimin e kurrikulës së re në 10 shkolla (6 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 2 shkolla të mesme të larta dhe 2 shkolla profesionale), në shtator të vitit 2013. 61 shkolla të reja fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta dhe 31 shkolla profesionale i janë bashkuar pilot projektit dhe kanë filluar me implementimin e KKK-së në muajin shtator 2014.

Gjatë muajve maj – shtator, 2014 Projekti i Binjakëzimit ka mbledhur të dhëna në 61 pilot shkolla të reja fillore të mesme të ulëta dhe në 19 Drejtori Komunale të Arsimit (DKA) për situatën në shkolla. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave ishte për të kuptuar:

- Cilat janë kushtet në shkolla për të filluar zbatimin e KKK-së;
- Çfarë lloje të trajnimeve kanë ndjekur drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit dhe cilat janë nevojat e tyre për trajnim të mëtejshëm;
- Çfarë lloj mbështetjeje u ofrohet shkollave dhe çfarë është e nevojshme për zbatimin e KKK-së;
- Si funksionon sigurimi i cilësisë në nivel shkollor; dhe
- Cilat janë nevojat për pajisje dhe materiale mësimore për zbatimin e KKK-së në shkolla.

Të dhënat e mbledhura gjithashtu përmbajnë informacione për situatën e nxënësve



me nevoja të veçanta arsimore (NVA), duke përfshirë informacione për pakicat etnike, lidhur me praktikën dhe burimet që shkollat kanë për të ofruar mbështetje për nxënësit në nevojë. Raporti i vizitave në terren i është prezantuar MASHT-it në muajin nëntor 2014.

Korniza për udhërrëfyesin është e bazuar në politika dhe dokumente të tjera përkatëse të Republikës së Kosovës. Funksionimi i strukturave dhe mekanizmave të krijuar për sigurimin e qasjes së barabartë për arsim cilësor është analizuar përmes reflektimit në praktikën në nivel shkollash.

Situata aktuale në nivel të shkollave është analizuar në bazë të të dhënave dhe informatave të mbledhura në vitin 2014 përmes vizitave në pilot shkollat e reja, Drejtoritë Komunale për Arsim si dhe në Qendrat Burimore në Kosovë. Autoritetet e MASHT-it, Divizioni i Arsimit Parashkollor, Divizioni i Arsimit me Nevoja të Veçanta, Divizioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional, barazia gjinore dhe SMIA, përfaqësues të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës, si dhe shumë përfaqësues të organizatave të ndryshme donatore dhe OJQ kanë dhënë informacione të vlefshme në lidhje me gjendjen aktuale dhe përgatitjen e këtij udhërrëfyesi. Përveç kësaj, disa raporte vlerësuese dhe rekomandime të ofruara nga organizata të ndryshme kanë qenë një bazë e rëndësishme për ndërtimin e një pasqyre të zhvillimeve dhe të situatës aktuale.



2. Qëllimet e udhërrëfyesit

Qëllimet e udhërrëfyesit janë:

- Të analizojë se si korniza ligjore dhe strukturat mbështetëse të ndërtuara për arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë janë duke funksionuar;
- Të ofrojë një pasqyrë të gjendjes së fëmijëve me nevoja të ndryshme në sistemin arsimor aktual në Kosovë;
- Të analizojë sfidat me të cilat shkollat e zakonshme përballen në zhvillimin e një shkolle gjithëpërfshirëse;
- Të nxjerrë në pah fushat që kanë nevojë për vëmendje të veçantë në promovimin e arsimit gjithëpërfshirës;
- Të ofrojë rekomandime se si të procedohet në zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës;
- Të ofrojë udhëzime për shkollat dhe mësimdhënësit si të fillojnë zhvillimin e shkollave dhe klasave të tyre për t'u bërë gjithëpërfshirëse.

Udhërrëfyesi përmban shumë informacione nga burime të ndryshme dhe referenca që lidhen me zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë gjatë 15 viteve të fundit. Prandaj, ky dokument shërben si material informues për programet e trajnimit që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë.



3. Diversiteti dhe gjithëpërfshirja në arsim

Diversiteti është koncept që mund të përdoret për të bërë dallimin e grupeve dhe njerëzve nga njëri-tjetri. Në arsim, diversiteti mund të shihet si karakteristika që mund të ndikojnë në mënyrat e veçanta në të cilat potenciali zhvillimor dhe të nxënimit realizohen, duke përfshirë dallimet gjuhësore kulturore, etnike, fetare dhe socio-ekonomike.

Sipas OBEZH(OECD) (2010) një sistem i suksesshëm shkollor trajton diversitetin si burim të zhvillimit potencial dhe jo si pengesë e natyrshme për performancën e nxënësve. Ai përdor forcën dhe fleksibilitetin e mësimdhënësve për të nxjerrë jashtë këtë potencial dhe u ofron atyre mbështetjen dhe udhëzimet e duhura për të përmbushur detyrën e tejkalimit të pabarazive dhe, në të njëjtën kohë, shfrytëzon të mirat që nxënësit dhe mësimdhënësit nga mjedise të ndryshme sjellin në klasë.

Korniza strategjike për bashkëpunim evropian në "Arsim dhe Aftësim 2020" (ET 2020) thekson se arsimi duhet të promovojë kompetencat ndërkulturore, vlerat demokratike dhe respektimin e të drejtave themelore dhe të mjedisit, si dhe të luftojë të gjitha format e diskriminimit, duke i pajisur të gjithë të rinjtë për të bashkëvepruar pozitivisht me moshatarët e tyre me prejardhje të ndryshme. Disavantazhi arsimor duhet të adresohet nëpërmjet edukimit të cilësisë së lartë në fëmijërinë e hershme, dhe përmes promovimit të arsimit gjithëpërfshirës. (Këshilli i Evropës. 2009.)



Sipas UNESCO-s (2009), gjithëpërfshirja në arsim mund të shihet si një aspekt i përfshirjes në shoqëri. Është proces i adresimit të dhe përgjigjes ndaj nevojave të ndryshme të të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në mësim, kulturë dhe komunitete, dhe reduktimit dhe eliminimit të përjashtimit në dhe nga arsimi. forcimit të kapacitetit të sistemit arsimor për të arritur tek të gjithë nxënësit pavarësisht nga varfëria, gjinia, përkatësia etnike, gjuha, aftësitë e kufizuara dhe dëmtimet.

Si parim i përgjithshëm, arsimi gjithëpërfshirës duhet të udhëheqë të gjitha politikat dhe praktikën e arsimit, duke filluar nga fakti se arsimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe themeli për një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë. Arsimi gjithëpërfshirës është thelbësor në arritjen e arsimit me cilësi të lartë për të gjithë nxënësit dhe zhvillimin e shoqërive më gjithëpërfshirëse (UNESCO 2009).

Sipas udhëzimeve të UNESCO-s për arsimin gjithëpërfshirës (2009), "suksesi i krijimit të arsimit gjithëpërfshirës si një çelës për krijimin e shoqërive gjithëpërfshirëse varet nga marrëveshja në mes të gjithë partnerëve relevantë për një vizion të përbashkët, të mbështetur nga një numër hapash specifik që duhet të ndërmerren për ta vënë këtë vizion në praktikë. Lëvizja drejt gjithëpërfshirjes është lëvizje graduale që duhet të bazohet në parimet e artikuluara qartë, që adresojnë zhvillimet e gjera të sistemit dhe qasjet shumë-sektoriale që përfshijnë të gjitha nivelet e shoqërisë. Barrierat për gjithëpërfshirje mund të reduktohen përmes bashkëpunimit aktiv midis politikë-bërësve, personelit arsimor dhe akterëve të tjerë, duke përfshirë edhe përfshirjen aktive të anëtarëve të komunitetit lokal, si udhëheqësit politik dhe fetarë, zyrtarët lokal të arsimit dhe mediat. "

Qasja gjithëpërfshirëse nënkupton ndërrimin nga të parit e fëmijës si problem në të parit e sistemit arsimor si problem, që mund të zgjidhet duke i riorganizuar shkollat e zakonshme nëpërmjet përmirësimit të shkollës dhe përqendrim në cilësi për t'u siguruar që të gjithë fëmijët të mund të mësojnë në mënyrë efektive. (UNESCO 2009.) Diversiteti i nxënësve dhe dallimet individuale shihen si mundësi për pasurimin e të nxënësve.

Arsimi gjithëpërfshirës kërkon rindërtimin e kulturave, strukturave, praktikave dhe metodologjive të përdorura në shkollë. Shkollë gjithëpërfshirëse duhet të ofrojë shanse dhe mundësi për një gamë të metodave të punës dhe trajtimit individual për t'u siguruar që asnjë fëmijë të mos përjashtohet nga pjesëmarrja në shkollë. Kjo nënkupton zhvillimin e shkollave të bazuara në drejtësi dhe miqësore për fëmijët, që janë efektive jo vetëm në aspektin akademik, por që janë edhe gjithëpërfshirëse, të shëndetshme dhe mbrojtëse të të gjithë fëmijëve, që i përgjigjen gjinisë dhe që inkurajojnë pjesëmarrjen e vetë nxënësve, familjeve dhe komunitetit të tyre. (UNESCO 2009.)

Shkollat duhet të transformohen ashtu që të kujdesen për të gjithë fëmijët në komunitetet, dhe anëtarët e komunitetit duhet t'i mbështesin shkollat në mirëpritjen e të gjithë fëmijëve në shkollë. Prandaj, mbështetja dhe përkushtimi i mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave dhe anëtarëve të komunitetit është me rëndësi thelbësore për të siguruar përfshirjen në klasë dhe mësim për të gjithë fëmijët pavarësisht nga dallimet e tyre.



4. Zhvillimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës në Kosovë

Sipas UNESCO-s (2009), transformimi i sistemit të arsimit në një sistem më gjithëpërfshirës kërkon ndryshimin dhe rishikimin e legjislacionit kombëtar për të përfshirë nocionet e arsimit gjithëpërfshirës. Konventa ndërkombëtare duhet të nënshkruhen dhe ratifikohen, dhe të reflektohen në legjislacionin kombëtar si dhe zbatimi i politikave dhe ligjeve duhet të promovohet dhe fuqizohet. Përveç kësaj, alokimet buxhetore për arsimin gjithëpërfshirës duhet të jenë përkatëse, transparente, të përgjegjshme dhe efikase. (UNESCO 2009.)

Republika e Kosovës është e përkushtuar për zhvillimin e sistemit të arsimit gjithëpërfshirës i cili është përcaktuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016. Një nga parimet kryesore të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (2011) është përfshirja e cila "i referohet të drejtës së çdo fëmije për të pasur qasje të barabartë në arsim cilësor".

Qeveria e Kosovës ka bërë përpjekje dhe ka treguar vullnet dhe përkushtim për të transformuar sistemin arsimor në mënyrë që të arrihen kërkesat e arsimit gjithëpërfshirës, duke krijuar infrastrukturën ligjore për zhvillimin e sistemit të arsimit gjithëpërfshirës. Në nën-kapitujt në vijim paraqitet kuadri ligjor dhe prezantohet struktura dhe funksionimi i sistemeve mbështetëse me rekomandime.



4.1. Korniza ligjore për zhvillimin e sistemit të arsimit gjithëpërfshirës në Republikën e Kosovës

Korniza ligjore për zhvillimin e sistemit të arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë është e përcaktuar në dokumentet ligjore dhe nënligjore të lëshuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), të tilla si:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe disa Udhëzime Administrative që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës dhe me nevoja të veçanta (Shtojca 4);
- Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011-2016 (PSAK 2011-2016), dhe si pjesë e saj Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2010-2015);
- Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK);
- Strategjia për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2009 – 2015

Përveç këtyre, Ligji Nr. 05 / L - 020 për Barazinë Gjinore dhe Ligji Nr. 03 / L- 047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë ka një komponent të arsimit që parasheh të drejtën për arsimim për të gjithë.

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i miratuar në vitin 2011, thekson se “parimi i arsimit gjithëpërfshirës duhet të zbatohet në Republikën e Kosovës si praktika më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare, siç përcaktohet në Konventën e UNESCO-s për të Drejtat e Fëmijëve (1989), Deklaratën e Salamankas (1994), Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007) dhe në konventat ose rekomandimet e tjera përkatëse ndërkombëtare” (Neni 40). Traktatet dhe deklaratat ndërkombëtare të cilat Kosova i ka njohur janë paraqitur në Shtojcën 2.



Sipas Ligjit (Neni 40. 2) parimi i arsimit gjithëpërfshirës do të thotë se:

- institucionet arsimore dhe/ose aftësuese duhet t'i akomodojnë të gjithë fëmijët, pavarësisht nga kushtet e tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo kushte të tjera dhe duhet të promovojnë integrimin dhe kontaktet ndërmjet fëmijëve;
- mbështetje e rëndësishme duhet të ofrohet në bazë të nevojave individuale të nxënësve; dhe
- mjediset e veçanta arsimore apo shkollat speciale justifikohen vetëm aty kur pas vlerësimit të ekspertëve konsiderohet jopraktike për të regjistruar fëmijën në shkollë apo institucion trajnimi të rregullt.

Ligji autorizon komunat që të marrin masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkolla, duke përfshirë krijimin e dhomave burimore dhe klasave të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore. Komunat kanë përgjegjësinë për të siguruar transport pa pagesë, të sigurt dhe të përshtatshëm, në bazë të vlerësimit të ekspertëve individualë, për fëmijët me aftësi të kufizuara ose vështirësi në të nxënë që ndjekin shkollimin.

Gjatë vitit 2011 – 2014, MASHT-i ka lëshuar disa udhëzime administrative që kanë të bëjnë me sistemet mbështetëse në arsim. (Shtojca 4).

Ligji Nr 02 / L-52 për Arsimin Parashkollor (2006) përcakton parimet e edukimit parashkollor (Neni 4) në institucionet parashkollore, si në vijim: a) barazia; b) përfshirja; c) demokracia; d) autonomia e stafit; e) profesionalizmi dhe përgjegjësia; f) mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve; g) e drejta për të qenë të ndryshëm; h) zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve. Sipas ligjit, arsimi parashkollor është e drejtë për të gjithë fëmijët, duke përfshirë ata me nevoja të veçanta.

Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme për fëmijët e moshës 0 – 6, miratuar në vitin 2011, përmbajnë objektivat kryesore për të stimuluar zhvillimin optimal të fëmijëve dhe për t'iu shërbyer të gjithë akterëve në fëmijërinë e hershme. Standardet janë të dizajnuara për të gjithë fëmijët në Kosovë, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, statusi social-ekonomik i familjeve të tyre dhe larmia kulturore, karakteristikat individuale, aftësitë dhe nevojat e veçanta. Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme e kanë fëmijën në qendër dhe kanë për qëllim të nxisin mbështetjen dhe të krijojnë mundësi dhe mjedis stimulues për zhvillimin optimal të fëmijëve dhe të mësuarit të tyre.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016 ka mision të ndërtimit të një cilësie të lartë të arsimit dhe të sistemit gjithëpërfshirës, të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin, që kontribuon në integrimin e plotë të komuniteteve në shoqëri. PSAK thekson se sistemi arsimor gjithëpërfshirës është i nevojshëm për të reduktuar pengesat për arsimin formal shkollor. Strategjitë e arsimit gjithëpërfshirës, prioritetet dhe veprimet do të jenë të dobishme për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Shtojca 2) dhe politikave gjithëpërfshirëse të qasjes së barabartë deri në vitin 2015. PSAK përcakton aspekte, në mesin e qëllimeve për sektorin e arsimit, si më poshtë:

- Promovimi i gjithëpërfshirjes në arsim me qasje për personat e papërfshirë në shoqëri, personat në varfëri, personat me aftësi të kufizuara dhe për ata që janë në situatë të pavolitshme arsimore, ose të marginalizuar dhe përmirësimi i mundësive të arsimit për gratë dhe vajzat;
- Promovimi i përfshirjes sociale si një koncept gjithëpërfshirës që përfshin pjesëmarrjen e plotë të të gjithë njerëzve, pavarësisht nga dallimet e tyre sociale (si gjinia,

përkatësia etnike, klasa sociale dhe aftësia e kufizuar), në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore.

Prioritetet strategjike të përcaktuara nga PSAK përmbajnë çështjet që janë të lidhura drejtpërdrejt me promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, të tilla si:

- Zhvillimi dhe përkrahja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit duke mundësuar qasje të barabartë në arsimin cilësor;
- Zvogëlimi i numrit të ndërrimeve në shkolla duke zvogëluar numrin e shkollave me dy ndërrime, të vendosura kryesisht në zonat urbane përmes ndërtimit të shkollave të reja fillore dhe të mesme;
- Zhvillimi i mjediseve shkollore miqësore për fëmijët;
- Zhvillimi dhe përkrahja e shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme;
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, të nxënësve dhe promovimi i rezultateve cilësore mësimore duke përcaktuar dhe duke ndihmuar nxënësit të mësojnë se çfarë ata duhet të mësojnë dhe duke i mësuar ata se si të mësojnë;
- Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në të gjitha nivelet dhe të gjitha grupet e arsimit.

Sipas PSAK-ut, MASHT-i mbetet i përkushtuar për rritjen e nivelit të përfshirjes së fëmijëve me NVA në arsimin e rregullt në shkollat fqinje. Shkollat speciale do të ofrojnë arsimim për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda ose të shumëfishta. Roli i ri i mësimdhënësve mbështetës (mësimdhënësit për arsim gjithëpërfshirës) është krijuar me qëllim të mbështetjes së përfshirjes së nxënësve me NVA në klasat e rregullta.

Plani Strategjik për Organizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë (2010 - 2015) është përfshirë në PSAK 2011-2016, së bashku me buxhetin e tij. Vizioni i planit strategjik është sistemi cilësor arsimor për të gjithë fëmijët, duke marrë parasysh dhe duke respektuar nevojat, interesat dhe mundësitë individuale. Për të realizuar këtë vizion, janë përcaktuar pesë objektiva:

- 1) Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja për të rritur gjithëpërfshirjen;
- 2) Sigurimi dhe forcimi i mekanizmave mbështetëse për shkolla gjithëpërfshirëse dhe të qasme;
- 3) Zhvillimi profesional i personelit arsimor;
- 4) Përmirësimi i infrastrukturës fizike për shkollat gjithëpërfshirëse; dhe
- 5) Rritja e vetëdijesimit për arsimin gjithëpërfshirës.

Plani i ri strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë për 2016 - 2020 është hartuar dhe është lansuar në vitin 2015.

Indeksi për gjithëpërfshirje, i cili është një instrument për të udhëhequr shkollat përmes një procesi të zhvillimit të shkollës gjithëpërfshirëse, është pjesë e këtij Plani strategjik. Materialet në Indeks ndihmojnë dhe mbështesin identifikimin e shtigjeve drejt arsimit gjithëpërfshirës duke eksploruar tri dimensione të ndërlidhura që krijojnë kulturën gjithëpërfshirëse, prodhojnë politika gjithëpërfshirëse dhe zhvillojnë praktika gjithëpërfshirëse. (Shtojca 6.)

Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK), e miratuar në vitin 2011, përcakton vizionin për zhvillimin dhe zbatimin e një kurrikule me nxënës në qendër dhe të bazuar në kompetenca në Kosovë, përmes integritimit dhe pasqyrit të vlerave dhe parimeve themelore të drejtave të njeriut, jetesës së bashku, drejtësisë sociale dhe gjithëpërfshirjes. Një nga tre parimet kryesore të KKK-së është gjithëpërfshirja që i referohet të drejtës së çdo fëmije



për të pasur qasje të barabartë në arsim cilësor. E udhëhequr nga ky parim, KKK-ja ofron zgjidhje të përshtatshme për të adresuar diversitetin e nxënësve dhe nevojat e tyre të veçanta në procesin e të nxënësve, duke kontribuar, në këtë mënyrë, në krijimin e plotë të mundësisë që çdo fëmijë të mësojë.

KKK-ja gjithashtu parasheh zgjidhje kurrikulare duke marrë parasysh nevojat e nxënësve dhe duke siguruar qasje të barabartë dhe arsimim cilësor për të gjithë. KKK-ja kërkon rreshtim me arsimimin dhe trajnimin e mësimdhënësve, vlerësimin dhe menaxhimin e klasës dhe të shkollës.

Plani Kombëtar i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar në Kosovë 2009-2011 është përgatitur me mbështetjen e Ministrisë italiane të Punëve të Jashtme dhe në bashkëpunim me personat vendor me aftësi të kufizuara për t'i ndihmuar Qeverisë së Republikës së Kosovës për të krijuar një politikë më efektive, të qëndrueshme dhe më të koordinuar në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, siç parashihet në konventat ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Plani i veprimit përcakton edhe objektivat kryesore në lidhje me arsimimin, si:

- krijimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor;
- zbatimin e legjislacionit në fushën e arsimit për personat me aftësi të kufizuara;
- sigurimin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës në institucionet parashkollore;
- krijimin e programeve profesionale zhvillimore në arsimin gjithëpërfshirës për mësimdhënësit dhe njerëzit e përfshirë në sistemin arsimor dhe përmirësimin e kompetencave për çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel komunal.

Strategjia për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, Komponenti i Arsimit 2007 - 2017 u miratua nga Ministria e Arsimit në vitin 2007. Ajo ka këto qëllime:

- Promovimin dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe integrimin e tyre të plotë në shoqërinë kosovare;
- Hartimin e politikave dhe legjislacionit të duhur, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- Në mënyrë aktive të promovojë fuqizimin e institucioneve demokratike dhe sundimit të ligjit, posaçërisht përmes dialogut dhe ndërtimit të institucioneve për zbatimin e të drejtave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian;
- Mbështetjen dhe inkurajimin e punës së OJQ-ve që përfaqësojnë interesat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, veçanërisht bashkëpunimin me ta, duke përfshirë edhe Institucionin e Avokatit të Popullit.

Kjo strategji është miratuar para përgatitjes së Strategjisë së përgjithshme për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian 2009 - 2015 dhe Planit të veprimit (shih më poshtë). Objektivat strategjike dhe aktivitetet e paraqitura në Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Komponenti arsimor 2007 – 2017, janë të përfshira në komponentin arsimor të Strategjisë së përgjithshme dhe Planit të saj të veprimit.

Strategjia për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë , 2009 – 2015 është strategji gjithëpërfshirëse që synon nxitjen e integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në sektorët kyç të arsimit, punësimit dhe fuqizimit ekonomik, shëndetësisë, strehimit dhe vendbanimit joformal, kthimit dhe ri-integritit, regjistrimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit, në atë të sigurisë, në polici dhe drejtësi, si dhe në media, kulturë dhe informacion. Çështjet gjinore dhe kundër diskriminimit janë ankoruar në të gjithë sektorët kyç si tema ndër-sektoriale.



Komponenti arsimor i Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian , 2009 - 2015 është përgatitur me qëllimin kryesor të krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës dhe të cilësisë së lartë arsimore të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin që kontribuon në integrimin e plotë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare.

Strategjia përmban një analizë të kushteve dhe sfidave të veçanta me të cilat përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, ndërsa Plani i Veprimit përshkruan masat e detajuara dhe konkrete që duhet të ndërmerren nga institucionet përkatëse të nivelit qendror dhe lokal për t'i adresuar sfidat e identifikuar (Shtojca 8). Plani i Veprimit përmban afatin kohor dhe buxhetin për zbatim.

Standardet për shkollat mike për fëmijë (Shtojca 5) në Kosovë janë hartuar në vitin 2012 nga Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetjen e UNICEF-it, për të plotësuar nevojën që rezultoi nga ndryshimet e bëra në fushën e kurrikulës dhe mbështetjen e qëllimit të krijimit të shkollave efektive, të shëndetshme, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrje aktive të prindërve dhe komunitetit. Qëllimi për përcaktimin e standardeve për shkollat mike për fëmijë është:

- Të sigurojë një dokument që përfshin dhe integron të gjitha komponentët e treguesve lidhur me barazinë në arsim që ndikon në bërjen e një shkolle miqësore për fëmijë, dhe
- Të ofrojë kërkesa matëse specifikuere të cilat ndihmojnë shkollën dhe institucionet arsimore për të rritur pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në jetën shkollore dhe në procesin e të mësuarit.

Udhëzimet për zbatimin e standardeve janë hartuar dhe u janë shpërndarë komunave dhe shkollave.

Situata aktuale

Përkundër këtyre përpjekjeve të përgatitjes së kuadrit ligjor me rregulloret dhe standardet me plane të veprimit për t'i adresuar nevojat për ta bërë sistemin arsimor më gjithëpërfshirës, zbatimi i kornizës së politikave dhe planeve të veprimit në praktikë mbetet sfida. Tabela 1 përmban reflektime në bazë të statistikave të siguruara nga SMIA (2015) dhe të dhënat e mbledhura gjatë vizitave në DKA dhe shkollat pilote të Binjakëzimit në vitin 2014 për PSAK (2010), prioritetet strategjike që lidhen me përfshirjen dhe arsimin parauniversitar për vitin 2011 - 2016.



Tabela 1 Prioritetet strategjike të PSAK –ut dhe situata në nivel shkollë në vitin 2014

Prioritetet strategjike të PSAK-ut	Situata në nivel shkollë 2014
Zhvillimi dhe përkrahja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor	Ka fëmijë, veçanërisht me aftësi të kufizuara, edhe nga komunitetet pakicë të cilët nuk kanë qasje në shkollë dhe të cilët për këtë arsye janë në rrezik të braktisjes së shkollës për shkak të mungesës së mbështetjes.
Zvogëlimi i numrit të ndërrimeve në shkolla duke zvogëluar shkollat me dy ndërrime, të vendosura kryesisht në zonat urbane përmes ndërtimit të shkollave të reja fillore dhe të mesme	Përkundër rritjes së numrit të shkollave të reja, shumica e shkollave janë të mbingarkuara dhe ende punojnë në dy ndërrime.
Zhvillimi i mjediseve shkollore mike për fëmijë.	Shumica e shkollave nuk i plotësojnë kërkesat e shkollave mike për fëmijë të përcaktuara sipas standardeve.
Zhvillimi dhe mbështetja e shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme	Në vitin 2014 - 2015 regjistrimi i përgjithshëm në institucionet e fëmijërisë së hershme ishte 3774. Institucionet parashkollore kryesisht u shërbejnë fëmijëve shqiptarë Në vitin 2014 - 2015 kanë qenë vetëm 50 fëmijë (1,3%) nga komunitetet pakicë të regjistruar në institucionet parashkollore. Numri i vogël i fëmijëve të regjistruar me nevoja të veçanta arsimore është kryesisht i akomoduar në shkolla speciale.
Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies dhe promovimi i rezultateve cilësore mësimore duke përcaktuar dhe duke ndihmuar nxënësit të mësojnë se çfarë ata duhet të mësojnë dhe të mësohen se si të mësojnë	Ka shumë pengesa për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies duke filluar nga kushtet në shkolla. Klasat e mbipopulluara, mungesa e pajisjeve dhe materialeve mësimore, mungesa e sistemeve mbështetëse kanë efekt negativ në rezultatet e të nxënies.
Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në të gjitha nivelet dhe të gjitha grupet e arsimit.	Niveli i pajisjeve dhe kapaciteteve njerëzore që kanë të bëjnë me përdorimin e TIK – ut për qëllime arsimore ndryshon shumë në shkolla, por është kryesisht shumë i kufizuar. Më pak se gjysma e shkollave kanë përdorur TIK-un në mësimdhënie lëndore. Kompjuterët ishin kryesisht për menaxhmentin dhe për lëndën e TIK-ut.

Rekomandime

MASHT dhe DKA

- Të sigurohen që parimet e arsimit gjithëpërfshirës, siç përcaktohet në ligj, PSAK dhe KKK të jetësohen në praktikë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- Të sigurohen që parimet e arsimit gjithëpërfshirës u prezantohen të gjithë akterëve përkatës, siç janë stafi i MASHT-it, inspektorët rajonalë, DKA-të, drejtorët e shkollave dhe trajnerët e mësimdhënësve (para shërbimit dhe në shërbim).



4.2. Regjistrimi në nivele të ndryshme në arsimin parauniversitar të Kosovës në 2013 -2014 dhe 2014 -2015

Statistikat vjetore në fushën e arsimit jepen përmes Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) në MASHT. Statistikat japin informacione, si p.sh. për numrin, gjininë dhe përkatësinë etnike të nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe për institucionet arsimore. Informacionet mbledhen nga drejtorët e shkollave dhe futen në databazën e SMIA-së, administrimin e së ciles e bën MASHT-i.

4.2.1. Sfidat në mbledhjen e informacioneve

Për shkak të mekanizmit joadekuat të monitorimit, SMIA përballet me sfida në mbledhjen e të dhënave të besueshme të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, fëmijëve jashtë shkollës dhe të atyre që kanë braktisur sistemin arsimor.

Vështirësitë në mbledhjen e të dhënave të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore janë për shkak të mungesës së mekanizmave për të mbledhur të dhëna në nivel të shkollës, si dhe mungesës së njohurive dhe aftësive për të identifikuar nevojat e veçanta arsimore. Në disa raste, nxënësit me syze janë identifikuar si nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Aktualisht, MASHT-i me mbështetjen e Save the Children është duke përgatitur një formular për identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave për nxënësit me NVA në shkolla.

Raportet (OSBE 2012 IPK 2014), që kanë të bëjnë me braktisjen dhe mosndjekjen e shkollës, tregojnë se ekziston një mungesë e të dhënave, ndërsa ato që janë në dispozicion, janë shumë pak të besueshme. Koncepti “fëmijët jashtë shkollës” madje nuk është definuar në dokumentet e politikave të arsimit në Kosovë. Disa nga problemet kryesore me mbledhjen e të dhënave rreth braktisjes dhe mosndjekjes që janë treguar në këto



raporte janë:

- Mungesa e mekanizmave të mbledhjes së të dhënave dhe llogaridhënies për ata që janë përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për nxënësit që kanë braktisur shkollën;
- Probleme me krahasimin dhe barazimin të atyre informacioneve që janë mbledhur në shkolla me ato të departamenteve të arsimit;
- Mungesa e grumbullimit të të dhënave për arsyet e braktisjes së shkollës;
- Mungesa e mundësisë së ndarjes së të dhënave ekzistuese sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike apo komunitetit;
- Mungesa e sistemit për identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave për fëmijët të cilët kurrë nuk kanë qenë në shkollë; dhe
- Mungesa e sistemit përkatës për menaxhimin e mungesave të nxënësve.

4.2.2. Regjistrimi në 2013 - 2014 dhe 2014 – 2015

Regjistrimi i përgjithshëm në bazë të statistikave të SMIA-s në nivele të ndryshme të arsimit parauniversitar gjatë vitit 2013 - 2014 dhe 2014 - 2015 është paraqitur në Tabelën 2, ndërsa numri i mësimdhënësve në Tabelën 3.

Tabela 2. Numri i nxënësve në institucionet parauniversitare në 2013 - 2014 dhe 2014 – 2015

Niveli	2013 – 2014	2014 – 2015
Arsimi parashkollor (grupmosha e fëmijëve prej 0 në 5 vjeç)	3773 (M1932, F 1841)	3774 (M1960, F1814)
Parafillor (grupmoshat prej 5-6 vjeç)	21383 (M11119, F10264)	22154 (M11406, F10748)
Fillor dhe i mesëm i ulët (Klasa 1 – 9)	278608 (M144335, F134273)	273649 (M141168, F132481)
E mesme e lartë (Klasa 10 – 13)	99578 (M53220, F46358) *Profesionale 54892 (M32990, F21902) * Gjimn. 44686 (M20230, F24456)	83743 (M44385, F39358) *Profesionale 41940 (M25758, F16182) *Gjimn. 41803 (M18627, F23176)
Gjithsej	403342 (M210606, F192736)	383320 (M198919, F184401)

Tabela 3. Numri mësimdhënësve në arsimin para-universitar në 2013 – 2014 dhe 2014 – 2015

Niveli	2013 – 2014	2014 – 2015
Arsimi parashkollor (grupmosha e fëmijëve prej 0 në 5 vjeç)	525 (M2, F523)	528 (M2, F526)
Parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët	17356 (M8499, F8857)	17594 (M8455, F 9139)
I mesëm i lartë (Klasa 10 – 13)	5441 (M3361, F2080)	5358 (M3277, F2081)
Gjithsej	23322 (M11862, F11460)	23480 (M11734, F11746)

Numri i nxënësve nga 2013 - 2014 deri në vitin 2014 - 2015 ka rënë me 20022 nxënës dhe numri i mësimdhënësve është rritur me 158 mësimdhënës nga 23322 në vitin 2013 - 2014

në 23480 në vitin 2014 - 2015.

Numri i shkollave të rregullta dhe paraleleve të ndara (satelitore) dhe raporti nxënës-mësimdhënës në vitin 2014 -2015 është paraqitur në Tabelën 4.

Tabela 4. Numri i shkollave të zakonshme

Niveli arsimor	Gjithsej shkolla	Shkollat satelitore	Proporcioni nxënës-mësimdhënës
Parashkollor	43	7	9,7
Fillor dhe i mesëm i ulët	985	352	16,4
I mesëm i lartë	119	16	15,6
Gjithsej	1147	375	

Proporcioni nxënës – mësimdhënës në statistika (Tabela 4) nuk jep pasqyrë të drejtë të madhësisë së klasës, sepse 1) ekziston një numër i madh i shkollave periferike të cilat janë shkolla të vogla nën administrimin e "shkollave amë" të mëdha dhe zakonisht kanë një numër të vogël të nxënësve, 2) ka klasa për nxënësit nga komunitetet pakicë me vetëm disa nxënës për klasë, dhe 3) shkollat në fshatra kanë zakonisht pak nxënës.

Të dhënat e mbledhura në 61 shkolla, nga Projekti i Binjakëzimit, në vitin 2014 kanë treguar se ka klasa me 2 - 10 nxënës që vijnë nga komunitetet pakicë dhe mesojnë në gjuhën e tyre. Në anën tjetër, në komunat e mëdha, klasat e mesme të larta kishin më shumë se 40 nxënës.

4.2.3. Gjinia e nxënësve dhe mësimdhënësve në arsimin parauniversitar

Tabela 5 paraqet gjininë e nxënësve dhe Tabela 6 gjininë e mësimdhënësve në nivele të ndryshme të arsimit në vitin 2014 - 2015. Pjesëmarrja e vajzave është 3 – 4 % më e vogël në arsimin parashkollor, nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm. Në shkollat profesionale ka 61,4 % djem. Vetëm në gjimnaze regjistrimi i vajzave (55,4 %) është dukshëm më i madh se regjistrimi i djemve.

Tabela 5. Gjinia e nxënësve në nivele të ndryshme të arsimit në vitin 2014 – 2015

Niveli arsimor	Gjithsej	Meshkuj	%	Femra	%
Parashkollor	3774	1960	52	1814	48
Parafillor	22154	11406	51,5	10748	48,5
Parafillor dhe i mesëm i ulët	273649	141168	51,6	132481	48,4
I mesëm i lartë (Gjithsej)	83743	44385	53	39358	47
* Profesionale	41940	25758	61,4	16182	38,6
* Gjimnaze	41803	18627	44,6	23176	55,4



Gjithsej	383320	198919	51,9	184401	48,1
----------	--------	--------	------	--------	------

Tabela 6. Gjinia e mësimeve në nivele të ndryshme të arsimit në vitin 2014 - 2015

Niveli arsimor	Gjithsej	Meshkuj	%	Femra	%
Parashkollor	528	2	0,4	526	99,6
Parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët	17594	8455	48,1	9139	51,9
I mesëm i lartë	5358	3277	61,2	2081	38,8
Gjithsej	23480	11734	50	11746	50

Pak a shumë, ekziston numër i njëjtë i mësimeve meshkuj dhe femra në arsimin parauniversitar, por ka dallime të mëdha në arsimin parashkollor dhe nivelet e mesme të larta. Edukimi parashkollor është i dominuar nga mësuesit femra, ku vetëm dy meshkuj janë duke punuar në institucionet parashkollore në tërë Kosovën. Në arsimin parafillor dhe të mesëm të ulët ka pak më shumë mësues femra. Në nivelin e mesëm të lartë shumica e mësimeve janë meshkuj.

4.2.4. Përkatësia etnike e nxënësve dhe mësimeve në arsimin parauniversitar

Tabela 7. Numri i nxënësve dhe mësimeve sipas origjinës etnike në arsimin parauniversitar në vitin 2013 - 2014 dhe 2014 - 2015.

Origjina etnike	Nxënës 2013 – 2014	Nxënës 2014 – 2015	Mësues 2013 – 2014	Mësues 2014 – 2015
Shqiptarë	388032	368071	22685	22816
Serb	405	622	-	-
Turq	2561	2716	181	193
Boshnjakë	4598	4334	423	436
Goran	643	667	6	7
Ashkali	4205	4177	8	7
Rom	2056	1918	6	7
Egjiptian	788	772	7	6
Kroat	43	31	6	8
Të tjerë	11	12		
Gjithsej	403342	383320	23322	23480

Vlen të përmendet se për shkak të sistemit arsimor paralel, shumica e komunave nuk kanë dhënë informacion në lidhje me nxënësit serb të regjistruar në shkolla.

Statistikat mbi strukturën etnike të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar në vitin 2014 - 2015 tregojnë se 96% e të gjithë nxënësve janë shqiptarë. Në nivele të ndryshme arsimore përkatësia etnike e nxënësve tregon, si më poshtë:



- Në arsimin parashkollor 98,7% e fëmijëve janë shqiptarë dhe 1,3% janë grupe të tjera etnike;
- Në arsimin parafillor 96.3% janë shqiptarë dhe 3.7% janë grupe të tjera etnike;
- Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët 95.5% janë shqiptarë, 4.5% janë grupe të tjera etnike; dhe
- Në arsimin e mesëm të lartë 98% janë shqiptarë, 2% janë grupe të tjera etnike

Ka 23480 mësimdhënës në arsimin parauniversitar dhe 22816 (97%) prej tyre janë shqiptarë. Pjesa tjetër prej 664 (3%) të mësimdhënësve përfaqëson prejardhje të tjera etnike:

- 436 janë boshnjakë që punojnë në komunën e Prizrenit (243), Dragash (75), Pejë (71), Istog (19), Mitrovicë (14), Prishtinë (13) dhe Lipjan (1).
- Mësimdhënësit turq (193) punojnë në komunat Prizren (109), Mamushë (38), Gjilan (23), Prishtinë (20) dhe Mitrovicë (3).
- Mësimdhënësit kroatë (8) janë duke punuar në komunën e Lipjanit.
- Mësimdhënësit rom (7) janë duke punuar në Prizren (4), Gjilan (2), dhe në Klinë (1).
- Mësimdhënësit ashkali (7) janë duke punuar në Suharekë (2), komuna e Ferizajit, Klinës, Pejës, Shtimës dhe Vushtrrisë kanë vetëm një mësimdhënës ashkali.
- Mësimdhënësit egjiptian (6) janë duke punuar në Gjakovë (3), nga një në Klinë, Pejë dhe Rahovec.
- Mësimdhënësit goran (7) janë duke punuar në komunën e Dragashit (2), Pejës (2) dhe Prizrenit (3).

4.2.5. Numri i nxënësve me NVA në sistemin arsimor në vitin 2013 -2014

Janë 5 shkolla speciale që punojnë në kuadër të Qendrave Burimore dhe Shkolla speciale "Shpresa" me gjithsejtë 455 nxënës të regjistruar (M 257, F 188). Tabela 8 tregon numrin e nxënësve me NVA të vendosur në nivele dhe mjedise të ndryshme në vitin 2013 - 2014 dhe në shkolla speciale në 2014 - 2015.

Të dhënat për vitin 2014 – 2015, të ofruara nga SMIA, nuk përmbajnë numrin e nxënësve në klasat e bashkangjitura dhe atyre në klasat e rregullta që mbështeten nga mësimdhënësit udhëtues. Kjo është për shkak të procesit të decentralizimit në fillim të vitit 2014 kur klasat e bashkangjitura janë bartur nga administrimi i MASHT-it në komuna. Ndryshe nga periudha para decentralizimit, shkollat kanë marrë fonde të barabarta prej 23 euro për nxënës në vit për të gjithë nxënësit, duke përfshirë ato me NVA në klasë të bashkangjitura. Kjo, së bashku me mungesën e aftësive për të identifikuar nxënësit me NVA, janë, me sa duket, arsye kryesore pse shkollat nuk kanë siguruar të dhëna të nxënësve me NVA.

Tabela 8. Numri i nxënësve me NVA në nivele dhe mjedise të ndryshme arsimore në vitin 2013 - 2014, dhe në shkolla speciale në vitin 2014 – 2015

Nivelet	Shkollat speciale (2013 -2014)	Klasat e bashkangjitura (2013 -2014)	Të mbështetur në klasat e rregullta (2013 – 2014)	Gjithsej 2013 -2014)	Shkollat speciale (2014 – 2015)
3-4 vjeç	12	19	0	31	10
4-5 vjeç	0	10	0	10	3
5-6 vjeç	25	15	18	58	39
Klasa 1	24	69	38	131	29
Klasa 2	39	41	21	101	24



Klasa 3	27	43	43	113	27
Klasa 4	40	57	36	133	34
Klasa 5	30	64	29	123	23
Klasa 6	41	46	26	113	32
Klasa 7	20	53	19	92	40
Klasa 8	22	52	9	83	25
Klasa 9	27	57	9	93	21
Klasa 10	38	0	1	39	50
Klasa 11	54	0	0	54	37
Klasa 12	62	0	1	63	51
Klasa 13	2	0	0	2	-
Gjithsej	463	526	250	1239	445

Regjistrimi në shkollat speciale që funksionojnë në qendra burimore është zvogëluar në vitin (2013-2014 dhe 2014 -2015) me 18 nxënës.

Në vitin 2013 - 2014, numri i përgjithshëm i nxënësve në shkolla speciale dhe klasë të bashkangjitura ishte 989. Numri i nxënësve të mbështetur në shkollat e rregullta (250) përfshin ata nxënës të cilët janë mbështetur nga mësime të udhëtuara dhe mbështetës. Shumica e nxënësve me vështirësi në të nxënë, si në lexim, shkrim dhe matematikë mbeten pa identifikim dhe mbështetje në shkolla.

Tabela 9 tregon numrin e nxënësve sipas llojit të nevojave të veçanta arsimore në vitin 2013 - 2014 dhe 2014 – 2015, sipas SMIA.

Tabela 9. Numri i nxënësve sipas llojit të NVA në 2013 - 2014 dhe 2014 -2015..

Lloji i NVA-së	2013 – 2014 Shkollat speciale dhe klasat e bashkangjitura	2014 -2015 Shkollat speciale
Dëmtime intelektuale	691	152
Dëmtime dëgjimore	103	40
Dëmtime pamore	86	65
Dëmtime fizike	32	2
Dëmtime të shumëfishta	286	140
Çrregullime komunikimi	6	16
Autizëm	26	25
Vështirësi në të nxënë	6	5
Gjithsej	1239	445

Duhet cekur se shifrat e vitit 2014, - 2015 nuk përmbajnë informacione të klasave të bashkangjitura.

Në gjysëmjetorin e parë, 2015, Divizioni për Nevoja të Veçanta/MASHT ka kërkuar nga

komunat për të siguruar të dhëna mbi numrin e nxënësve me NVA, të regjistruar në Klasat 1 - 9 në shkollat e rregullta në vitin 2014 - 2015 në mënyrë që të përgatisë buxhetin për shkollat. Të dhënat e dorëzuara (paraqitur në tabelën 10) përmbajnë edhe informata për përkatësinë etnike të nxënësve (përkatësi etnike shqiptare ose të tjera).

Tabela 10. Nxënësit me NVA sipas llojit të NVA-ve me përkatësi etnike në klasat 1-9 në vitin 2014 - 2015 (të dhënat e mbledhura nga DNVA në vitin 2015)

Nxënësit me	Shqiptarë	Përkatësi të tjera etnike	Gjithsej në klasa të rregullta 1 – 9
Dëmtime intelektuale	1304	74	1378
Dëmtime dëgjimore	222	15	237
Dëmtime pamore	939	64	1003
Dëmtime fizike	389	25	414
Dëmtime të shumëfishta	452	29	481
Autizëm	127	7	134
Çrregullime komunikimi	80	22	102
Gjithsej	3513	236	3749

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 10 nuk përmbajnë informacione nga shkollat serbe. Të dhënat e mbledhura nuk përfshijnë nxënës me vështirësi në të mësuar, si në lexim, shkrim dhe matematikë dhe ata që braktisin shkollën për shkak të nevojave të veçanta arsimore.

Të dhënat gjithashtu mungojnë për fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët kurrë nuk kanë ndjekur shkollën. Dy grupet të fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të humbur nga sistemi arsimor në Kosovë: fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda intelektuale dhe të shumëfishta, dhe fëmijët e shurdhër-verbër. MASHT-i është duke punuar në përgatitjen e udhëzimeve për mësimdhënie sipas fushave të aktiviteteve që do të ndihmojnë në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda intelektuale dhe të shumëfishta. Numri i fëmijëve të shurdhër dhe të verbër në Kosovë është i panjohur.

4.2.6. Statistikat për braktisjet

Statistikat vjetore të SMIA-s për vitin 2014 - 2015 nuk përmbajnë të dhëna të braktisjes së shkollimit. Përqindjet e braktisjes së shkollimit në vitin 2013 - 2014 për nxënësit me prejar-dhje të ndryshme etnike janë paraqitur në Tabelën 11. Kjo tregon se përqindjet më të mëdha të braktisjes janë tek nxënësit rom, egjiptianë dhe ashkali. Duhet të theksohet se, sipas raporteve të OSBE-së (2012) dhe IPK-së (2014) në lidhje me braktisjen e shkollës dhe mosndjekjen e shkollës tregohet se ekziston mungesë e të dhënave, ndërsa ato të dhëna që janë në dispozicion janë shumë të pabesueshme.



Tabela 11. Përqindja e braktisjes së shkollimit në vitin 2013 – 2014 sipas përkatësisë etnike

Klasa	Shqiptarë	Turq	Boshnjakë	Ashkali	Rom	Egjiptian	Gjithsej
1-9	187	0	1	60	90	16	354
10-13	1033	2	16	1	0	2	1054
Gjithsej	1220	2	17	61	90	18	1408
Gjithsej të regjistruar	388032	2561	4598	4205	2056	788	
% e braktisjes së shkollimit sipas përkatësisë etnike	0,31	0,07	0,36	1,45	4,37	2,28	

Të dhënat nuk përfshijnë braktisjet e shkollimit të serbëve. Nuk kishte goran dhe kroatë që kishin braktisur shkollën, ose mungojnë të dhënat.

4.2.7. Statusi social dhe familjar i nxënësve

Në vitin 2014 - 2015, më shumë se 10% e të gjithë nxënësve vijnë nga familje me asistencë sociale e me një prind. 418 (0,11%) e nxënësve nuk kanë asnjërin prind. (Tabela 12.)

Tabela 12. Statusi social i nxënësve në nivele të ndryshme arsimore

Niveli arsimor	Familjet me asistencë sociale	Familje me një prind	Pa prindër
Parashkollor dhe parafillor	1225 (M686, F539)	140 (M50, F90)	15 (M14, F1)
Fillor dhe i mesëm i ulët	27396 (M14492, F12904)	5989 (M3101, F2888)	304 (M126, F178)
I mesëm i lartë	3409 (M1874, F1535)	2436 (M1293, F1143)	99 (M43, F56)
Gjithsej	32030 (M17052, F14978)	8565 (M4444, F4121)	418 (M183, F235)
% e regjistrimit të përgjithshëm (383320)	8,4	2,23	0,11

Rekomandimet

MASHT

- Të forcohet bashkëpunimi në kuadër të MASHT-it dhe me komunat për t'i përmirësuar të dhënat statistikore për fëmijët jashtë shkollës dhe fëmijët me NVA në dhe jashtë sistemit arsimor si dhe braktisjen e shkollimit. Ekipet vlerësuese komunale do të ofrojnë informata të dobishme lidhur me nxënësit me NVA.
- Të sigurohet që identifikimi i hershëm i NVA të jetë funksional dhe të ofrohet mbështetje në edukimin në fëmijërinë e hershme dhe në arsimin parashkollor dhe fillor;
- Të përkujdeset që fazat e kalimit nga edukimi në shtëpi / edukimi në fëmijërinë e hershme në arsimin parashkollor / fillor dhe gjithashtu nga arsimi i mesëm i ulët në arsimin e mesëm të lartë / profesional të përgatiten mirë për nxënësit me NVA. cvc



4.3. Nivelet e arsimit që kanë nevojë për vëmendje të veçantë

Nivelet në sistemin e arsimit të Kosovës që kanë nevojë për vëmendje të veçantë janë arsimi parashkollor dhe arsimi dhe aftësimi profesional të cilat i kanë sfidat e tyre të veçanta që lidhen me përfshirjen dhe qasjen, siç është paraqitur më poshtë.

4.3.1. Arsimi parashkollor

Arsimi parashkollor është rregulluar me Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011), Ligji Nr. 02 / L-52 për Arsimin Parashkollor (2006), si dhe Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (2011). Arsimi parashkollor përbëhet nga arsimi parashkollor për grupmoshat 0 - 5 dhe arsimi parafillor për grupmoshat 5-6.

Në vitin 2014 -2015 ka pasur 43 institucione parashkollore publike me 3774 fëmijë (Tabela 14). Numri i mësimdhënësve ishte 528 (M2, F526). Krahasuar me vitin e kaluar regjistrimi ka mbetur pak a shumë i njëjtë. Në arsimin parashkollor regjistrimi është rritur paksa në vitin 2014 – 2015.

Statistikat vjetore të SMIA-s për vitin 2014 - 2015 tregojnë se në Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë ka institucione parashkollore private të cilat në vitin 2014 - 2015 janë përkujdesur për gjithsej 251 fëmijë të moshës parashkollore dhe 66 fëmijë të klasave/moshës parafillore.

Përveç kësaj, ka institucione private parashkollore të cilat janë në proces të licencimit nga MASHT-i dhe informacionet e regjistrimit të tyre nuk janë përfshirë në statistikatat vjetore. Sipas Divizionit për Arsimin Parashkollor në MASHT, ka më shumë se 2000 fëmijë të regjistruar në këto institucione private.



Tabela 13. Regjistrimi në arsimin parashkollor publik dhe arsimin parafillor në vitin 2013 - 2014 dhe 2014 -2015

Niveli	2013 – 2014	2014 – 2015
Arsimi parashkollor (grupmosha 0 - 5 vjeç)	3773 (M1932, F 1841)	3774 (M1960, F1814)
Arsimi parafillor (grupmosha 5 - 6 vjeç)	21383 (M11119, 10264)	22154 (M11406, F10748)

Arsimi parashkollor, sipas ligjit, është e drejtë për të gjithë fëmijët. Megjithatë, Kosova ka shkallën më të ulët të vijimit parashkollor në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (QAK 2014).

Komunat kanë përgjegjësinë për organizimin e arsimit parashkollor dhe parafillor. Sipas IPK-së (2014), ka dallime të vogla në mes praktikave të DKA-ve të ndryshme në lidhje me regjistrimin e fëmijëve në arsimin parashkollor. Shumica e shtatë komunave, të cilat ishin të përfshira në studimin e IPK-së, të realizuar në vitin 2013 - 2014, kanë përfshirë aktivitete për gjithëpërfshirje, mbikëqyrje dhe organizim të arsimit parashkollor në planet e tyre vjetore, të tilla si trajnimi i edukatorëve përgjegjës për gjithëpërfshirje, mbikëqyrjen e regjistrimit të fëmijëve në klasat parafillore me informacione të moshës, gjinisë dhe përkatësisë etnike. Megjithatë, të gjitha planet vjetore nuk kanë plane operative të veprimit me qëllim të rritjes së numrit të nxënësve në klasat parafillore. Zyrtarët e intervistuar të DKA-ve kanë arsyetuar mungesën e planeve dhe aktiviteteve me kufizimet buxhetore dhe me faktin se arsimi parafillor nuk është i detyrueshëm.

Sfidat kryesore të cilat hasen dhe disa zgjidhje në fushën e arsimit në fëmijërinë e hershme janë:

1) Mungesa e hapësirës, si problemi më i madh.

- Aktualisht janë vetëm 43 institucione publike të edukimit në fëmijërinë e hershme, në Prishtinë 8 dhe në Gjilan 3, dhe komunat tjera kanë vetëm nga një, përveç shtatë komunave të reja të cilat nuk kanë asnjë të tillë.

2) Mungesa e hapësirës është problem veçanërisht në komunat më të mëdha, p.sh në Prishtinë mund të ketë 50 fëmijë që aplikojnë për një vend. Në anën tjetër, ka institucione parashkollore në komunat më të vogla, në të cilat mund të regjistrohen më shumë fëmijë, ndërsa aplikojnë më pak.

- Ka një tarifë mujore për t'u paguar nga prindërit në institucionin parashkollor (mosha 0 - 5).
- Familjet e mëdha dhe, të paktën, nënat e papunësuar, janë shpesh arsyet për të mos e dërguar fëmijën në arsimin parashkollor.
- Divizioni i arsimit parashkollor përkujdeset për rritjen e vetëdijesimit lidhur me rëndësinë e edukimit të hershëm në mesin e prindërve.

3) Mungesa e kualifikimit të barabartë të edukatorëve në fëmijërinë e hershme dhe sidomos mungesa e edukatorëve të kualifikuar, posaçërisht për moshat 0 - 3;

- Edukatorët për moshat 0 - 3 kanë shkollim të infermierisë, dhe edukatorët për moshat 3 - 5 kanë Bachelor në edukimin e fëmijërisë së hershme.
- MASHT-i dhe Fakulteti i Edukimit kanë adresuar këtë problem dhe në vitin 2014 Fakulteti i Edukimit ka filluar me programin Bachelor për edukatorët për moshat 0 - 3. Aktualisht janë 100 studentë në këtë program katër vjeçar.

4) Mungesa e edukatorëve të kualifikuar për të identifikuar nevojat e veçanta arsimore dhe për të punuar me fëmijët me NVA;



5) Mungesa e sistemeve mbështetëse.

Fëmijëria e hershme është faza ku edukimi mund të ndikojnë në mënyrën më efektive në zhvillimin e fëmijëve dhe të ndihmojë në përmirësimin e situatës së paleverdishme. (EURLex 2011). Prandaj arsimimi në fëmijërinë e hershme është i nevojshëm veçanërisht për fëmijët që vijnë nga familje të varfra. Arsimimi në fëmijërinë e hershme ka treguar të jetë një mënyrë e rëndësishme për të reduktuar lëshimin e hershëm të shkollës, për të mbyllur hendekun në zhvillimin social dhe në të arriturat në shkrim-lexim ndërmjet fëmijëve me prejardhje të avancuar shoqërore dhe atyre me prejardhje të pavolitshme, për të thyer ciklin e arritjeve të ulëta dhe mosangazhimin që shpesh çon në braktisje të shkollës dhe bartje të varfërisë nga një brez në tjetrin. (EURLex 2011.)

Fëmijët me vonesa zhvillimore dhe aftësi të kufizuara do të përfitojnë nga arsimimi në fëmijërinë e hershme, ku ata do t'i zhvillojnë aftësitë e tyre në moshë (p.sh. aftësitë sociale, motorike, kognitive apo njohëse, komunikuese), që janë të nevojshme më vonë në shkollë. Edukimi në fëmijërinë e hershme ofron potencial për përfshirje më të madhe të fëmijëve me NVA, e që hap rrugën për integrimin e tyre në shkollat e rregullta (EURLex 2011).

Statistikat e SMIA-s për vitin 2014 -2015 tregojnë numrin e nxënësve parashkollor me NVA të regjistruar në shkolla speciale dhe jo të atyre në shkolla të rregullta. Në shkollat speciale numri i fëmijëve të grup moshës prej 3 - 5 vjeç është 13, dhe i parafillorëve 39. Sipas EURLex (2011) ka dëshmi të qartë se qasja universale për edukim dhe për kujdes cilësor në fëmijërinë e hershme është më e dobishme se ndërhyrjet e synuara ekskluzivisht në grupet e rrezikuara.

Regjistrimi i fëmijëve nga komunitetet pakicë në arsimin parashkollor është jashtëzakonisht i ulët. Në vitin shkollor 2014 -2015 ka pasur 50 fëmijë nga komunitetet pakicë të regjistruar në institucionet parashkollore publike dhe, si shembull, kanë qenë vetëm 5 fëmijë rom të përfshirë. (SMIA 2015.)

Pavarësisht të dhënave zhgënjyese statistikore, ka shembuj të mirë në mesin e komunave se si të sigurohet qasje në arsim në fëmijërinë e hershme për fëmijët me prejardhje të pafavorshme dhe me aftësi të kufizuara. Një prej këtyre shembujve të mirë është komuna e Prishtinës, e cila në sigurimin e qasjes u ka dhënë përparësi fëmijëve me nëna vetushqyese dhe nga familjet e varfra, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta.

Një nga sfidat në arsimin parashkollor ka të bëjë me bilancin gjinor ndërmjet anëtarëve të stafit. Ka vetëm dy meshkuj duke punuar si edukatorë parashkollor në tërë Kosovën. Fëmijët, veçanërisht ata që vijnë nga familjet pa baba, kanë nevojë për modelin e rolit të cilin mësimdhënësit meshkuj në institucionin parashkollor mund ta ofrojnë.

Standardet e zhvillimit të të mësuarit në fëmijërinë e hershme të moshës 0 – 6

Standardet e zhvillimit të të mësuarit në fëmijërinë e hershme të moshës 0 - 6, miratuar në vitin 2011, ofrojnë një kornizë për arsimin parashkollor për të stimuluar zhvillimin optimal të fëmijëve dhe për t'u shërbyer të gjitha palëve të interesuara në fëmijërinë e hershme. Standardet janë të dizajnuara për të gjithë fëmijët në Kosovë, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, statusi social-ekonomik i familjeve të tyre dhe diversiteti kulturor, karakteristikat individuale, aftësitë dhe nevojat e veçanta. Zhvillimi dhe standardet e të mësuarit të hershëm e kanë fëmijën në qendër dhe kanë për qëllim të nxisin mbështetje



dhe të krijojnë mundësi dhe një mjedis stimulues për zhvillimin optimal të fëmijëve dhe të nxënies.

MASHT-i në bashkëpunim me UNICEF-in ka trajnuar të gjithë edukatorët parashkollorë në përdorimin e standardeve. Këtë vit, fillon trajnimi për mësimdhënësit parafillor. Përdorimi i standardeve është një pjesë e sistemit të MASHT-it për licencimin e edukatorëve. Edukatorët duhet të përgatisin një portfolio të punës që kanë bërë në lidhje me standardet dhe ta dërgojnë atë në MASHT. Një grup ekspertësh të trajnuar e bëjnë vlerësimin e portfoliove dhe nëse dikush dështon në zbatim, ofrohet mbështetje nga këta ekspertë. Në mars të vitit 2015 janë dhënë certifikatat për 218 edukatorë.

Qendrat e komunitetit

Me mbështetjen e Save the Children, Balkan Sunflowers Kosova dhe Caritas të Zvicrës janë themeluar rreth 20 qendra të komunitetit, veçanërisht në zonat rurale, në 7 rajone. Këto qendra të komunitetit u shërbejnë fëmijëve nga mosha 3 – 6 vjeç. Fëmijët qëndrojnë në qendrat e komunitetit 2 - 3 orë në ditë. Qendrat e komunitetit janë financuar nga donatorët për tre vitet e para. Aktualisht komunat i administrojnë ato.

Save the Children ka mbështetur edukimin në fëmijërinë e hershme në Kosovë, veçanërisht në fushën e NVA (Shtojca 4).

Rekomandimet

DKA-të dhe institucionet parashkollore

- T'i përmirësojnë kushtet për arsim cilësor parashkollor për të gjithë dhe, në veçanti, për fëmijët me prejardhje të pafavorizuara, me vonesa zhvillimore dhe aftësi të kufizuara;
- Të krijojnë më shumë paralele parashkollore në mënyrë që të mundësojnë qasje për të gjithë fëmijët;
- Të rrisin vetëdijësimin e prindërve dhe komuniteteve për rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme;
- Të lehtësojnë kalimin e fëmijëve prej edukimit në familje në edukim parashkollor, dhe prej edukimit parashkollor në arsimin parafillor;
- Të përmirësojnë baraspeshën gjinore në mesin e stafit.

4.3.2. Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP)

Divizioni i Arsimit dhe Aftësimi Profesional pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë paraqet komponentin administrativ dhe profesional të arsimit të mesëm të lartë. Arsimi dhe Aftësimi profesional në Kosovë është i rregulluar nga ligjet dhe strategjitë e mëposhtme:

- Ligji Nr.04 / L-032 për Arsimin Parauniversitar (2011);
- Ligji Nr 04 / L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (2013);
- Ligji Nr 04 / L-143 për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve (2012);
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011 - 2016 (2011); dhe
- Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale 2013 - 2020 (2013); dhe
- Strategjia për Udhëzimin për Karrierë për vitin 2015 - 2018.

Parimet për arsimin dhe aftësimin profesional, të përcaktuara në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (2013) janë: 1) gjithëpërfshirja; 2) qasja, transferimi dhe progresi; 3) mësimi teorik dhe praktika profesionale; 4) Nevojat aktuale dhe të ardhshme të ekonomisë; dhe 5) mbështetja e zhvillimit të karrierës si pjesë e integruar e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

4.3.2.1. Regjistrimi në AAP

Sipas SMIA-s, në vitin 2014 - 2015 regjistrimi i përgjithshëm në institucionet e AAP-së ishte 41940 që është rreth 50% e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë. Regjistrimi në shkollat e AAP-së është në rritje gjatë viteve të fundit. Në vitin 2013 - 2014, regjistrimi në AAP në nivelin e mesëm të lartë ishte 55% e regjistrimit të përgjithshëm (Tabela 14) dhe në vitin 2012 - 2013 pothuajse 60%.

Tabela 14. Numri i nxënësve në institucionet e arsimit profesional në vitin 2013- 2014 dhe 2014 – 2015

Niveli	2013 – 2014	2014 – 2015
I mesëm i lartë, gjithsej (Klasat 10 – 13)	99578	83743
I mesëm i lartë profesional (Klasat 10 – 13)	Profesionale 54892 (M32990, F21902)	Profesionale 41940 (M25758, F16182)
% e nxënësve në AAP në arsimin e mesëm të lartë	55 (M33, F 22)	50 (30,7, F19,3)

4.3.2.2. Sfidat e hasura në AAP në lidhje me gjithëpërfshirjen

Në vitin 2013 znj. Gashi A. & Serhati J. kanë bërë një studim në lidhje me arsimin dhe trajnimin profesional me qëllim të thellimit të kuptimit të pengesave dhe mundësive për ndërtimin e sistemit të arsimit profesional gjithëpërfshirës dhe të barabartë në Kosovë. Studimi zbuloi se disa politika synojnë nxitjen e arsimit profesional gjithëpërfshirës, por ka pengesa të zbatimit, si më poshtë:

- Legjislacioni dhe prioritetet strategjike të përcaktuara nga MASHT-i nuk janë të ndërlidhura me ato të ministrive të tjera të linjës dhe nuk i përgjigjen në mënyrë efektive situatës ekonomike;
- Disa reforma të fundit ende nuk janë zbatuar, kështu që ndikimi i tyre nuk është ende i njohur (d.m.th roli i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe i Sistemit të Akreditimit në ofrimin e një sistemi fleksibël dhe të barabartë për të gjithë).
- Mekanizmat e krijuara nga krijuesit e politikave në nivel kombëtar nuk korrespondojnë me kapacitetet në dispozicion në nivel lokal dhe në shkolla (d.m.th Udhëzimi administrativ i miratuar për parandalimin e braktisjes së shkollimit kërkon burime shtesë financiare për ekipet për parandalim dhe reagim në kuadër të shkollave, ndërsa për përgjegjësitë e reja që u janë bartur komunave mungojnë kapacitete për t'u marrë me to).
- Disa nga mundësitë në dispozicion për shkollat profesionale nuk janë duke u përdorur në mënyrë efektive (mësimi elektronik për të plotësuar nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara, tekstet shkollore për të gjithë pa shpenzime shtesë dhe masa të tjera nuk janë përdorur në mënyrë adekuate nga shkollat, dhe roli i firmave ushtrimore në ofrimin e mundësive për grupe të ndryshme të marginalizuara).

Sipas Gashi A. & Serhati J. (2013) sfidat me të cilat përballen shkollat e AAP-së në Kosovë janë si më poshtë:

- Infrastruktura e dobët, imazhi i varfër, dhe atraktiviteti i ulët për të rinjtë.
- Arsimi profesional shihet si një zgjedhje më pak e dëshirueshme për nxënësit dhe shumë prej tyre zgjedhin shkollat profesionale pasi të kenë dështuar për t'u regjistruar në arsimin e përgjithshëm.
- Nxënësit në shkollat profesionale kanë origjinën nga mjediset e varfra socio-ekonomike, që nënkupton se ata janë në rrezik të përjashtimit social.



- Mësimdhënësve në shkollat e AAP-së u mungon trajnimi pedagogjik që ndikon negativisht në cilësinë e arsimit.
- Të diplomuarit e AAP-së nuk janë të përgatitur në mënyrë adekuate për tregun e punës për shkak se shkollat janë të pajisura dobët, ofrojnë mundësi të kufizuara për të mësuar aftësitë praktike, dhe ka pak mundësi për vendosje në ndërmarrjet vendore për praktikën profesionale të nxënësve.
- Ka pak gjasa që shkollat profesionale t'i zgjedhin vajzat, nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nxënësit me vështirësi në të nxënë.
- Shkollat profesionale mund të jenë më pak efektive në ofrimin e mundësive për punësim për vajzat;
- Mundësitë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë janë edhe më të pakta se sa për të tjerët.
- Nuk ka ndonjë sistem formal të përcjelljes së nxënësve brenda shkollave, i cili ofron mundësi të barabarta për të gjitha grupet e nxënësve.

4.2.3.3. Balanca aktuale gjinore në AAP

138 Programet ekzistuese, të AAP-së tërheqin më shumë meshkujt sesa femrat. Sipas SMIA-s, në vitin 2014 -2015 regjistrimi i përgjithshëm në shkollat e AAP-së është 41940 dhe 61,4% e nxënësve ishin meshkuj dhe 38,6% femra. Duhet të theksohet se në të njëjtën kohë 55,4% e nxënësve në arsimin e përgjithshëm të mesëm të lartë janë femra. Färnsveded U. et al (2014) sugjeroi se "shkollat profesionale duken të ndara nga profesionet stereotipe për gratë dhe burrat, pa synime institucionale për të thyer këto modele". Divizioni i Arsimit Profesional në MASHT ka adresuar këtë problem duke organizuar ngjarje të ndryshme për të motivuar vajzat për të aplikuar në arsimin profesional në vitin 2015.

4.3.2.4. Situata aktuale e nxënësve me NVA në AAP

Rruga arsimore për nxënësit me NVA shpesh ndalon gjatë ose pas përfundimit të arsimit të obligueshëm. Në arsimin e obligueshëm, nxënësit me NVA regjistrohen kryesisht në klasë të bashkangjitura apo shkolla speciale dhe nuk ka ndonjë lidhje të duhur për të vazhduar shkollimin në programet e arsimit profesional.

Ka pesë shkolla speciale në qendrat burimore ekzistuese që ofrojnë programe trajnimi për nxënësit me aftësi të kufizuara (shihni fq. 57).

Në vitin 2014 - 2015 numri i përgjithshëm i nxënësve në këto programe të veçanta të aftësimin profesional ishte 138. Në shkollat e rregullta të AAP-së ekziston një numër i panjohur i nxënësve me aftësi të kufizuara, ose vështirësi në të mësuar, por ata nuk marrin ndonjë përkrahje (EU KOSVET V, 2011). Sipas Znj. Gashi A. & Serhati J. (2013), shkollat e rregullta të AAP-së nuk janë përgatitur për të siguruar arsim për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- mësimdhënësit nuk janë të trajnuar për të përmbushur nevojat e veçanta arsimore në klasë;
- infrastruktura përcakton kufizime për qasje për personat me aftësi të kufizuara; dhe
- Nuk ka programe të përshtatshme për nxënësit me NVA dhe vende për praktikën profesionale për ta.

4.3.2.5. Nxënësit nga komunitetet pakicë në AAP

Përqindjet e braktisjes së shkollimit në mesin e nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë të larta në të gjithë arsimin e obligueshëm, dhe vetëm një numër i



vogël i fëmijëve të këtyre komuniteteve vazhdojnë në shkollat e mesme. Përqindja e braktisjes është veçanërisht e lartë në mesin e vajzave, si rezultat i martesave të hershme dhe perceptimeve thellësisht të rrënjosura të roleve gjinore.

4.3.2.6. Rekomandimet e propozuara nga Gashi A. & Serhati J. në vitin 2013

Gashi A. & Serhati J. kanë propozuar këto veprime për shkollat:

- 1) Shkollat duhet të zhvillojnë plane specifike për të tërhequr nxënësit me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë në profilet që u përshtaten këtyre dy grupeve dhe t'i vendosin këta nxënës në kompani të përshtatshme për praktikën profesionale.
- 2) Shërbimet e udhëzimit për karrierë duhet të jenë më të mira për nxënësit me aftësi të kufizuara, nga grupet dhe vajzat e pakicave.
- 3) Shkollat duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre për të parandaluar braktisjen e shkollimit në nivelin e parë të shkollimit profesional ose klasën e 10-të.
- 4) Mësimdhënësit duhet të trajnohen më mirë në marrëdhëniet mësimdhënës - nxënës dhe në trajtimin e nxënësve të përjashtuar nga shoqëria.

Për të përmirësuar mundësitë e punësimit për grupet e pafavorizuara në tregun e punës Gashi A. & Serhati J (2013) rekomandojnë që:

- 1) Komunitat duhet të analizojnë nevojat e tregut lokal të punës dhe të kuptojnë potencialin për punësimin e nxënësve me nevoja të veçanta, me aftësi të kufizuara dhe të etnive të ndryshme;
- 2) Firmat ushtarore duhet më mirë të adresojnë nevojat individuale të nxënësve;
- 3) Shkollat duhet të promovojnë më mirë profilet dhe diplomat që ato ofrojnë dhe mundësitë lokale për punësim;
- 4) Shkollat duhet të ofrojnë mentorim dhe këshillim për pjesën praktike të shkollimit profesional për të nxitur, por edhe për të adresuar gjithëpërfshirjen në përvojën e arsimit;
- 5) Me mbështetjen e donatorëve, OJQ-të që merren me çështjet e përjashtimit social duhet të bashkëpunojnë me shkollat e mesme profesionale dhe të adresojnë nevojat e tyre specifike, dhe
- 6) Shkollat dhe vet sistemi duhet të inkurajojnë më shumë shoqatat e biznesit për të ofruar vendosje në kompanitë për nxënës nga grupet e pafavorizuara.

4.3.2.7. Adresimi i sfidave

MASHT-i ka adresuar sfidat me të cilat përballen shkollat profesionale dhe me mbështetjen e projekteve të financuara nga donatorët ai ka bërë përpjekje për të ndryshuar situatën.

Dy Qendra të Kompetencës (QK), janë themeluar pjesërisht me mbështetjen e projektit Mbështetje për Reformën në Arsim dhe Aftësim në Kosovë - Lux Development KSV/015 KSV/015 (Shtojca 3). QK-të ofrojnë arsim dhe aftësim profesional për të rinjtë, bashkëpunojnë ngushtë me kompanitë private për të zhvilluar mundësi për punë praktike për nxënësit e AAP-së, dhe ofrojnë trajnime dhe shërbime të mësimit gjatë gjithë jetës për bizneset. Projekti KSV/015 ka mbështetur ndërtimin dhe pajisjen e QK-ve duke përfshirë zhvillimin e kurrikulës me trajnimin përkatës të trajnerëve dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të QK-ve.

Projekti Gjithëpërfshirja Sociale në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (SIVET) (Shtojca 3) është zbatuar në pesë shkolla të AAP-së në vitin 2011 - 2013 dhe ka mbështetur MASHT-in për të zbatuar përfshirjen sociale në AAP dhe për të mbështetur qasje të barabartë në arsimin dhe aftësimin profesional për të gjithë. Projekti synonte në krijimin e parakushteve



për një mjedis miqësor dhe një klimë shkollore gjithëpërfshirës për fëmijë , e fokusuar në trajnimin e mësimitdhënësve, krijimin e klimës gjithëpërfshirëse në shkollë dhe pajisjen e klasave model për të lehtësuar mësimitdhënien dhe mësimitnxënien gjithëpërfshirëse.

Projekti SIVET ka zhvilluar programe të trajnimit të mësimitdhënësve në arsimin gjithëpërfshirës të cilat janë të njohura dhe të akredituara nga MASHT-i. Klasat model të shkollave pilot janë të pajisura për të lehtësuar zbatimin e metodave gjithëpërfshirëse të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies, dhe nga pesë mësimitdhënës të secilës shkollë pilote të cilët janë trajnuar në metoda të mësimitdhënies gjithëpërfshirëse kanë shpërndarë njohuritë për mësimitdhënësit e tjerë në shkollat e veta (ka plane për të shpërndarë ato edhe në shkollat e tjera të AAP-së në Kosovë). Shkollat kanë zhvilluar dhe miratuar rregulloret e veta shkollore për gjithëpërfshirjen.

Në përgjithësi, ka pasur kënaqëshmëri të lartë për rezultatet e projektit në mesin e menaxhmentit të shkollës, mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve me rezultatet e përdorimit të metodologjive të reja në klasë. Rezultatet e të nxënësve dhe vijimi janë përmirësuar, nxënësit kanë qenë më të motivuar për mësimit dhe ka pasur më shumë kohë për mësimitdhënësit për ta ndarë me nxënësit me çdo lloj vështirësie në të nxënë. SIVET ka përgatitur rekomandime për të nxitur arsimin gjithëpërfshirës në AAP dhe rekomandimet për hartimin e udhëzimit administrativ për arsimin gjithëpërfshirës në AAP.

MASHT-i ka filluar trajnimin pedagogjik të të gjithë mësimitdhënësve të AAP-së në vitin 2015. Ky trajnim do të jetë një pjesë e Programit Master, zhvilluar nga Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës, në bashkëpunim me MASHT-in, për mësimitdhënësit e ardhshëm të AAP-së. Programi Master do të fillojë në vitin 2016 - 2017.

ALLED –Projekti - Harmonizimi i Arsimit me Nevojat e Tregut të Punës (Shtojca 3) filloi në shkurt të vitit 2015. Projekti e forcon cilësinë dhe rëndësinë e programeve të arsimit dhe lidhjen midis arsimit dhe tregut të punës, si një parakusht për punësim dhe zhvillim ekonomik. Projekti përpiqet të avancojë bashkëpunimin dhe dialogun në mes të institucioneve arsimore dhe partnerëve socialë. Ai fokusohet në përafrimin e arsimit me nevojat e tregut të punës në tre sektorë: bujqësi, makineri dhe përpunim të ushqimit.

Tre rezultatet kryesore të synuara janë si vijon (aktivitetet në Shtojcën 3):

1. Forcimi i lidhjes në mes të Arsimit të lartë (AL) dhe tregut të punës përmes zhvillimit, modernizimit dhe reformimit cilësor të programeve të Arsimit të lartë për të përmbushur nevojat e tregut të punës;
2. Përkujdeset që Korniza Kombëtare e Kualifikimeve të zbatohet me kualifikime të validuara që ofrohen me sukses nga institucionet e akredituara në nivelet 2-5 të kornizës;

Përmirësimi i cilësisë së praktikës dhe mësimitdhënies dhe të nxënësve në arsimin dhe aftësimin profesional të shkollave/ institucioneve në sektorët kryesor profesional që janë të rëndësishëm për nevojat e tregut të punës.



4.4. Sistemet e mbështetëse për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës

Me qëllim të krijimit të sistemit arsimor gjithëpërfshirës, fokusi kryesor duhet të jetë mbi atë që po ndodh në klasat e regullta dhe se si të mbështeten mësimdhënësit e zakonshëm për t'i përfshirë dhe për t'i përmbushur nevojat e ndryshme në klasë.

Nënkapitujt në vijim paraqesin strukturën dhe funksionimin e shërbimeve mbështetëse për nxënësit me NVA, një pasqyrë të veprimeve të bëra për të siguruar arsim cilësor për nxënësit nga komunitetet e pakicave, veprimet e bëra për parandalimin braktisjes së shkollimit nga nxënësit dhe për t'i identifikuar nxënësit që janë jashtë shkollës, si është ngulitur barazia gjinore në sistemin e arsimit, një pasqyrë të sistemit aktual të trajnimit të mësimdhënësve dhe si adresohen nevojat e mësimdhënësve në klasa dhe shkolla gjithëpërfshirëse. Analizohet funksionimi i shërbimeve dhe jepen disa rekomandime për përmirësimin e sistemit.



4.4.1. Struktura dhe funksionimi i shërbimeve mbështetëse për nxënësit me NVA në Kosovë

Sipas Deklaratës së Salamanka-s dhe Kornizës për Veprim në Arsimin për Nevoja të Veçanta (1994), përkthimi i vizionit të arsimit gjithëpërfshirës në praktikë kërkon krijimin e politikave arsimore, praktikave pedagogjike dhe mjediseve që përfshijnë të gjithë fëmijët në procesin e të mësuarit. Përfshirja shkon paralelisht me aftësinë për të siguruar shërbime mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (NVA) në shkollat e tyre të rregullta.

Gjatë 15 viteve të fundit, me mbështetjen e shumë donatorëve (Shtojca 4), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka zhvilluar një sistem për të siguruar qasje dhe mbështetje për fëmijët me NVA. Shumë përparime pozitive janë arritur, duke filluar nga legjislacioni dhe krijimi i shërbimeve dhe mekanizmave për të siguruar mbështetje për nxënësit me NVA.


Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar (neni 39), fëmija ka vështirësi në mësim nëse ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim sesa shumica e fëmijëve të asaj moshe; apo ka një paaftësi e cila e ndalon ose e pengon atë nga përdorimi i pajisjeve arsimore të llojit që ofrohen në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore apo aftësuese.

Ky kapitull përshkruan strukturën dhe funksionimin e sistemeve mbështetëse, siç janë paraqitur në ligj dhe në udhëzimet administrative, dhe jep rekomandime se si të përmirësohen shërbimet.

Figura 1 ilustron se si shërbimet mbështetëse për përmbushjen e NVA-së janë organizuar në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Figura 1

Shërbimet mbështetëse për plotësimin e nevojave të veçanta arsimore në arsimin para-universitar në Kosovë



Në MASHT, **Divizioni për Arsimit me Nevoja të Veçanta** (DANV) vepron në kuadër të Departamentit të Politikave të Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe përbëhet nga katër ekspertë dhe një administrator. DANV është përgjegjës për:

- Zhvillimin e politikave për arsimin gjithëpërfshirës, me theks të veçantë tek fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit për arsimin me nevoja të veçanta;
- Menaxhimin e personelit që punon me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në Qendra Burimore;
- Koordinimin dhe planifikimin e aktiviteteve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës me institucionet, komunat dhe organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
- Monitorimin dhe avancimin e punës së QB-ve, duke përfshirë planifikimin pedagogjik, shërbimet mbështetëse, planifikimin e buxhetit dhe identifikimin e nevojave për këshilla mbështetëse;
- Promovimin për arsimin gjithëpërfshirës përmes veprimeve konkrete që sigurojnë pjesëmarrjen e fëmijëve me NVA në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, me një fokus të veçantë tek fëmijët të cilët janë jashtë sistemit arsimor;
- Monitorimin e cilësisë së procesit arsimor që ofrohet për nxënësit me NVA në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- Bashkëpunimin dhe koordinimin me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me aktivitetet dhe iniciimin e programeve dhe projekteve që do të përmirësojnë gjendjen e arsimit me nevoja të veçanta dhe gjithashtu promovimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Drejtoritë Komunale të Arsimit administrojnë punën e shkollave në komunë. Komunat në Kosovë kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive në ofrimin e arsimit publik parafillor,



fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e mësimitdhënësve dhe administratorëve të arsimit. (Ligji Nr. 03 / L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 17)

Në fillim të vitit 2014, si rezultat i procesit të decentralizimit, administrimi i klasave të bashkangjitura (klasa speciale të vendosura në mjediset e shkollave të zakonshme) është dorëzuar nga MASHT-i në komuna. Para këtij procesi të decentralizimit, shkolla me klasë të bashkangjitura ka marrë fonde për klasat e bashkangjitura nga MASHT-i. Pas decentralizimit, DKA-të administrojnë këto shkolla sipas numrit të nxënësve dhe prandaj nxënësit me NVA edhe në klasat e bashkëngjitura kanë mbetur pa asnjë financim shtesë. DKA-të vazhdojnë të sigurojnë transportin për nxënësit me NVA.

4.4.1.1 Shërbimet në nivel të DKA-ve Zyrtarët për Arsim Gjithëpërfshirës

Njëzetë e tetë (28) komuna kanë emëruar zyrtarë të arsimit gjithëpërfshirës deri në vitin 2015 dhe përshkrimi i punës për ta është përgatitur nga DANV dhe MASHT-i (Shtojca 7). Zyrtarët mbështeten nga DANV me trajnime të vazhdueshme që lidhen me fushën e arsimit gjithëpërfshirës / nevoja të veçanta, me zbatimin e ligjit, PSAK-ut, udhëzimeve administrative etj. Zyrtarët e arsimit gjithëpërfshirës mbajnë takime të rregullta me DANV për të marrë këshilla dhe përkrahje dhe për të shkëmbyer informacione rreth përvojave.

Ekipet vlerësuese profesionale të komunës

Ligji për Arsimin Parauniversitar (neni 41) parasheh që secila komunë, vetëm, ose në bashkëpunim me komunat e tjera, do të krijojë një ekip profesional vlerësues dhe mbështetës për nevoja të veçanta arsimore për të siguruar mbështetje të jashtme për institucionet arsimore dhe/ose trajnuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimitdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Deri më tani, 28 komuna kanë themeluar ekipet e vlerësimit. DANV ka zhvilluar dhe ofruar një instrument me udhëzime rreth përdorimit të tij nga ekipet vlerësuese komunale dhe ekipet vlerësuese janë trajnuar për përdorimin e këtij instrumenti.

Udhëzimi Administrativ Nr 07/2012 mbi Vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore përcakton procedurën se si realizohet vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Vlerësimi profesional duhet, në përputhje me parimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe duke marrë parasysh dëshirat dhe mendimet e prindërve, të shqyrtojë dhe të përcaktojë nëse nxënësi kërkon arsimim të veçantë dhe çfarë lloji i mësimitdhënies duhet të sigurohet. Vlerësimi profesional i fëmijëve përfshin institucionet parashkollore, të gjitha klasat e shkollave të rregullta, qendrat burimore, shkollat speciale spitalore, qendrat edukative dhe rehabilituese të OJQ-ve.

Qëllimet e vlerësimit janë:

- Të vlerësohen aftësitë, interesat dhe nevojat e fëmijës;
- Të jepen rekomandime për metodat e mësimitdhënies, ndihmën, dhe gjërat e tjera të nevojshme për mirëqenien dhe mësimnxënien e fëmijës;
- Të përcaktohen nevojat për pajisje të posaçme të nevojshme për të mësuar; dhe
- Të jepen rekomandime për vendosjen e nxënësit.

Kërkesa për vlerësimin profesional mund të iniciohet nga një prind / kujdestar ligjor, drejtori i shkollës me kërkesën e një mësimitdhënësi, zyrtari të DKA-së për arsimin gjithëpërf-



shirës, ekspertëve mjekësor, drejtorit të Qendrës për Punë Sociale. Kërkesa për vlerësim duhet të dorëzohet në DKA.

Struktura e ekipit vlerësues është

- Zyrtari i DKA-së për arsimin gjithëpërfshirës
- Psikologu
- Punëtori social
- Mësimdhënësi gjithëpërfshirës (mbështetës)
- Mësimdhënësi i Qendrës Burimore
- Specialisti i rehabilitimit varësisht nga lloji i nevojës së veçantë.
- Prindi / kujdestari duhet të konsultohet gjatë kohës së vlerësimit.

Plani individual arsimor (PIA) do të përpilohet pasi që vendimi për arsimin me nevoja të veçanta të jetë marrë nga grupi i vlerësimit. Grupi i vlerësimit mund të japë rekomandime për përmbajtjen e PIA-s. Shqyrtimi i çdo vendimi duhet të bëhet të paktën një herë në vit.

4.4.1.2. Mbështetja në nivel shkolle

Klasat e bashkangjitura, dhomat burimore dhe mësimdhënësit mbështetës

Janë 69 klasë të bashkangjitura me nxënës kryesisht me aftësi të kufizuara shqisore, intelektuale, fizike dhe neurologjike në tërë Kosovën, me 526 nxënës në vitin 2013 - 2014. Klasat e bashkangjitura janë të vendosura në mjediset e shkollave të rregullta dhe mësimdhënësit e klasave të bashkangjitura janë mësimdhënës të kualifikuar.

Sipas Udhëzimit Administrativ (Nr. 24/2014), klasat e bashkangjitura duhet të transformohen në dhoma burimore dhe mësuesit e klasave të bashkangjitura të punojnë si mësues mbështetës. Dhomat burimore duhet të ofrojnë shërbimet e mëposhtme:

- Të mbështesin nxënësit me NVA në klasa të rregullta;
- Të ofrojnë mbështetje individuale për nxënësit me NVA;
- Të prodhojnë materiale mësimore për nxënësit me NVA;
- Të mbështesin mësimdhënësit që punojnë me nxënësit me NVA;
- Të organizojnë aktivitete gjithëpërfshirëse brenda dhe jashtë shkollës;
- Të planifikojnë, këshillojnë dhe vlerësojnë planet arsimore të individualizuara (PIA);
- Të mbajnë takime me prindërit dhe OJQ të ndryshme.
- Roli i mësimdhënësit mbështetës

Roli i mësimdhënësve mbështetës

- Të vëzhgojnë klasat e rregullta, në bashkëpunim me mësuesit klasorë për të identifikuar nxënësit me NVA, veçanërisht në fazat e tranzicionit;
- Të mbështesin nxënësit me NVA dhe vështirësi në të nxënë në klasat e rregullta;
- Të planifikojnë dhe organizojnë mësim në klasa me nxënës me NVA në bashkëpunim me mësuesin klasor;
- Të punojnë në mënyrë individuale me nxënësit me NVA kur është e nevojshme;
- Të hartojnë PIA në bashkëpunim me mësuesin klasor, prindërit dhe, kur të jetë e mundur, me nxënësin;
- Të përkujdesen që PIA-t të vlerësohen dhe rishikohen rregullisht;
- Të këshillojnë dhe ndihmojnë mësuesit në klasë të rregullta se si të punojnë me nxënësit me NVA dhe si të menaxhojnë një klasë gjithëpërfshirëse;



- Të kombinojnë materiale alternative mësimore me mësimdhënës të rregullt për nxënësit me NVA;
- Të ndihmojnë për të rritur vetëdijesimin në mesin e stafit të shkollës për gjithëpërfshirjen;
- Të ndihmojnë udhëheqësinë e shkollës për të akomoduar nxënësit me NVA;
- Të bashkëpunojnë me Qendrat Burimore (QB) për të transferuar nxënësit nga QB në shkolla të rregullta dhe të mbështesin nxënësit me NVA në procesin e integritimit;
- Të bashkëpunojnë me QB-të për të ofruar metoda adekuate të mësimdhënies, materiale dhe përkrahje për nxënësit me NVA;

Në rast se ka dy ose më shumë klasa të bashkangjitura në shkollë dhe nuk ka nevojë për më shumë se një mësimdhënës mbështetës, DKA mund të vendosë për transferimin e mësimdhënësit mbështetës në ndonjë shkollë tjetër të komunës.

Ekipe mbështetëse

Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2014 përcakton se shkollat duhet të krijojnë ekipe mbështetëse për të mbështetur transferimin e nxënësve nga klasat e bashkangjitura në klasa të rregullta. Ekipi Mbështetës përbëhet nga anëtarët në vijim:

- Drejtori i shkollës;
- Mësimdhënësi i klasës së bashkangjitur dhe mësimdhënësi mbështetës;
- Psikologu apo pedagogu, ose një mësimdhënës i trajnuar në arsimin gjithëpërfshirës.

Mësimdhënësit e klasave të bashkangjitura i vlerësojnë nxënësit që janë të gatshëm për integrim të pjesshëm apo integrim të plotë në klasë të rregullta. Pas diskutimit rreth vendimit të ekipit mbështetës, drejtori e përgatit një vendim me shkrim mbi integrimin e nxënësit në klasë të rregullt. Integrimi rekomandohet për të filluar me lëndët e shkathtësive, artit dhe edukimit fizik, por ekipi mbështetës merr vendimin përfundimtar nëse nxënësi mund të integrohet në lëndët e tjera ose të integrohet plotësisht. Përparimi i nxënësit me NVA në klasë të rregullt duhet të përcillet nga mësimdhënësi mbështetës, mësimdhënësi i klasës së bashkangjitur dhe mësimdhënësit klasor lëndor për të ndihmuar nëse paraqiten pengesa në adaptimin e tyre.

Planet e individualizuara arsimore (PIA)

Ligji për Arsimin Parauniversitar (Neni 41) përcakton se përmbajtja mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore do të vendoset në planet individuale arsimore (PIA). Procedura për zbatimin dhe vlerësimin e PIA-ve është e rregulluar në Udhëzimin Administrativ Nr. 18/2013 për përdorimin e Planit Individual Arsimor me këtë përmbajtje:

- Definicioni i PIA-;
- Përcakton cilët nxënës kanë të drejtë për PIA;
- Përcakton se çfarë duhet të përmbajë PIA;
- Përcakton se si PIA duhet të rishqyrtohet dhe vlerësohet;
- Përcakton se si nxënësit me PIA duhet të vlerësohen;
- Identifikimi dhe mirëmbajtja e dokumentacionit;
- Monitorimi i përdorimit të PIA-s.

Udhëzimet për planet arsimore të individualizuara u botuan nga MASHT-i në vitin 2011 dhe një instrument për monitorimin e zbatimit të PIA-s është zhvilluar. MASHT-i, me mbështetjen e projekteve të donatorëve dhe qendrave burimore, kanë trajnuar qindra mësimdhënës në përdorimin e PIA-s. Inspektorët rajonal dhe drejtorët e shkollave me klasë të bashkangjitura janë trajnuar për të monitoruar përdorimin e PIA-s.

4.4.1.3. Situata aktuale



Gjatë viteve të fundit, numri i klasave të bashkangjitura ka rënë nga 73 deri 69. Për fat të keq, shumica e komunave me klasë të bashkangjitura kanë tendencë për të akomoduar nxënësit me aftësi të kufizuara dhe NVA në klasë të bashkangjitura. Sipas DKA-ve dhe shkollave, kjo është për shkak të njohurive dhe shkathtësive të kufizuara të mësimit të klasave të rregullta për të menaxhuar klasa me nxënës me NVA.

Edhe pse shumë nga klasat e bashkëngjitura janë duke funksionuar në ndërtesë të njëjta me klasat e rregullta, gati se nuk ka fare komunikim me nxënësit në klasat e rregullta. Nxënësit në klasat e bashkangjitura janë të grumbulluar në të njëjtën klasë, pavarësisht moshës së tyre apo nevojës së veçantë për shkak të aftësisë së kufizuar dhe, përveç kësaj, diferencimet e kurrikulës gati janë të pamundura, sepse nuk ka asnjë asistent shkollor në dispozicion. Si rezultat i kësaj, mund të thuhet se klasat e bashkangjitura stimulojnë ndarjen e nxënësve me NVA, funksionojnë kryesisht si depo për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nuk paraqesin ndonjë arsimim cilësor.

Plani për transformimin e klasave të bashkangjitura në dhoma burimore do të thotë se nxënësit nga klasat e bashkangjitura do të transferohen në klasë të rregullta. Kushtet aktuale mësimore në klasa të bashkangjitura paraqesin një arsye të mirë për këtë, por për t'iu shmangur situatave edhe më të këqija në klasat e rregullta, kur nxënësit me aftësi të kufizuara vendosen atje, përgatitjet duhet të bëhen siç duhet, që do të thotë se mësimit të klasave të rregullta duhet të jenë të trajnuar për të menaxhuar klasë gjithëpërfshirëse dhe shërbimet mbështetëse duhet të jenë në dispozicion për nxënësit me NVA dhe mësimit të tyre. Nxënësit duhet të vendosen në klasa me moshë të përshtatshme.

Janë vetëm 37 mësimit të mbështetës të emëruar, 9 që punojnë në nivelin parashkollor dhe 28 në shkollat fillore, dhe në këtë mënyrë roli i dhomave burimore dhe mësuesve mbështetës mbetet i panjohur për shumicën e shkollave në Kosovë. Që nga viti 2009, me mbështetjen e Save the Children dhe FSIESK, 20 shkolla gjithëpërfshirëse, duke përfshirë 9 të nivelit parashkollor janë themeluar. Në këto shkolla të gjithë anëtarët e stafit janë trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës, janë siguruar materiale didaktike, janë pajisur (me kompjuterë dhe lap-top), dhe janë punësuar mësimit të mbështetës. Indeksi për gjithëpërfshirjen (Shtojca 6) është prezantuar në shumicën e këtyre shkollave dhe 7 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe 7 institucione parashkollore janë ende duke e përdorur atë si një mjet për të zhvilluar shkollën për t'u bërë më gjithëpërfshirëse.

Edhe përkundër përpjekjeve, për t'i njoftuar mësimit të mbështetës me PIA-t janë ende kryesisht të panjohura në shkolla dhe janë në përdorim sistematik vetëm në shkollat speciale dhe në klasë të bashkangjitura. Veçanërisht, mësimit të mbështetës në shkollat e rregullta duhet të trajnohen se si të përgatisin dhe të përdorin PIA-t, duke përfshirë planifikimin e diferencimeve individuale kurrikulare.

Një prej shkollave gjithëpërfshirëse është shkolla e mesme e ulët "Rexhep Elmazi" në Gjilan, e cila është një shembull i mirë i një shkolle në Kosovë që ka krijuar mjedis të mirë të të mësuarit për nxënësit me NVA. Praktikën e mira për përfshirjen e nxënësve me NVA, që janë realizuar në këtë shkollë janë të paraqitura më poshtë. Shkolla gjithëpërfshirëse "Rexhep Elmazi" në Gjilan është duke treguar praktika të mira në përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara



- Menaxhmenti i shkollës është shumë pozitiv në qasjen e arsimit gjithëpërfshirës dhe është duke bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të mbështetur nxënësit me NVA;
- 24 nxënës me aftësi të kufizuara dhe numër shtesë i nxënësve me vështirësi në lexim, shkrim dhe matematikë janë regjistruar dhe mbështetur;
- 16 nga nxënësit me aftësi të kufizuara janë duke mësuar në klasat e rregullta dhe ndihmohen nga mësime të mbështetës;
- Një klasë e bashkangjitur me 8 nxënës me dëmtime intelektuale dhe të shurdhër;
- Në klasën e bashkangjitur, 2 interpretues të gjuhës së shenjave të angazhuar nga DKA;
- Mësime të mbështetës që ofron mbështetje individuale për nxënësit me NVA dhe jep mësim bashkë me mësime të klasorë dhe lëndorë;
- PIA në përdorim dhe prindërit të përfshirë në përgatitjen e PIA-ve;
- Ekipi komunal i vlerësimit e mbështet shkollën;
- Shumica e mësime të mbështetës janë trajnuar në arsimin special/gjithëpërfshirës nga projektet finlandeze që nga viti 2000 dhe qëndrimet e të gjithë mësime të mbështetës janë pozitive për gjithëpërfshirjen dhe mbështetjen e nxënësve me NVA;

Rekomandimet MASHT

- Të fuqizohen ekipet vlerësuese duke ofruar trajnim të mjaftueshëm për ta dhe për të forcuar bashkëpunimin e ekipeve vlerësuese me shkollat;
- Të planifikohet se si të rritet numrin e mësime të mbështetës në shkolla, përmes:
 - përgatitjes së udhëzimeve administrative për mësime të mbështetës në të gjitha shkollat (jo vetëm në shkollat me klasa të bashkëngjitura), duke përfshirë udhëzimet për themelimin e dhomave burimore dhe ekipeve;
 - planifikimit dhe zbatimit të kurseve trajnuese në shërbim dhe para-shërbimit për mësime të mbështetës në bashkëpunim me IPK-në dhe Fakultetin e Edukimit;
 - udhëzimit të DKA-ve për përdorimin e burimeve ekzistuese njerëzore për të punuar si mësime të mbështetës, sidomos në shkollat me ulje të numrit të nxënësve;
- Të përkujdeset që transformimi i klasave të bashkëngjitura në dhoma burimore të përgatitet paraprakisht. Fokusi duhet të jetë në fuqizimin e klasës dhe mësime të mbështetës lëndorë për t'i mirëpritur nxënësit me NVA. Duhet pasur parasysh, këto në vijim:
 - Nxënësit në klasat e bashkëngjitura duhet të vendosen në klasa sipas moshave;
 - Mësime të klasorë dhe lëndorë duhet të jenë të trajnuar dhe të përgatitur mirë për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse dhe për të plotësuar nevojat e nxënësve me NVA;
 - Mësime të mbështetës duhet të jenë të trajnuar në përdorimin e PIA-s dhe në diferencimin e kurrikulës (përmbajtja, strategjitë e mësimit, materialet dhe vlerësimi);
 - Përkrahja që u jepet nxënësve me NVA dhe mësime të klasorë / lëndorë duhet të planifikohet në mënyrë të duhur para se të akomodohen nxënësit me NVA në klasën e rregullt;
- Të planifikohet se si të rritet numrin e mësime të mbështetës në shkolla përmes:
 - përgatitjes së udhëzimeve administrative për mësime të mbështetës në të gjitha shkollat (jo vetëm në shkollat me klasa të bashkëngjitura), duke përfshirë udhëzimet për themelimin e dhomave burimore dhe ekipeve;

- planifikimit dhe zbatimit të kurseve trajnuese në shërbim dhe para-shërbimit për mësimdhënësit mbështetës në bashkëpunim me IPK-në dhe fakultetin e Edukimit;
- udhëzimit të DKA-ve për përdorimin e burimeve ekzistuese njerëzore për të punuar si mësimdhënës mbështetës, sidomos në shkollat me ulje të numrit të nxënësve;

DKA

- Të sigurohet se parimet e arsimit gjithëpërfshirës që janë përcaktuar në kornizën ligjore të Kosovës zbatohen në komuna;
- Të sigurohet që komunat kanë emëruar zyrtarët për arsim gjithëpërfshirës;
- Të mbështetet puna e zyrtarëve komunal për arsim gjithëpërfshirës për të koordinuar dhe për t'u ofruar shkollave mbështetje;
- Të sigurohet që ekipet vlerësuese komunale të themelohen dhe të trajnohen në bashkëpunim me shkollat për arsim gjithëpërfshirës;
- Të punohet në bashkëpunim me shkollat, ofruesit e shërbimeve në fëmijërinë e hershme dhe OJQ-të për të rritur vetëdijesimin mbi arsimin gjithëpërfshirës në mesin e prindërve dhe komunitetit, duke përfshirë aktivitetet e vetëdijesimit;
- Të trajnohen drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit për të menaxhuar një shkollë duke organizuar trajnime të vazhdueshme për gjithëpërfshirjen.
- Transformimi i klasave të bashkangjitura në dhoma burimore dhe përgatitja e duhur e procesit të transformimit, për t'u siguruar që mësimdhënësit lëndorë dhe klasorë të jenë të trajnuar për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse dhe për të përmbushur nevojat e nxënësve me NVA në klasë; për t'u siguruar që mbështetje e mjaftueshme ofrohet për nxënësit me NVA dhe mësimdhënësit e tyre;
- T'u mundësohet shkollave të kenë mësimdhënës mbështetës dhe dhoma burimore. Mësimdhënësit mbështetës dhe dhomat burimore janë të nevojshme në të gjitha shkollat, jo vetëm në ato me klasë të bashkangjitura. DKA - të mund të fillojnë me një nga opsionet e mëposhtme:
 - 1) Varësisht nga numri i shkollave në komunë, të punësojnë 1-3 mësimdhënës "udhëtues" mbështetës për të punuar në komunë dhe për t'i mbështetur shkollat;
 - 2) Të krijojnë dhoma burimore në të gjitha shkollat, ku mësimdhënësit "udhëtues" mbështetës mund të ofrojnë mbështetje individuale/ në grupe të vogla;
 - 1) Të transformojnë disa shkolla në "qendra grumbullimi" për të siguruar mbështetje profesionale dhe materiale në shkollat e tjera në komunë. Themelimi i qendrës së grumbullimit kërkon:
 - a. Punësimin e mësimdhënësve mbështetës në qendër të grumbullimit;
 - b. Trajnimin e mësimdhënësve në mënyrë që të fitojnë njohuri dhe aftësi se si të menaxhojnë një klasë gjithëpërfshirëse dhe të mbështesin nxënësit me NVA;
 - c. Ndarjen e buxhetit për të prodhuar dhe ofruar materiale mësimore për shkolla.

Këto shkolla duhet mundësisht të jenë shkollat e tanishme gjithëpërfshirëse, dhe pilot shkollat e KKK-së të cilat janë duke u mbështetur nga Projekti i Binjakëzimit.

Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Projekti i Binjakëzimit janë duke ndërtuar kapacitete në mesin e mësimdhënësve dhe menaxhmentit.

Komunat me rënie të numrit të nxënësve mund të përdorin mësimdhënësit klasor për të punuar, pasi të jenë trajnuar, si mësimdhënës mbështetës. MASHT-i në bashkëpunim me IPK-në dhe Fakultetin e Edukimit duhet të planifikojnë se si t'i trajnojnë këta mësimdhënës për të punuar si mësimdhënës mbështetës.



Roli i mësimdhënësve mbështetës duhet t'u sqarohet drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve në shkollat e rregullta. Mësimdhënia bashkëpunuese ndërmjet mësimdhënësve mbështetës dhe mësimdhënësve të tjerë duhet të forcohet dhe mësimdhënësit të trajnohen në metodat bashkëpunuese të mësimdhënies

4.4.1.5. Qendrat burimore

Funksionimi i qendrave burimore dhe shkollave speciale është përcaktuar me Ligjin për Arsimin Parauniversitar (Neni 42) dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 23/2013 për Qendrat Burimore. Sipas Ligjit, Ministria mund të themelojë dhe mirëmbajë qendra burimore, shkolla speciale dhe njësi të tjera për sigurimin e arsimit special për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda ose të shumëfishta, apo vështirësi në të nxënë që janë vlerësuar si të paaftë për t'u arsimuar në shkollat komunale ose institucione trajnuese publike. Qendra burimore dhe njësitë e tjera të veçanta të krijuara do të sigurojnë, brenda burimeve në dispozicion, asistencë me kërkesë të institucioneve arsimore dhe/ose aftësuese në edukimin e nxënësit me vështirësi në të nxënë.

Qendrat burimore janë duke funksionuar drejtpërdrejt nën administrimin e MASHT-it. Ministria duhet të sigurojë transport pa pagesë, të sigurt dhe të përshtatshëm, ose të organizojë kujdesin e përshtatshëm për banim, sipas vlerësimit individual të ekspertëve, për fëmijët që frekuentojnë qendrat burimore, shkollat speciale dhe njësi të tjera të përcaktuara në këtë pjesë.

Qendrat Burimore funksionojnë 1) si shkolla speciale për nxënësit me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta duke ofruar strehim në konvikte për ata në nevojë; dhe 2) si shërbime mbështetëse për të siguruar mbështetje për shkollat e zakonshme në mësimin e nxënësve me NVA. Shkollat speciale dhe shërbimet mbështetëse të veçanta bashkëpunojnë ngushtë për të shkëmbyer informacione, njohuri, ekspertizë, hulumtime dhe burime.

Ekzistojnë pesë qendra burimore në Kosovë dhe secila prej tyre me një fushë të caktuar të specializimit:

- QB Dr. Xheladin Deda në Pejë për mësimdhënie dhe shërbime për nxënësit me dëmtime shikimi;
- QB Nënë Tereza në Prizren për mësimdhënie dhe shërbime për nxënësit me dëmtime dëgjimi;
- QB Përparimi në Prishtinë për mësimdhënie dhe shërbime për nxënësit me dëmtime intelektuale dhe vonesa zhvillimore;
- QB Lef Nosi në Prizren për nxënësit me dëmtime intelektuale dhe vonesa zhvillimore; dhe
- QB Nena Tereza në Mitrovicë për nxënësit me dëmtime intelektuale dhe vonesa zhvillimore.

Secila nga QB-të është e përcaktuar për t'i shërbyer zonave të caktuara në mënyrë që të ofrohen shërbime për të gjithë vendin. Nivelet arsimore me të cilat punojnë shkollat speciale janë:

- Klasa e arsimit parafillor (niveli 0);
- Arsimi fillor, klasat 1-5;
- Arsimi i mesëm i ulët, klasa 6-9;
- Arsimi i mesëm i lartë, klasa 10-12; dhe
- Arsimi joformal bazuar në specializimin e shkollës.

Grupi i synuar i arsimit joformal përbëhet nga nxënësit që e kanë tejkaluar moshën shkollore dhe të cilët duhet të kenë qasje në programe të veçanta për ta përfunduar arsimimin e obligueshëm. Këta mund të jenë nxënësit mbi moshë, të cilët janë të reg-



jistruar në QB, fëmijët të cilët janë të regjistruar për herë të parë në shkollë, apo fëmijët që janë identifikuar si jashtë sistemit shkollor, ose fëmijët që janë regjistruar, por shkollimi i të cilëve është ndërprerë për arsye shëndetësore. Fatkeqësisht, arsimimi joformal nuk është siguruar akoma në qendrat burimore.

Qendrat Burimore ofrojnë edhe trajnime profesionale. Programet e trajnimit janë si më poshtë:

- QB Përparimi në Prishtinë: bujqësi
- QB Nëna Terezë në Mitrovicë: makineri, zdrukthëtari dhe rrobaqepësi
- QB Nëna Terezë në Prizren: punë me metale, zdrukthëtari, tekstil dhe dizajn të modës
- QB Xheladin Deda në Pejë: biznes dhe administrim biznesi dhe teknologji e informacionit
- QB Lef Nosi në Prizren: bujqësi dhe pemëtari
- QB Përparimi in Prishtina: bujqësi
- QB Nënë Tereza në Mitrovica: makineri, zdrukthëtari dhe rrobaqepësi.

Shërbimet e ofruara nga QB-të, të parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2013 në Qendra Burimore janë si më poshtë:

1) Detyrat e shkollave speciale

- Ofrimi i mësimdhënies për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta;
- Përgatitja e programeve për nevoja të veçanta arsimore për nxënësit në shkollë;
- Përgatitja e PIA-ve për nxënësit;
- Ofrimi i programeve me institucionet e tjera arsimore për arsimin joformal për personat me aftësi të kufizuara që kanë tejkalluar moshën e shkollës;
- Ofrimi i shërbimeve rehabilituese në bazë të specializimit të shkollës;
- Vlerësimi i nevojave të nxënësve;
- Planifikimi i tranzicionit të nxënësve;
- Bashkëpunimi me prindërit dhe institucionet përkatëse;
- Organizimi i transportit të sigurt dhe efikas për nxënësit;
- Sigurimi i akomodimit për nxënësit në konvikte, organizimi i aktiviteteve jashtë shkollore;
- Ofrimi i ushqimit ditor për nxënësit në QB.

2) Detyrat e Qendrave Burimore

Qendrat Burimore ofrojnë shërbime për shkolla të rregullta lidhur me mësimdhënien dhe të mësuarit e nxënësve me NVA. Çdo QB ka emëruar nga një koordinator për shërbimet mbështetëse, ka punësuar mësimdhënës udhëtues dhe ka krijuar ekipe për mbështetje teknike si në vijim:

- Ekipin pedagogjik të vlerësimit;
- Ekipin rehabilitues;
- Ekipin për hartimin e materialeve të mësimdhënies;
- Ekipet trajnuese; dhe
- Ekipet për shërbime të veçanta sipas nevojave të QB.

Detyrat e shërbimeve mbështetëse:

- Identifikimi dhe vlerësimi i fëmijëve duke përfshirë ata jashtë shkollës dhe parashkollorë;
- Mbështetja për institucione parashkollore, shkolla të rregullta dhe prindër;
- Mbështetje për nxënësit dhe mësimdhënësit në shkollat e rregullta nga mësimdhënësit udhëtues;
- Zhvillimi, hartimi dhe shpërndarja e materialeve mbështetëse për nxënësit;



- Dhënia e këshillave për mësimdhënësit në shkollat e rregullta për t'i mësuar nxënësit me NVA;
- Organizimi i kurseve të akredituara për mësimdhënësit me nxënës me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë;
- Ofrimi i kurseve të shkurtra për nxënës të shkollave të rregullta të cilët janë në nevojë për teknikat alternative për të mësuar, vlerësimi dhe rehabilitimi i atyre në nevojë për mbështetje në periudhën e tranzicionit;
- Vlerësimi pedagogjik i nxënësve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë në shkolla;
- Ofrimi i mbështetjes dhe pajisjeve didaktike për nxënës me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë;
- Bashkëpunimi me OJQ-të që merren me personat me aftësi të kufizuar për të identifikuar fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë;
- Rrjetëzimi me QB-të e tjera për të mbuluar të gjithë territorin e Kosovës;
- Bashkëpunimi me ekipe multi-profesionale të komunës në lidhje me vendosjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen e nevojshme për nxënësit me vështirësi në të nxënë;
- Organizimi i fushatave të vetëdijesimit mbi arsimin gjithëpërfshirës për prindërit dhe anëtarët e komunitetit;
- Bashkëpunimi me mësimdhënësit mbështetës dhe mësimdhënësit e klasave të bashkangjitura në bashkërendimin e mbështetjes për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë;
- Realizimi i hulumtimit dhe publikimit të rezultateve në lidhje me metodat dhe teknikat e mësimdhënies;
- Mbajtja dhe përditësimi i të dhënave për datat e ofrimit të mbështetjes në shkolla të rregullta, përgatitja e raporteve të rregullta për punën e bërë.

Qendrat burimore kanë tri funksione kryesore:

- Të ofrojnë mbështetje për shkollat e tjera;
- Të prodhojnë materiale mësimore për përdorim nga shkollat me nxënës me NVA në shkollat e zakonshme; dhe
- Të ofrojnë trajnime për mësimdhënësit e shkollave të zakonshme.

Mësimdhënësit udhëtues

Aktualisht janë 9 mësimdhënës udhëtues që punojnë në 5 qendra burimore. Detyrat e mësimdhënësve udhëtues janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 23/2013 për Qendrat Burimore, si më poshtë:

1. Mbështetja për nxënësit në shkolla të rregullta, duke përfshirë identifikimin e nevojave;
2. Forma e mbështetjes përcaktohet në kuadër të grupit mbështetës të QB-së;
3. Hartimi i planeve dhe raporteve të punës;
4. Mbledhjet javore në QB dhe takimet me mësimdhënësit e tjerë udhëtues, çdo tre muaj;
5. 40 orët e punës javore përmbajnë 10 orë udhëtimi, 10 orë për përgatitjen e materialeve dhe 20 orë të mbështetjes për nxënës.

Përshkrimi i punës për mësimdhënësit udhëtues është përgatitur nga DANV, MASHT (Shtojca 7). Sipas të dhënave të mbledhura nga DANV, MASHT në vitin 2014 – 2015, shtatë mësues udhëtues në 5 qendra burimore kanë mbështetur 155 nxënës në shkollat e rregullta.

Transferimi i nxënësve nga shkolla speciale në shkolla të rregullta

Procesi i integritimit nga QB në shkolla të rregullta është i rregulluar me Udhëzimin Admin-

istrativ për qendrat burimore (Nr. 23/2013) si vijon:

- Nëse ekipi vlerësues në QB ka vlerësuar se fëmija mund të jetë i përfshirë në shkollën e rregullt, QB është e detyruar të fillojë dhe të zhvillojë procedurën për përfshirjen e fëmijës;
- Integrimi mund të jetë i pjesshëm, kur nxënësi ndjek pjesën më të madhe të mësimëve, ose me kohë të plotë kur integrimi bëhet në bashkëpunim të ngushtë me prindërit dhe shkollat e rregullta.

Qendrat burimore si ofrues të trajnimeve

MASHT-i ka autorizuar qendrat burimore për të ofruar 16 programe trajnimi (shih Tabelën 15).

Tabela 15. Programet e akredituara të trajnimit që ofrohen nga qendrat burimore

Trajnim i akredituar	Dr. Xheladin Deda, Pejë	Nëna Terezë, Prizren	Përparimi, Prishtinë	Lef Nosi, Prizren	Nëna Terezë, Mitrovicë
Planet e Individualizuara Arsimore	X		X	X (dhe në gjuhën boshnjake)	X
Prodhimi i materialeve për mësimdhënie dhe mësim-nxënie			X		X
Metodologjia e mësimdhënies			X		
Arsimi gjithëpërfshirës					X
Fusha e NVA-së dhe karakteristikat në punën me nxënësit me NVA				X	
Fëmijët me autizëm				X	
Gjithëpërfshirja dhe mjedisi mësimor për gjithëpërfshirje				X	
Karakteristikat e dhe strategjitë e mësimdhënies për fëmijët me NVA				X	
Vështirësitë në të nxënë				X	
Mësimi i Braille-it	X				
Karakteristikat e fëmijëve me dëmtime pamore	X				
Intervenimi i hershëm	X				
Trajnim për orientimin dhe mobilitetin	X				
Përdorimi i TIK-ut për të verbrit	X				
Trajnime TESFA		X			
Trajnim i avancuar në TESFA		X			

Qendrat burimore, me fushën e tyre të specializimit, numrin e nxënësve në shkolla speciale dhe të mbështetur në klasat e zakonshme, numrin e mësimdhënësve dhe mësimdhënësve udhëtues dhe numrin e ditëve të trajnimit të parashikuara për mësimdhënësit



e shkollave të zakonshme dhe prindërve janë paraqitur në Tabelën 16.

Tabela 16. Informacionet e qendrave burimore në 2014 - 2015 të ofruara nga DANV, MASHT

Qendra Burimore	Nr.i nxënësve në shkolla speciale	Nr i nxënësve të mbështetur në shkollat e rregullta nga mësimdhënësit 2014 -2015 (të dhënat e mbledhura nga DANV, MASHT)	Nr i mësimdhënësve	Nr i mësimdhënësve udhëtues	Nr. i ditëve të trajnimit të ofruar
Dr. Xheladin Deda, Pejë	34	36	37	2	Nuk ka pasur trajnime këtë vit
Nëna Terezë, Prizren	79	36	21	1	12 ditë 30 mësimdhënës
Përparimi, Prishtinë	134	35	34	2	35 ditë 108 mësimdhënës
Lef Nosi, Prizren	87	33	16	2	6 ditë 58 mësimdhënës
Nëna Terezë, Mitrovicë	68	15	17	2	11 ditë 75 mësimdhënës
Gjithsej	402	155	125	9	

Aktualisht qendrat burimore, funksionojnë kryesisht ende si shkolla speciale. Shkollat e rregullta nuk janë të vetëdijshme për funksionet e qendrave burimore dhe kështu ato nuk po marrin mbështetjen që iu nevojitet.

Mësimdhënësit udhëtues nuk janë duke i vizituar shkollat dhe mbështetur nxënësit dhe mësimdhënësit në mënyrë të mjaftueshme. Mësimdhënësit lëndorë dhe klasorë të shkollave të zakonshme kanë nevojë për këshilla dhe trajnime se si të përfshihen nxënësit me NVA në klasë.

Si shembull i qendrës burimore që ka zhvilluar praktika të mira në një për të ofruar mbështetje për shkollat e rregullta është qendra burimore Lef Nosi në Prizren. Shkolla speciale në qendren burimore është specializuar për nxënësit më dëmtime intelektuale dhe neurologjike, si për shembull me autizëm. Aktualisht, Qendra Burimore Lef Nosi në Prizren:

- Është duke ofruar përkrahje për mësimdhënësit, prindërit, shkollat dhe mbi të gjitha, nxënësit;
- Është duke ofruar trajnime për mësimdhënësit e shkollave të zakonshme që kanë nxënës me NVA (trajnime të akredituara: Përdorimi i PIA-s, fushat e aktivitetit, autizëm, TESFA/DShEGj, (përdorimi i PIA-s dhe autizmit në gjuhën boshnjake);

- Ka krijuar një ekip për të prodhuar materiale që u përgjigjen kërkesave të mësimdhënësve të shkollave të zakonshme (p.sh. për lëndët mësimore, shkronjat, për të zhvilluar aftësitë motorike, materiale të komunikimit, foto);
- Ka krijuar një ekip pedagogjik të vlerësimit për të vlerësuar të gjithë nxënësit në shkollën speciale për të identifikuar nëse integrimi në shkolla të rregullta është i mundur në çdo gjashtë muaj;
- Është duke punuar në ngritjen e vetëdijes në Prizren
- Po bashkëpunon me shkollën speciale shqiptare në Shkodër.

4.4.1.6. Gjuha e shenjave dhe sistemi Brail (Braille)

Ligji për Arsimin Parauniversitar në nenin 43 përcakton normat për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe sistemin Brail (Braille) si vijon:

- Nxënësve dhe fëmijëve të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë, duhet t'u ofrohet mësimdhënie për përdorimin e gjuhës së shenjave edhe përmes medimeve të gjuhës së shenjave.
- Ministria mund të vendosë që mësimdhënia nëpërmjet gjuhës së shenjave dhe për përdorimin e gjuhës së shenjave të ofrohet në një lokacion jashtë institucionit të zakonshëm të nxënësve.
- Nxënësit me të parë të pjesshëm dhe ata të verbër kanë të drejtën që të mësohen për përdorimin e alfabetit Breacill, si dhe për ndihmat teknike të nevojshme. Nxënësit e fillë kanë gjithashtu edhe të drejtën për orientimin e nevojshëm dhe për udhëzime gjatë lëvizjes në shkollë, vajtjen dhe kthimin nga shkolla dhe në shtëpi.
- Para dhënies së mësimi përmes gjuhës së shenjave, në alfabetin Brail dhe udhëzimeve për orientim dhe lëvizje, ose ndonjë trajnimi sipas këtij neni, ekipi komunal vlerësues i përbërë prej ekspertëve, i themeluar sipas këtij ligji, bën një vlerësim të aftësive të kufizuara të nxënësit, si dhe nevojat e tij për qasje.

4.4.1.7. Arsimimi i të verbërve

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve (SHKSH), me mbështetjen e Shoqatës Finlandeze të të Shurdhërve (SHFSH) (FAD) ka realizuar një program trajnimi dyvjeçar për asistentët e klasës dhe instruktorët e gjuhës së shenjave (AKIGjSh) me 120 ECT, kontraktuar dhe bashkë-financuar nga MASHT-i. Si rezultat i kësaj, 15 trajnerë të gjuhës së shenjave për të shurdhër dhe asistentë shkollor ishin certifikuar nga MASHT-i në maj të vitit 2015 dhe 10 prej tyre do të fillojnë punën në fillim të vitit 2016. Përveç kësaj, është zhvilluar kurrikula për trajnimin e gjuhës së shenjave si gjuhë e huaj për të rriturit me 60 ECTS.

Planet e mëtejshme për arsimimin e të shurdhërve përfshijnë zhvillimin e kriterëve si për kualifikimin e mësimdhënësve ashtu edhe për implementimin e arsimimit të të shurdhërve me perspektivë të arsimit gjithëpërfshirës. Kriteret e kualifikimit të mësimdhënësve përfshijnë 60 ECTS, gjuhën e shenjave të Kosovës dhe trajnimin në metodën e mësimdhënies së të dy gjuhëve (paketa e trajnimit do të zhvillohet dhe zbatohet më vonë). Kriteret në zbatimin e arsimimit të të shurdhërve me perspektivë të arsimit gjithëpërfshirës përcaktojnë kornizën për arsimin gjithëpërfshirës për të shurdhër. Të dy kriteret janë të ndara, edhe pse të afërt me njëri-tjetrin. Arsimimi dygjuhësh për nxënësit e shurdhër kërkon zhvillimin e një kurrikule dhe programi të trajnimit për “gjuhën e shenjave si gjuhë amtare” me mësimdhënës që kanë gjuhën e shenjave gjuhë amtare si trajnerë. Programi për AKIGjSh dhe programe të tjera të trajnimit që lidhen me arsimin e të shurdhërve do të akreditohen në Universitetin e Prizrenit. Për më tepër, personat e trajnuar, që kanë gju-



hën e shenjave si gjuhë amtare duhet të përfshihen si ekspertë në vlerësimin e arsimit të të shurdhërve dhe kompetencave të mësimdhënësve dhe nxënësve të shurdhër.

Rekomandimet MASHT

- Të forcohen kapacitetet e qendrave burimore për të siguruar mbështetje efikase dhe cilësore për shkollat e rregullta;
- Të mobilizohen qendrat burimore për të filluar trajnimin sistematik të të gjitha shkollave në arsimin gjithëpërfshirës. Qendrat burimore janë të autorizuara nga MASHT-i për të ofruar 16 kurse të akredituara në arsimin gjithëpërfshirës, nevoja të veçanta arsimore, përdorimin e PLA-ve dhe tema të tjera të ndërlidhura me shkollat, prindërit dhe anëtarët e komunitetit.
- Të planifikojë se si të krijojë një sistem të asistentëve shkollorë me trajnim në Kosovë;
- Të kuptohet roli i veçantë i nxënësve të shurdhër në sistemin arsimor, ata përfaqësojnë një minoritet gjuhësor dhe rezultatet e tyre të të nxënësve varen tërësisht nga gjuha në të cilën mësojnë. Ata kanë nevojë për një mjedis mësimor me gjuhën e shenjave për të arritur rezultate të mira. Nxënësit e shurdhër duhet të kenë klasat e tyre me mësimdhënës që e njih rrjedhshëm gjuhën e shenjave ose, në rastin e përfshirjes, përkthyes të gjuhës së shenjave me orar të plotë, apo asistent shkollor.

Qendrat burimore

- Regjistrimi në shkollë speciale duhet të ulet dhe të përqendrohet më shumë në ofrimin e shërbimeve për shkollat e rregullta;
- Të punësohen ose emërohen më shumë mësimdhënës udhëtues për të kontribuar më shumë në shkollat e rregullta;
- Të përfshihen të gjithë mësimdhënësit e qendrave burimore në ofrimin e mbështetjes së tyre për shkollat e rregullta;
- Të bëhen më të dukshme qendrat burimore në sistemin arsimor; shkollat dhe mësimdhënësit duhet të dinë se çfarë lloji të shërbimeve ata mund të presin dhe të marrin nga qendrat burimore;
- Të bashkëpunohet më shumë me shkollat e rregullta dhe të mobilizohen mësimdhënësit udhëtues për të komunikuar me shkollat e rregullta me qëllim të ofrimit të mbështetjes nxënësve me vështirësi në mësim-nxënie/aftësi të kufizuara dhe mësimdhënësve të tyre në shkollat e rregullta;
- Të forcohet roli i qendrave burimore si ofrues të shërbimeve mbështetëse (mbështetje të shkollave të rregullta, ofrimin dhe mundësimin e materialeve mësimore); tani për tani shumica e qendrave burimore funksionojnë kryesisht si shkolla speciale;
- Të mobilizohen mësimdhënësit e trajnuar që të fillojnë trajnime sistematike të të gjitha shkollave për arsimim gjithëpërfshirës dhe si të trajtohen NVA në shkolla të rregullta. Qendrat burimore i kanë 16 kurse të akredituara të cilat ato mund t'i ofrojnë për mësimdhënësit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit.
- Të bashkëpunohet lidhur me trajnimin e mësimdhënësve për të ofruar praktikë profesionale për studentet mësimdhënës në shkolla.



4.4.1.8. Fushat e veçanta të arsimit që duhet të zhvillohen në fushën e NVA-së

1. Vështirësitë në lexim dhe shkrim

Aftësitë e leximit dhe shkrimit janë themelore për mësim të mëtejshëm. Vlerësimet mbi përhapjen e vështirësive në lexim dhe shkrim ndryshojnë sipas kritereve të përdorura në përcaktimin e vështirësive në shkrim dhe lexim. Sipas Institutit Niilo Mäki, rreth 5% e nxënësve kanë vështirësi të tilla në lexim dhe shkrim që shkaktojnë probleme të rënda në mësim-nxënie.

Një nga sfidat më të mëdha në shkollat e Kosovës është se nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim janë kryesisht të paidentifikuar dhe kështu edhe pa mbështetje. Përkundër përpjekjeve për të adresuar këtë problem nga projektet finlandez FSDEKII dhe FSIESK, dhe USAID-it (të përshkruar më poshtë), problemi mbetet ende i pazgjidhur.

Në bashkëpunim me Institutin Niilo Mäki në Finlandë, FSDEK II në vitin 2007 - 2008 ka zhvilluar një mjet për vlerësimin individual të shkathtësive në lexim dhe shkrim dhe në vitin 2011 - 2012 FSIESK ka zhvilluar një mjet për vlerësimin e grupeve në lexim dhe shkrim për kontekstin e Kosovës. Në vitin 2011 - 2012 FSIESK ka realizuar një studim intervenimi në vështirësitë në lexim dhe shkrim në 8 shkolla me rreth 1700 nxënës. Katër prej shkollave kanë punuar si shkolla model të cilat mbështeteshin me trajnimin e mësimeve për të përdorur mjetin e ekzaminimit, për të prodhuar materiale alternative mësimore, për të organizuar mësimin plotësues dhe për të themeluar klubet e leximit në shkolla. Katër shkollat e tjera kanë punuar si shkolla të kontrollit. Rezultatet treguan se mbështetja e dhënë nëpërmjet klubeve të leximit është efektive për nxënësit që kanë vështirësi në lexim dhe shkrim. OJQ-ja "Shoqata e Kosovës për Promovimin e Arsimit Gjithëpërfshirës" ka vazhduar këtë mbështetje pas përfundimit të FSIESK dhe aktualisht është në procesin e fillimit të mbështetjes së 34 pilot shkollave fillore të projektit të Binjakëzimit.

Në vitin 2012, Programi i USAID-it për Arsim Themelor ka zhvilluar një mjet për Vlerësimin e leximit në klasë të hershme (EGRA) në gjuhën shqipe i cili u mundëson mësimeve për të diagnostikuar pikat e forta dhe dobësitë e nxënësve individualë. EGRA është test i thjeshtë individual për aftësitë e leximit, i projektuar për t'u realizuar në klasat 1-3. Ai përmban nën-teste për vetëdijësimin fonematik, njohuri për shkronjat, emrat / njohuri të tingujve, lexim të fjalëve të njohura, rrjedhshmëri të leximit dhe të kuptuarit e leximit, të kuptuarit e dëgjimit dhe diktimit.

Në vitin 2012, USAID-i ka realizuar studimin "Vlerësimi i leximit në klasat e hershme" - VLKH (EGRA) në 40 shkolla - rurale dhe urbane. 800 nxënës të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga klasa e dytë ishin testuar në fund të vitit shkollor. Në vitin 2013 mësimeve janë trajnuar dhe pajisur me materiale; libra leximi për klasat e para dhe të dyta, "mini-libra" të cilat nxënësit mund t'i presin, kapin, vizatojnë, ngjyrosin dhe lexojnë, dhe "libra të mëdha", që mund të përdoren për të gjithë grupin. Testimi i dytë u realizua në vitin 2014. Rezultatet e studimit tregojnë se deri në fund të klasës së dytë:

- ka shumë pak që nuk dinë të lexojnë në shkollat publike të Kosovës;
- pothuajse të gjithë nxënësit kanë njohuri themelore fonematike dhe njohuri të shkronjave dhe shqiptimit të tyre;
- shumica e nxënësve kanë një nivel të arsyeshëm të aftësive deshifruese dhe pak fjalor pamor;
- rreth gjysma e të gjithë nxënësve të testuar nuk ka arritur nivel të pranueshëm të



rrjedhshmërisë në të folur për nivelin e tyre të klasës;

- rreth katër nga dhjetë kanë mund t'u përgjigjen pyetjeve të të kuptuarit në nivel shumë më të ulët, marrjen e informacionit të deklaruar në mënyrë eksplicite.
- rreth një e treta e nxënësve kanë lexuar në nivel të kënaqshëm, dhe një e katërta kishte një nivel të mjaftueshëm të fjalorit pamor, aftësi deshifrimi, rrjedhshmëri në të folur dhe të kuptuarit për të sugjeruar se ata mund të jenë në rrugë të duhur për të arritur nivelin e dëshiruar;
- rreth katër në dhjetë ishin në rrezik të qartë të dështimit për të arritur nivelin e kërkuar bazik të aftësive.

Sipas rezultateve të studimit, duket se mësimdhënia duhet të mbajë përgjegjësi të konsiderueshme për situatën. Disa mësimdhënës, të paktën, i kanë dhënë rëndësi të madhe aftësive themelore të deshifrimit dhe diktimit, por shumë më pak zhvillimit të rrjedhshmërisë dhe të kuptuarit.

2. Arsimimi i të shurdhërve dhe të verbërve

Të qenit i/e verbër dhe i/e shurdhër është një kombinim i humbjes së të pamurit dhe mungesës së dëgjimit. Shumica e të shurdhërve dhe të verbërve mbajnë një shkallë të dëgjimit dhe/ose kapacitetit vizual, por fëmijët që janë pa këtë shkallë të të pamurit apo dëgjimit, apo që kanë lindur të shurdhër dhe të verbër mësojnë vetëm nga ajo që ata bëjnë. Në çdo rast, verbëria dhe shurdhëria shkakton komunikim të rëndë dhe nevojë të tjera zhvillimore dhe fëmijët e shurdhër dhe të verbër nuk mund të vendosen në program special vetëm për fëmijët e shurdhër apo fëmijët e verbër. Është i nevojshëm arsimimi për të shurdhër dhe të verbër në mënyrë që ata të jenë në gjendje të komunikojnë me të tjerët dhe të mësojnë. Sistemi arsimor i Kosovës nuk është i përgatitur për arsimimin e fëmijëve të shurdhër-verbër.

Arsimimi i të verbër-shurdhërve <http://www.deafblindinfo.org>

3. Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale të shumëfishta dhe të rënda

Fëmijët me kombinim të aftësive të kufizuara intelektuale të shumta dhe të rënda mungojnë në sistemin arsimor në Kosovë. Ata janë fëmijë kapacitetet kognitive të të cilëve nuk janë të mjaftueshme për të mësuar ndonjë lëndë dhe ata kanë nevojë për kujdes të përditshëm të specializuar dhe individual. Megjithatë, ata kanë të drejtë për arsimim dhe përmes programeve mësimore sipas fushave të aktiviteteve që planifikohen për secilin nxënës, ata mund të mësojnë shkathtësitë motorike, sociale, kognitive apo njohëse, komunikuese dhe aftësitë e përditshme të jetesës.

Një shkollë e vogël speciale "Shpresa", vetëm me dy klasa në Shtime është e vendosur ngjitur me institucionin e Shtimes për personat me dëmtime intelektuale. Dy mësues janë duke punuar me 14 nxënës me dëmtime të rënda intelektuale. Nxënësit vijnë nga familje shumë të varfra dhe kryesisht nga familje me një prind. Shkolla është duke luftuar me burime shumë të kufizuara njerëzore dhe materiale. Nuk ka asistentë shkollorë dhe mësimdhënësit e kalojnë kohën duke bërë përpjekje të mëdha për të mirën e tyre vetëm për t'i mbajtur nxënësit në klasë dhe për tu kujdesur për sigurinë e tyre. Nxënësit mbahen në shkollë pa program të përshtatshëm trajnimi. Aktualisht DANV bashkë me shkollën janë duke bërë përpjekje që të përmirësojë situatën, mirëpo për shkak të kufizimeve financiare është e vështirë të zbatohen përmirësimet e planifikuara.



Aktualisht, DANV është duke përgatitur një program për mësim sipas fushave të aktivitetit që do të jenë të përshtatura individualisht për nevojat e çdo nxënësi. Arsimitimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale të shumëfishta dhe të rënda gjithmonë kërkon ndihmë individuale. Prandaj, kur planifikohet mësimi sipas fushave të aktivitetit, gjithashtu duhet të planifikohet se si të organizohen asistentët shkollorë për këta nxënës.

Aktualisht, DNVA është duke përgatitur një program për mësim sipas fushave të aktivitetit që do të jenë të përshtatura individualisht për nevojat e çdo nxënësi. Arsimitimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale të shumëfishta dhe të rënda gjithmonë kërkon ndihmë individuale. Prandaj, kur planifikohet mësimi sipas fushave të aktivitetit, gjithashtu duhet të planifikohet se si të organizohen asistentët shkollorë për këta nxënës.

4. Asistentët shkollorë

MASHT ka lëshuar Udhëzimin administrativ për kriteret e përzgjedhjes së asistentëve dhe instruktorëve shkollor dhe obligimet e tyre për arsimin gjithëpërfshirës (UA Nr. 12/2012) i cili përmban përshkrimin e përgjegjësiave të asistentëve shkollorë, dhe detyrave të shkollës dhe asistentëve dhe instruktorëve të gjuhës së shenjave (Shtojca 7). Megjithatë, me vetëm pak përjashtime, nuk ka asistentë shkollorë në Kosovë, dhe ekziston nevojë urgjente për zhvillimin e një sistemi për trajnimin dhe punësimin e asistentëve shkollorë. Më poshtë janë përshkruar përvojat e punësimit dhe trajnimit të asistentëve shkollorë në Finlandë.

Asistentët shkollorë e kanë një rol të rëndësishëm në sistemin arsimor gjithëpërfshirës. Në Finlandë rëndësia dhe vlera e punës së tyre mund të shihet në numrin e shtuar të asistentëve shkollor të punësuar gjatë 15 viteve të fundit, dhe në përpjekjet e Bordit Kombëtar të Arsimit të Finlandës për krijimin e sistemit të trajnimeve të cilësisë së lartë të bazuara në kompetenca dhe sistemit kualifikues për asistentët shkollor.

Sot, shumica e shkollave fillore dhe të mesme i kanë asistentët shkollorë në Finlandë. Në qytetin Espoo në vitin 2014-2015 kishte 576 asistentë shkollorë dhe 25020 nxënës. Asistentët shkollorë punojnë në të gjitha nivelet arsimore në klasat e zakonshme, klasat speciale, institucionet parashkollorë dhe klubet e paradites dhe pasdites që janë kryesisht për klasat e 1ra dhe 2ta.

Qëllimi kryesor i asistentëve shkollor është që të ndihmojnë dhe mbështesin nxënësit gjatë procesit mësimor. Puna përfshinë të gjitha llojet e detyrave të cilat e bëjnë arsimimin të qashtëm dhe në dispozicion për të gjitha llojet e nxënësve.

Asistentët shkollorë punojnë në të gjitha nivelet e arsimit dhe shumica e shkollave fillore dhe të mesme kanë së paku një asistent shkollor. Përshkrimet e punës së tyre ndryshojnë shumë në varësi të nivelit të arsimit dhe llojit të organizimit (i përgjithshëm apo special), ata punojnë në llojin e vendit të punës për të cilin janë punësuar. Asistentët shkollor mund të punësohen si asistent të përgjithshëm në klasë ose në shkollë dhe si asistent personal. Asistentët e përgjithshëm i mbështesin të gjithë nxënësit në klasë që kanë nevojë për përkrahje gjatë mësimit. Ata mund të shërbejnë vetëm në një klasë ose ata mund të punojnë gjatë ditës në disa klasë varësisht nga nevojat. Asistenti personal shkollor i mbështetë vetëm nxënësit të cilët kanë të drejtë për ndihmën e tillë. Këta nxënës mund të kenë aftësi të kufizuara të shumëfishta ose aftësi të kufizuara që shkakton sfida të atilla në mësim për të cilat ndihma është e nevojshme. Nxënësit me asistencë personale zakonisht kanë nevojë për mbështetje shumicën e kohës dhe në shumicën e aktiviteteve në shkollë.



Përshkrimet e punës dhe praktikat e përbashkëta që lidhen me asistentin shkollor ndryshojnë nga shkolla në shkollë, nga vendi i punës në vendin e punës, dhe nga klasa në klasë, sepse nevojat e shkollave gjithmonë varen nga nevojat aktuale dhe të ndryshme të nxënësve në shkollë dhe në klasë. Bashkëpunimi dhe ndarja e punës ndërmjet mësimit dhe asistentit shkollor ndryshojnë dhe pajtohen për secilin rast veç e veç në mes të mësimit dhe asistentit shkollor. Bashkëpunimi dhe komunikimi i mirë midis asistentit shkollor dhe mësimit është i rëndësishëm për përvojat e të mësuarit të suksesshëm dhe rezultatet në klasë.

Arsimimi i asistentëve shkollorë në Finlandë

Arsimimi i asistentëve shkollorë në Finlandë është i rregulluar dhe monitorohet nga Bordi i arsimit i cili e ka siguruar kurrikulën kombëtare me kualifikimet kryesore profesionale, kompetencat dhe kriteret për vlerësim. Kualifikimet sikur në përgjithësi në arsimimin për të rritur në Finlandë janë të bazuara në kompetenca.

Kurrikula kombëtare e kualifikimeve profesionale për asistentët shkollorë përbëhet nga 4 module si në vijim:

- Puna si profesionist;
- Mbështetja në rritje dhe zhvillim;
- Mbështetja dhe udhëzimi në mësim; dhe
- Mbështetja për nxënësit me NVA.

Secili nga modulet përmban studime teorike dhe trajnim praktik në këtë fushë. Në fund të çdo moduli bëhet vlerësimi i kompetencave në një mjedis autentik (klasa të shkollave të përgjithshme, klasa speciale, institucione të arsimit në fëmijërinë e hershme, klube të paradites dhe pasdites) ku kualifikimet e fituara prezantohen tek një ekip i vlerësimit. Ekipi i vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë: një përfaqësues nga menaxhmenti i institucionit, një mësimit ose një asistent i kualifikuar i shkollës, dhe një përfaqësues i institutit të trajnimit. Bordi Kombëtar i Arsimit e rregullon dhe e monitoron vlerësimin, siguron dhe mban regjistrin e certifikatave për asistentë shkollorë.

Asistentët shkollorë të kualifikuar mund të vazhdojnë kualifikimet e tyre për kualifikimin specialist, i cila përmban dy pjesë të detyrueshme dhe një nga tre module opsionale si më poshtë:

Modulet e detyrueshme

- 1) Mbështetja dhe promovimi i mirëqenies dhe pjesëmarrjes
- 2) Koordinimi dhe zhvillimi i udhëzimeve për shkollimin dhe aktivitetet e paradites dhe pasdites; dhe Modulet opsionale (njëri nga ata):
- 3) Funksionaliteti dhe kreativiteti në udhëzimin e fëmijëve dhe të rinjve;
- 4) Udhëzimi në aktivitetet e kohës së lirë të fëmijëve dhe të rinjve;
- 5) Puna në ambiente shumë-kulturore

Institucionet profesionale janë duke ofruar trajnime përgatitore për asistentë shkollorë, por vlerësimi përfundimtar i kompetencave bëhet nga grupi vlerësues. Trajnimi përgatitor për asistentë shkollorë zgjatë një vit kohë të plotë studimi. Një tjetër mundësi është që të merren kualifikimet përmes kontratës së zanatit, ku 80% e përgatitjeve për marrjen e kualifikimit merren në një vend të mirëfilltë të punës dhe 20% të sigurohen nga instituti profesional. Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit bëhet ashtu siç përshkruhet më sipër.

Planet individuale të studimit bëhen për çdo nxënës dhe kështu, bëhet i mundur përparimi individual. Kjo do të thotë që kompetencat e fituara përmes përvojës së punës



dhe / ose të studimeve të mëparshme në këtë fushë njihen dhe një kandidat mund të tregojë kompetencat dhe kualifikimet e saj / tij pa ndonjë trajnim përgatitor.

Ka edhe shumë infermiere praktike që punojnë si asistentë të shkollave dhe përgatitja e tyre arsimore (3 - 4 vjeçare), konsiderohet si kualifikim i pranueshëm për ndihmë në shkollë.

Rekomandimet

MASHT, DKA-të dhe shkollat

- Të fillojnë të fokusohen në atë se si të merren me vështirësitë në lexim dhe shkrim në shkolla;
- T'i trajnojnë mësuesit klasorë se si të përdorin mjete për të vlerësuar shkathtësitë e leximit dhe shkrimit të nxënësve, si t'i identifikojnë dhe mbështesin nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim;
- T'i shfrytëzojnë rezultatet e mira dhe përvojat e fituara nga klubet e leximit.

Rekomandimet

MASHT dhe Qendrat burimore

- Të organizojnë mësimdhënien sipas fushave të aktivitetit për nxënësit me aftësi të kufizuara të shumëfishta dhe të rënda intelektuale duke i trajnuar mësime dhënësit dhe duke alokuar burime njerëzore dhe materiale për mësimdhënie; nxënësit që mësojnë sipas fushave të aktivitetit duhet, në shumicën e rasteve, të kenë asistent personal të shkollës, pajisje të posaçme dhe pajisje ndihmëse. Asistenca e OJQ-ve dhe bashkëpunimi me OJQ-të lokale do të jenë të dobishme në përgatitjet dhe në zbatimin e mësimdhënies sipas fushave të aktivitetit;
- Të planifikojnë, në bashkëpunim me MASHT-in, se si të organizojnë arsimimin e të verbërve dhe të shurdhërve;
- Të planifikohet si të krijohet një sistem i asistentit të mësimdhënësit me trajnim në Kosovë;
- Të planifikojnë dhe organizojnë edukimin e fëmijëve të shurdhër dhe të verbër.



4.4.2. Mbështetja për nxënësit nga komunitetet pakicë

Ligji Nr. 03 / L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë (Neni 1.4.) përkufizon komunitetet si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës që nuk janë në shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, kroat dhe komunitete të tjera. Më tej, ligji përcakton se anëtarët e komunitetit shumicë në Kosovë që jetojnë në një komunë ku ata janë në pakicë kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat e radhitura në ligj.

4.4.2.1. Korniza ligjore për arsimin e fëmijëve nga komunitetet pakicë

Të drejtat e nxënësve nga komunitetet që kanë të bëjnë me arsimimin janë përcaktuar në Kushtetutë (2008) dhe ofrimi i arsimimit për pakicat në Republikën e Kosovës është i rregulluar në disa ligje të cilat janë të paraqitura në Shtojcën 8, dhe në udhëzimet administrative të nxjerra nga Qeveria. Gjithashtu Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011-2016 parasheh masat që duhen ndërmarrë për rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve në sistemin arsimor në të gjitha nivelet.

Ligji (Nr. 03 / L-047) për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë përcakton të drejtat e veçanta të komuniteteve të Kosovës në lidhje me identitetin e tyre, përdorimin e gjuhëve, medie, kulturës, fesë, arsimin, shëndetin, mundësitë ekonomike dhe sociale, si dhe përfaqësimin e tyre politik. Ligji thotë se të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin



shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës sipas zgjedhjes së tyre, dhe ata kanë të drejtë për arsimim parashkollor, fillor, të mesëm publik në gjuhën e tyre, edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare. (Neni 8.1).

Neni 8.7. thekson se Qeveria e Kosovës do të hartojë kurrikulat e integruara në gjuhët e komuniteteve që nuk janë gjuhë zyrtare, si dhe standardet arsimore për të gjitha aspektet e arsimit, dhe do të monitorojë dhe zbatojë cilësinë e ofrimit të arsimit në gjuhët e komuniteteve. Përveç kësaj, neni thotë se komunitetet duhet të kenë të drejtë në bashkëpunim me Qeverinë për të gjeneruar module arsimore lidhur me kulturën e vet, historinë dhe traditat e tyre.

Kurrikula arsimore kombëtare e Kosovës duhet të përfshijë historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve tradicionalisht të pranishme në vend, për të nxitur frymën e respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës ndërmjet të gjitha komuniteteve në Kosovë, dhe organizatat përfaqësuese të komuniteteve duhet të konsultohen në procesin e hartimit të një kurrikule të tillë (Neni 8.12).

Udhëzimet administrative në vijim janë lëshuar nga MASHT:

- UA Nr. 37/2009 për Komisionin e pavarur për rishikimin e Materialeve mësimore në gjuhën serbe;
- UA Nr. 7/2010 për miratimin e Kurrikulës rrome në kuadër të sistemit të institucioneve arsimore të Kosovës. ;
- UA Nr. 07/2010 për zbatimin e programeve të rishikuara të punës për lëndën: Gjuhë rrome me elemente historike dhe kulturore. ;
- UA Nr. 22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe proporcioni mësimdhënës – nxënës.

4.4.2.2. Arsimimi i nxënësve nga komunitetet pakicë

Në Kosovë nxënësit nga komuniteti serb janë të regjistruar në një sistem paralel në shkollat që mësojnë në gjuhën serbe, e ndjekin kurrikulën e Serbisë dhe i përdorin tekstet serbe të prodhuara dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit të Serbisë. Materiale mësimore që përdoren nga nxënësit serb në Kosovë nuk janë të përshtatura domosdoshmërisht për nevojat e komunitetit serb që jeton në Kosovë, dhe struktura e kurrikulës serbe është krejtësisht e ndryshme nga kurrikula e Kosovës. Kjo situatë nuk e lehtëson përfshirjen e nxënësve nga komuniteti serb në Kosovë. (Ndihma e BE-së për Kosovë.) Nxënësit nga komuniteti malazez gjithashtu e ndjekin sistemin e kurrikulës serbe dhe i ndjekin mësimet në gjuhën serbe (OSBE 2010).

Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e ligjit dhe e drejta e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për arsimim në gjuhën e tyre, komunat kanë themeluar siç është përcaktuar në ligj (Neni 8.1.) klasa ose shkolla që veprojnë në gjuhët e komuniteteve të caktuara. Nxënësit boshnjak integrohen shpesh në klasa shqiptare, por në shumë komuna i kanë klasat dhe shkollat e tyre. Nxënësit kroatë vijnë kryesisht nga komuna e Lipjanit dhe ata janë të regjistruar në klasat e tyre me mësimdhënësit e tyre kroatë. Komuniteti turk gjendet kryesisht në komunat e Prizrenit, Mamushës, Prishtinës dhe Lipjanit, dhe arsimit u ofrohet në shkolla apo klasa turke.

Shumica e anëtarëve të komunitetit të vogël goran jetojnë në komunën jugore të Dragashit. Shumica e tyre e konsiderojnë gjuhën gorane si gjuhën e tyre amtare, por ka edhe të tjerë që pretendojnë gjuhën serbe ose boshnjake si gjuhë të tyre zyrtare. Nxënësit goran, për shkak të numrit të tyre të vogël, në përgjithësi integrohen në sistemin arsimor të Kosovës, qoftë në gjuhën boshnjake, ku ekzistojnë këto klasa, ose më rrallë, në



gjuhën shqipe. Shumica e goranëve në Komunën e Dragashit preferojnë të regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollat e drejtuara nga Serbia, ku mësimi është në gjuhën serbe, e që ofron mundësi më të mëdha për regjistrim në Universitete serbe. (OSBE 2010.)

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë të përqendruara kryesisht në komunat Gjakovë, Fushë Kosovë, Prizren, Pejë dhe Ferizaj. Pjesa më e madhe e komunitetit rom jeton në komunën e Prizrenit; komuniteti ashkali është më i përqendruar në komunat e Fushë Kosovës dhe të Ferizajt, dhe një pjesë e madhe e komunitetit egjiptian jeton në komunën e Gjakovës dhe Pejës. (OSBE 2010.) Nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kryesisht shkojnë në shkolla në gjuhën shqipe, por edhe në klasa ose shkolla që e kanë gjuhën turke, boshnjake dhe serbe si gjuhë mësimore (Qeveria e Kosovës 2008). Shumica e ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë e konsiderojnë gjuhën shqipe si gjuhë amtare. Pjesëtarët e komunitetit rom janë përgjithësisht folës të gjuhës rome dhe / ose serbe dhe një pjesë e vogël e tyre flet shqip. Gjuha e përdorur në shkolla mbetet një sfidë për fëmijët që kanë gjuhën rome si gjuhë amtare, pasi që nuk ka shkolla në të cilat gjuha rome përdoret si gjuhë mësimore, ose ku është e mundur për të mësuar gjuhën rome.

Romët, ashkalitë dhe egjiptianët i përkasin komuniteteve më të varfra në Evropë (Qeveria e Kosovës 2008), dhe përkundër të drejtës për qasje të barabartë në arsim për të gjithë në Kosovë, fëmijët e këtyre komuniteteve kanë mbetur më të rrezikuara nga braktisja dhe ndarja nga dhe në sistemin arsimor. Ky kapitull përqendrohet në përpjekjet që synojnë përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në sistemin arsimor në Kosovë.

4.4.2.3. Sfidat e hasura në arsimimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Vështirësitë e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në përgjithësi dhe gjithashtu në lidhje me qasjen në arsim janë rritur gjatë zhvillimeve të vitet 1990 - ta dhe nga lufta në Kosovë, si rezultat i së cilës ka qenë zhvendosja e popullatës brenda dhe jashtë Kosovës. Këto komunitete kanë qenë të lidhura me statusin e tyre social-ekonomik dhe me fenomenin e marginalizimit, diskriminimit dhe ndarjes. (Qeveria e Kosovës, 2008)

Situata e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë është karakterizuar me pjesëmarrje të ulët në arsimin e obligueshëm, normat e larta të braktisjes veçanërisht në mesin e vajzave; pjesëmarrja e ulët në arsimin e lartë dhe universitet, veçanërisht në mesin e vajzave, diskriminimi me të cilin ballafaqohen nxënësit, mungesa e mësimdhënësve të gjuhës rome, ashkali apo egjiptiane; dhe mungesa e materialeve cilësore mësimore në gjuhën e tyre amtare. Faktorët prapa këtyre sfidave janë analizuar nga Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (2012) me disa reflektime të shtuara për situatën në vitin 2015 si vijon:

1) Vijimi i ulët dhe vijimi i parregullt

Sfidat kryesore në arsimimin e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë pjesëmarrja e ulët dhe e parregullt në arsimin e obligueshëm. Kjo ka rezultuar nga gjendja e dobët sociale-ekonomike e familjeve të tyre. Prindërit shpesh nuk janë në gjendje për të financuar shpenzimet që lidhen me arsimin, të tilla si libra dhe materiale të tjera shkollore, veshje e duhur dhe ushqim, dhe shumë fëmijë janë të detyruar të punojnë për të mbështetur familjet e tyre, shpesh në rrugë. Përveç kësaj ngacmimi, diskriminimi dhe vështirësitë me gjuhën e përdorur në shkolla i parandalon fëmijët të shkojnë në shkollë. Pjesëmarrja e ulët dhe e parregullt në arsimin e obligueshëm ndikon



në performancën e fëmijëve dhe shpesh çon në braktisje të shkollës.

Me qëllim të përmirësimit të situatës MASHT-i në bashkëpunim me OJQ-të ka siguruar mbi 500 bursa në vit për nxënësit në nivelin e arsimit të mesëm.

2) Shkalla e lartë e braktisjes së shkollës

Shkalla e braktisjes së shkollimit në mesin e fëmijëve nga komuniteti i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve është e lartë në arsimimin fillor në veçanti në klasat 5 dhe 6. Përveç kësaj, vetëm një numër i vogël i fëmijëve nga këto komunitete e vazhdon shkollimin e mesëm dhe, kështu numri i studentëve të këtyre komuniteteve në universitet është shumë i ulët. Shkalla e braktisjes së shkollimit është shumë e lartë në mesin e vajzave, si rezultat i martesave të hershme dhe perceptimit thellë të rrënjësive të roleve gjinore.

3) Regjistrimi i vonshëm dhe ndarja në klasa

Shumë fëmijë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian nuk regjistrohen në shkollë në moshën 6 vjeçare ose ata fillojnë me vonesë duke humbur muajt e parë të vitit shkollos. Regjistrimi i vonshëm e bën të vështirë për ta që t'i arrijnë shokët/shoqet e tyre të klasës. Regjistrimi me vonesë i fëmijëve nga këto komunitete mund t'i atribuohet shumë faktorëve:

- mungesa e vetëdijes së prindërve për procedurat e regjistrimit;
- mungesa e certifikatave të lindjes të nevojshme për regjistrim;
- mungesa e të kuptuarit të prindërve për rëndësinë dhe vlerën e arsimit formal për shkak të nivelit të ulët të arsimit të tyre;
- mungesa e perspektivave për kushte të përmirësuara të jetesës;
- arsyet sociale-ekonomike; dhe
- frika e diskriminimit dhe ngacmimit në shkolla.

Fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë të ndarë shpesh në klasat e tyre të veçanta dhe mbahen kështu gjatë tërë arsimit të tyre, gjë që ka ndikime negative në shanset e suksesit socio-ekonomik, performancën në shkollë dhe afinitetin me shoqërinë në përgjithësi, integrimin dhe stereotipat. Sipas QEÇP Kosova (2012) "raste të ndarjes janë identifikuar në mënyrë të përsëritur, që tregojnë një kronikë, dhe një dukuri jo të rastësishme", dhe në shumë raste edhe profesionistëve të arsimit edhe prindërve u mungon të kuptuarit e asaj se çka nënkupton diskriminimi dhe mjetet e efektet negative të ndarjes.

4) Performanca e dobët dhe ulja e standardeve

Vijimi i parregullt, regjistrimi i vonë dhe ndarja e pengojnë performancën e shumë fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptianë në shkollë dhe kjo më vonë mund të çojë në braktisjen e shkollës. Nxënësit shpesh kanë një mjedis të varfër mësimi në shtëpi dhe kanë mungesë të mbështetjes prindërore për detyrat e shtëpisë. Gjuha e mësimdhënies e përdorur në shkolla shpesh paraqet një pengesë shtesë sidomos për fëmijët rom dhe fëmijët familjet e të cilëve janë riatdhesuar ose kthyer me forcë nga Evropa Perëndimore dhe që flasin gjuhën që flitet në vendin prej nga janë kthyer.

Në shkolla, performanca e dobët akademike e nxënësve nga këto komunitete tolerohet shpesh dhe nxënësit vazhdojnë arsimimin e tyre pa përmbushjen e standardeve të aplikuar për shumicën. Ulja e standardeve inkurajon ndarjen, popullarizon perceptimin se nxënësit nga komunitetet pakicë nuk janë në gjendje të kenë performancë të mirë sikur shokët/shoqet e tyre, dhe kjo e dëmton vetëbesimin e tyre. (QEÇP Kosova 2012.)



Mungesa e arsimimit dhe materialeve në gjuhën rome

Kur fëmijët nuk mund të qasen në arsimin fillor në gjuhën e tyre amtare, ata janë në një pozitë të pafavorshme, e cila ka një ndikim në performancën e tyre akademike dhe mund të çojë në braktisjen e shkollimit. Kjo ndodhë veçanërisht në mesin e shumicës së nxënësve romë. Kurrikula për gjuhën, historinë dhe kulturën rome, për klasat 2-9 të shkollave fillore është hartuar, por ajo nuk është duke u zbatuar në të gjitha shkollat me nxënës romë. Përveç kësaj, ka mungesë të teksteve shkollore dhe mësimdhënësve të trajnuar. MASHT-i e ka adresuar problemin dhe aktualisht është duke e zgjeruar mësimdhënien në gjuhën rome.

5) Mungesa e përfaqësimit adekuat të komunitetit në personelin shkollor
Diversiteti në shkolla nuk reflektohet në personelin shkollor. Në vitin 2014 - 2015 në Kosovë ka pasur vetëm 50 mësimdhënës që përfaqësojnë komunitetet pakicë, 20 prej tyre nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Mungesa e përfaqësimit të komunitetit në personelin shkollor ndikon në perceptimin e fëmijëve se ata janë pjesë e shkollave, duke e kufizuar kështu përfshirjen dhe integrimin e tyre.

4.4.2.4. Përpjekjet për përmirësimin e arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Me qëllim të adresimit të sfidave të hasura dhe sigurimit të garantimit të së drejtës së arsimimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjitë dhe planin e veprimit në vijim:

- Strategjia për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Komponenti i arsimit 2007 - 2017 i miratuar në vitin 2007;
- Strategjia për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, 2009 - 2015 e miratuar në vitin 2008; dhe
- Plani i veprimit i Republikës së Kosovës për zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, 2009 - 2015.

Strategjia për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Komponenti i arsimit 2007 - 2017 u miratua nga Ministria e Arsimit para hartimit dhe miratimit të strategjisë së përgjithshme dhe planit të saj të veprimit. Megjithatë, objektivat dhe aktivitetet strategjike të përcaktuara në strategjinë për vitin 2007 - 2017 janë të përfshira në komponentin arsimor të strategjisë së përgjithshme dhe planit të saj të veprimit.

Strategjia dhe Plani i saj i veprimit synojnë në nxitjen e integritit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorët kyç të arsimit, punësimit dhe fuqizimit ekonomik, çështjet e shëndetësisë, strehimit dhe vendbanimeve joformale, kthimit dhe ri-integritit, regjistrimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit, sigurisë, policisë dhe drejtësisë, si dhe medie, kulturës dhe informimit. Gjinia dhe mos-diskriminim janë ancoruar në të gjithë sektorët kyç si tema ndër-sektoriale.

Strategjia përmban një analizë të kushteve dhe sfidave të veçanta me të cilat përballen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, ndërsa Plani i Veprimit përshkruan masa të detajuara dhe konkrete (Shtojca 10), që duhet të ndërmerren nga institucionet përkatëse të nivelit qendror dhe lokal për të adresuar sfidat e identifikuara. Plani i Veprimit përmban një afat kohor dhe parashikimet buxhetore për zbatimin e planit.

Qëllimet kryesore të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, 2009-2015 janë si më poshtë:



- Promovimi dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të integritit të plotë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare;
- Hartimi i politikave të duhura dhe legjislacionit, dhe të sigurohet që legjislacioni është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- Promovimi aktiv i fuqizimit të institucioneve demokratike dhe atyre të sundimit të ligjit, posaçërisht përmes dialogut dhe ndërtimit të institucioneve për zbatimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- Mbështetja dhe inkurajimi i punës së OJQ-ve që përfaqësojnë interesat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, sidomos bashkëpunimi me ta, duke përfshirë edhe Institucionin e Avokatit të Popullit

Qëllimi kryesor i komponentit të arsimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, 2009-2015 është që të krijojë një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe të cilësisë së lartë të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin që i kontribuon integritit të plotë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare.

Objektivat strategjik të përcaktuar në komponentin e arsimit të Planit të veprimit janë këta në vijim:

Objektivi 1: Përmirësimi i dukshëm i pjesëmarrjes në sistemin e arsimit dhe i cilësisë së arsimit për anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Objektivi 2: Parandalimi i diskriminimit dhe ndarjes në sistemin arsimor

Objektivi 3: Bashkëpunimi cilësor dhe efikas në mes të institucioneve dhe organizatave relevante drejt arsimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së komuniteteve dhe palëve të interesit për mbështetjen e arsimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ministritë në nivel qendror janë përgjegjës për zhvillimin dhe përshtatjen e legjislacionit, politikave dhe strategjive. Plani i Veprimit i identifikon Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) si tri institucionet kryesore përgjegjëse për realizimin e qëllimeve të parashikuara në sektorin e arsimit. Këto ministri janë përgjegjëse për promovimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe të cilësisë së lartë të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin, duke kontribuar kështu në integrimin e plotë në shoqëri të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (OSBE 2012.) Organet e nivelit qendror dhe mekanizmat përgjegjës për çështjet e pakicave janë paraqitur në Shtojcën 9.

Në nivel lokal, komunat kanë përgjegjësi për të zbatuar politikën dhe strategjitë në praktikë, dhe kështu zyrtarët komunal janë akterët kryesorë përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Komunal të Veprimit (PKV) të Strategjisë. Institucionet e nivelit lokal, organet, akterët dhe mekanizmat që kanë të bëjnë direkt apo indirekt me ofrimin e arsimit për komunitetet pakicë janë paraqitur në Shtojcën 9.

4.4.2.5. Doracaku për zyrtarët komunal për përmirësimin e ofrimit të arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Në vitin 2012, Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë (QEÇP Kosovë), me mbështetjen e UNICEF-it ka përgatitur një doracak për zyrtarët komunal për të përmirësuar ofrimin e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë në komunat e tyre. Doracaku ofron udhëzime dhe informata praktike, konkrete dhe hap-pas-hapi se si të zhvillohet, dhe zbatohet Plani Komunal i Veprimit (PKV) në zbatimin e komponentit të



arsimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Doracaku është ndërtuar mbi përvojat, mësimet e nxjerra dhe praktikat e mira të identifikuara nga zbatimi i projektit “Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Fushë Kosovës në vitin 2011 - 2012. (QEÇP Kosove 2012).

Doracaku e udhëzon procesin përmes gjashtë hapave kryesor:

- HAPI 1: Përcaktimi i objektivave të veçantë dhe aktiviteteve
- HAPI 2: Specifikimi i treguesve të matshëm
- HAPI 3: Aktivitetet buxhetore
- HAPI 4: Specifikimi i përgjegjësive për secilin veprim
- HAPI 5: Përcaktimi dhe adaptimi i afateve kohore
- HAPI 6: Dizajnimi i planit monitorues dhe vlerësues

Përveç kësaj, doracaku përmban një sërë shabllonësh dhe mjetesh të dobishme për të mbështetur zyrtarët komunalë në punën e tyre në përmirësimin e ofrimit të arsimit për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Doracaku mund të përdoret si mjet për ndërtimin e kapaciteteve nga komunat dhe organizatat e tjera që mbështesin ofrimin e arsimit për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (QEÇP Kosovë 2012).

4.4.2.6. Raportet për zbatimin e strategjisë dhe planit të saj të veprimit

Shumë raporte të publikuara (OSBE 2011, QEÇP Kosova 2012 dhe QAK (2014) për zbatimin e Strategjisë dhe planit të saj të veprimit nuk kanë dhënë një pasqyrë pozitive të progresit në zbatimin e strategjisë.

Në vitin 2012, QEÇP në Kosovë vuri në dukje se në komunat ku ishin miratuar PKV-të, zbatimi ishte shpesh jo i kënaqshëm ose i mangët për shkak të funksionalizimit të pamjaftueshëm të tyre, mungesës së alokimit të buxhetit dhe/ose monitorimit dhe vlerësimit. Prandaj, sipas QEÇP Kosovë “në mënyrë që një PKV të bëhet një mjet kuptimplotë udhëzues që mund të kontribuojnë në sigurimin e zbatimit të mirëfilltë dhe arritjen e rezultateve konkrete, është e rëndësishme që ai të jetë i lidhur me dokumentet e nivelit qendror dhe të këtë funksionalizim të mirëfilltë: “Aktivitetet duhet të jenë të detajuara dhe të buxhetuara në mënyrë adekuate, akterët përgjegjës si edhe afatet kohore dhe treguesit real të jenë të përcaktuar, me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit. ”

Në vitin 2012, QEÇP në Kosovë vuri në dukje se në komunat ku ishin miratuar PKV-të, zbatimi ishte shpesh jo i kënaqshëm ose i mangët për shkak të funksionalizimit të pamjaftueshëm të tyre, mungesës së alokimit të buxhetit dhe/ose monitorimit dhe vlerësimit. Prandaj, sipas QEÇP Kosovë “në mënyrë që një PKV të bëhet një mjet kuptimplotë udhëzues që mund të kontribuojnë në sigurimin e zbatimit të mirëfilltë dhe arritjen e rezultateve konkrete, është e rëndësishme që ai të jetë i lidhur me dokumentet e nivelit qendror dhe të këtë funksionalizim të mirëfilltë: Aktivitetet duhet të jenë të detajuara dhe të buxhetuara në mënyrë adekuate, dhe akterët përgjegjës të jenë të përcaktuar, si edhe afatet kohore dhe treguesit real me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit. ”

Në vitin 2014, Qendra për Arsim e Kosovës ka përgatitur një analizë të shkurtër të problemeve me të cilat sistemi arsimor në Kosovë është duke u përballur në të gjitha nivelet. Analiza u përqendrua në aktivitetet, politikat dhe prioritetet e zbatuara gjatë vitit 2013 - 2014 dhe kishte përfshirjen e komuniteteve në sistemin e arsimit si një çështje të ndërlidhur. QAK raporton se “deri më tani pak përparim është parë për shkak të problemeve të tilla si: mungesa e buxhetit, bashkëpunimi i kufizuar në nivel lokal dhe qendror

dhe koordinimi i pamjaftueshëm i të gjitha palëve". Sfidat kryesore të identifikuara nga QAK janë si më poshtë:

- faktorët ekonomik duke përfshirë edhe varfërinë e skajshme;
- pengesat administrative në regjistrimin e fëmijëve, sidomos atyre që kthehen nga rajoni apo nga vendet perëndimore;
- nevoja e dukshme për të trajnuar mësimdhënësit lidhur me paragjykimet dhe diskriminimin për shkak të një numri të madh të rasteve të raportuara për shkak të qasjes neglizhuese ndaj nxënësve të komunitetit rom, ashkali, dhe egjiptian (QEÇP 2012);
- me gjithë progresin e bërë në dhjetë vitet e fundit, numri i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali, egjiptian që nuk e ndjekin arsimin e detyrueshëm është ende shumë i lartë, ndërsa pjesëmarrja në arsimin e mesëm është shqetësuese;
- një numër shumë i vogël i fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian e vijojnë arsimin parashkollor;
- edhe pse ka kuota për nxënësit, numri i nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është ende shumë i ulët;
- MASHT e menaxhon një fond bursash për komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian, por shumica e këtij fondi është nga donatorët e jashtëm e jo nga Qeveria e Kosovës

4.4.2.7 Prejardhja etnike e nxënësve

Siç prezantohet në Kapitullin 4.2., 96 % e të gjithë nxënësve në arsimin parauniversitar në vitet 2014 -2015 janë shqiptarë. Në nivelet e ndryshme të arsimit përkatësia etnike është si në vijim:

- në arsimin parashkollor 98,7 % e fëmijëve janë shqiptarë dhe 1,3 % janë nga grupet e tjera etnike;
- në arsimin parafillor 96.3 % janë shqiptarë dhe 3.7 % janë nga grupet e tjera etnike;
- në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët 95.5 % janë shqiptarë, 4.5 % janë nga grupet e tjera etnike; dhe
- në arsimin e mesëm të lartë 98 % janë shqiptarë, 2 % janë nga grupet e tjera etnike.

Tabela 17 tregon numrin e nxënësve sipas origjinës etnike në nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar në vitet 2013 – 2014 dhe Tabela 18 në vitet 2014 -2015. Tabelat tregojnë se nuk ka pasur ndonjë përmirësim të dukshëm lidhur me regjistrimin dhe integrimin e fëmijëve rom.

Tabela 17. Numri i nxënësve sipas origjinës etnike në nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar në vitet 2013 – 2014.

Origjina etnike	Niveli parashkollor	Niveli parafillor	Niveli fillor dhe i mesëm i ulët	Niveli i mesëm i lartë	Gjithsejtë
Shqiptar	3737	20644	266147	97504	388032
Serb	14	10	381		405
Turq	8	109	1876	568	2561
Boshnjak	10	243	3224	1121	4598
Goran		69	566	8	643
Ashkali		218	3766	221	4205
Rom	4	43	1945	64	2056



Egjiptian		35	663	90	788
Kroatë		12	31		43
Të tjerë			9	2	11
Gjithsej	3773	22154	278608	99578	403342

Tabela 18. Numri i nxënësve sipas originës etnike në nivelet e ndryshme të arsimit parauniversitar në vitet 2014 - 2015.

Origjina etnike	Niveli parashkollor	Niveli parfillor	Niveli fillor dhe i mesëm i ulët	Niveli i mesëm i lartë	Gjithsej
Origjina etnike	3724	21334	261468	81545	368071
Shqiptar	28	14	385	195	622
Serb	10	194	1842	670	2716
Turq	7	227	3141	959	4334
Boshnjak		75	587	5	667
Goran		200	3766	211	4177
Ashkali	5	77	1785	51	1918
Rom		28	642	102	772
Egjiptian		5	26		31
Kroatë			7	5	12
Të tjerë	3774	22154	273649	83743	383320

Në vitin shkollor 2014/2015, kishte 6867 nxënës nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar e që është 1,81 % e numrit të përgjithshëm të regjistruarve.

4.4.2.8. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë Sondazh i gamës së treguesve të shumëfishtë (SGTSH/MICS)

Në vitin 2013 - 2014, Agjencia e Statistikave të Kosovës, e mbështetur nga UNICEF-i, ka kryer sondazhin e gamës së treguesve të shumëfishtë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian*(MICS), si pjesë e programit botëror MICS. Programi global MICS është zhvilluar nga UNICEF-i në vitet 1990 si një program ndërkombëtar i anketimeve të ekonomive familjare për të mbledhur të dhëna të krahasueshme në nivel ndërkombëtar në një gamë të gjerë të treguesve për gjendjen e fëmijëve dhe grave. Sondazhet e MICS i kanë matur treguesit kryesorë që i lejojnë vendet të gjenerojnë të dhëna për përdorim në politika dhe programe, dhe për të monitoruar progresin drejt Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) dhe angazhime të tjera të pranuar ndërkombëtarisht.

Sondazhi MICS për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë ofron:

- informata të azhurnuara për vlerësimin e gjendjes së fëmijëve, grave dhe burave të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian dhe sigurimin e të dhënave për monitorimin e strategjive dhe planeve të veprimit ekzistuese për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian,

- të dhëna për dizajnimin e intervenimeve të programeve të ardhshme dhe planifikim të mbështetjes bazuar në dëshmi të institucioneve të Kosovës.
- të dhëna për informim rreth aspiratave të Kosovës për në BE dhe planifikimin në procesin e zgjerimit të BE-së duke kontribuar në cilësinë e përmirësuar në statistika, mbledhjen e të dhënave, sistemet e menaxhimit dhe monitorimit

Tabela 19 siguron informata lidhur me vijimin e arsimimit në moshë të hershme, mbështetjen për mësim në shtëpi, librat dhe lodrat e fëmijëve në dispozicion, kujdesin jo adekuat dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve të moshës 36 – 59 muaj nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Tabela 19. Zhvillimi i fëmijëve në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë statistikat MICS (2014)

Emri i treguesit	Përshkrimi	Vlera
Vijimi i arsimimit në moshë të hershme	Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh të cilët e vijnë programin e arsimimit të fëmijërisë së hershme	16.1
Mbështetja për mësim	Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh me të cilët një i rritur është angazhuar në katër apo më shumë aktivitete për promovimin e mësimin dhe gatishmërisë për shkollim në 3 ditët e fundit	40.7
Mbështetja e babait për mësim	Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh, babai biologjik i të cilëve është angazhuar me ta në katër apo më shumë aktivitete për promovimin e mësimin dhe gatishmërisë për shkollim në 3 ditët e fundit	7,0
Mbështetja e nënës për mësim	Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh nëna biologjike e të cilëve është angazhuar me ta në katër apo më shumë aktivitete për promovimin e mësimin dhe gatishmërisë për shkollim në 3 ditët e fundit	20,5
Disponueshmëria e librave për fëmijë	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare të cilët kanë tre apo më shumë libra për fëmijë	6,0
Disponueshmëria e lodrave	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare të cilët luajnë me dy apo më shumë lloje lodrash	68,6
Kujdesi jo-adekuat	Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare të cilët janë lënë vetëm ose nën përkujdesjen e një fëmije tjetër nën moshën 10 vjeçare për së paku një orë javën e kaluar	12,5
Indeksi i zhvillimit të hershëm të fëmijës	Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muaj të cilët janë duke u zhvilluar mirë së paku në katër fushat në vijim: njohja e shkronjave–numrave, fizikisht, në fushën socio-emocionale, dhe që janë në gjendje të mësojnë	77,2



4.4.2.9. Praktikrat e mira të fituara përmes projekteve për mbështetjen e arsimimit të komuniteteve pakicë

Një numër i organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare e kanë mbështetur arsimimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes disa programeve të cilat janë paraqitur në Shtojcën 3. QAK (2014) thekson se këto organizata veprojnë në mënyrë të pavarur nga sistemi i arsimimit formal dhe janë tërësisht të varura nga donacionet, gjë që e ven qëndrueshmërinë e tyre në rrezik. Megjithatë, kontributi i projekteve është i madh, për shkak se ata kanë prodhuar shumë materiale të trajnimit, praktika të mira të bazuara në dëshmi, si dhe doracakë e mjete për të punuar me to. Donatorët/akterët kryesor në këtë fushë kanë qenë Save the Children, UNICEF, OSBE, QEÇP e Kosovës, Këshilli i Evropës dhe shumë OJQ lokale si Balkan Sunflowers, Iniciativa 6 dhe Ideas Partnership. Projektet janë paraqitur në Shtojcën 3 dhe disa nga praktikrat e mira të fituara përmes këtyre projekteve janë paraqitur më poshtë.

Programi për avokimin e strategjisë që zbatohet nga Balkan Sunflowers synon në rritjen e vetëdijes dhe kapaciteteve të zyrtarëve komunal për zbatimin e "Strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian" në 9 komuna. Projekti synon gjithashtu të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet OJQ-ve, OSHC-ve dhe akterëve të tjerë që punojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që të fuqizohen qytetarët dhe shoqëria civile që të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e politik-bërjes dhe vendimmarrjes lidhur me strategjinë në nivel lokal.

Ndërmjetësuesit e shkollave

- U takojnë komuniteteve ku ata punojnë, ata kanë qasje më të lehtë në familje se sa çdo punëtorë social;
- Detyrat kryesore janë:
 - sigurimi i regjistrimit të fëmijëve në shkollë;
 - parandalimi i ndërprerjes së vijimit të shkollimit të tyre;
 - individualizimi i problemeve të cilat nxënësit mund t'i hasin lidhur me shkollimin e tyre;
 - vendosja e veprimeve korigjuese; dhe ndërmjetësimi në mes të familjeve, shkollave dhe administratës komunale.
- Aktualisht programet ndërmjetësuese shkollore u shërbejnë më shumë se 1200 fëmijëve.
- Doracaku i trajnimit të shkollave të Kosovës për ndërmjetësim i publikuar nga Balkan Sunflowers në bashkëpunim me OSBE-në synon në normalizimin e figurës së ndërmjetësuesit shkollor në kontekstin e Kosovës.

Studimi “Roli i ndërmjetësuesve në integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor”

Studimi “Roli i ndërmjetësuesve në integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor” është realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, me mbështetjen e Këshillit të Evropës (KE) dhe Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) në vitin 2014.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi ishte që të sigurojë informata lehtësisht të arritshme dhe të kuptueshme për punën aktuale dhe rolin potencial të ndërmjetësuesve të arsimit lidhur me gjendjen e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në kuptimin e braktisjes së shkollës, riatdhesimit, diskriminimit, ndarjes, si dhe bashkëpunimit të palëve të interesuara në këto aspekte.

Qëllimet e veçanta të studimit ishin këto në vijim:

- Sigurimi i informatave të rëndësishme për sfondin e programit të ndërmjetësimit në arsim;
- Përshkrimi i rolit, aktiviteteve dhe modaliteteve të punës së ndërmjetësuesve të arsimit;
- Ofrimi i dëshmive për ndikimin e punës së ndërmjetësuesve në vijimin e shkollimit dhe zvogëlimin e rasteve të braktisjes së shkollimit
- Reflektimi i pikëpamjeve të palëve të interesuara në lidhje me rezultatet dhe praktikat e bashkëpunimit me ndërmjetësuesit në vijimin e shkollimit dhe rënies së numrit të rasteve të braktisjes së shkollimit;
- Lëshimi i rekomandimeve për mundësitë për avancimin e rolit, mbështetjes dhe bashkëpunimit të ndërmjetësuesve të arsimit, me qëllim të përmirësimit të pozitës së arsimit të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në të ardhmen. (Zylfiu H. et al 2014)

Programi i ndërmjetësimit i realizon aktivitetet e veta të asistencës në dy modalitete:

- 1) Aktivitetet në qendrat mësimore, dhe
- 2) Aktivitetet e ndërmjetësimit në shkollë, në familje dhe komunitet të synuara në mbështetjen e rritjes së qasjes në arsimim për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e regjistrimit me kohë në shkollë, përmirësimin e vijimit dhe parandalimin e braktisjes së shkollimit.

Raporti i studimit rekomandon, në mënyrë që ndërmjetësimi në arsim të kthehet në një mekanizëm të qëndrueshëm i cili e mbështet integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit të Kosovës, që:

- MASHT-i duhet të nxjerrë një udhëzim administrativ për rregullimin e pozitës, rolit, detyrave dhe përgjegjësi të ndërmjetësuesve, si dhe për të përcaktuar rolet dhe detyrat e MASHT-it-, DKA-ve dhe shkollave për të siguruar mbështetjen dhe bashkëpunimin me ndërmjetësuesit e arsimit; dhe
- MASHT-i dhe DKA-të duhet të institucionalizojnë profilin e ndërmjetësuesve të arsimit siç janë paraqitur në raportin e studimit duke inkorporuar ato në strukturën e shkollës dhe stafit komunal mbështetës.

Mozaik (Shtojca 3)

- Një model unik i arsimit dygjuhësh dhe multi-kulturor i fëmijëve parashkollor;
- Filozofia e Mozaikut është që të socializohen fëmijët në një ambient multi-kulturor në moshën më të hershme të mundshme, për të mësuar tolerancën dhe respektin për diversitetin e kulturave, dhe për të ndihmuar komunitetet e ndryshme etnike që të bashkëpunojnë dhe të komunikojnë me njëri-tjetrin.

Qendrat mësimore (QM) në Kosovë:

- Qendrat mësimore janë krijuar me vetë-iniciativë të organizatave dhe ato ofrojnë



kurse shtesë për fëmijët romë, ashkali në nivelin parashkollor dhe fillor. Roli i QM-ve ka qenë për të nxitur fuqizimin e komunitetit dhe për të mbështetur integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare në përgjithësi. Ato kanë dhënë një model alternativ të zhvillimit dhe arsimimit të fëmijëve, të rinjve dhe familjeve romë, ashkali dhe egjiptiane,.

- QM-të e para janë krijuar para më shumë se dhjetë vitesh. Aktualisht janë më shumë se 40 qendra mësimore të drejtuara nga 12 OJQ në 15 komuna dhe u shërbejnë më shumë se 2700 fëmijëve.
- Shërbimet e ofruara nga QM - të (varësisht nga QM): mësim pas orarit të mësim-it, aktivitete të kohës së lirë, programe për prindër dhe puna si “qendër e komuniteteve”.
- Shumica e QM-ve financohen nga donatorët ndërkombëtar, me përjashtim të një numri të vogël të QM-ve të cilat kanë një Memorandum Mirëkuptimi me komunat për të mbuluar koston e tyre deri në 7000 euro në vit. QM-të mbajnë takime mujore koordinuese për të shkëmbyer informata për praktikat më të mira dhe sfidat e përbashkëta, dhe për të bërë plane së bashku.
- Aktualisht MASHT-i me mbështetjen e ACCESS-it dhe në bashkëpunim me OJQ-të ka themeluar një grup pune për hartimin e udhëzimeve administrative për rolin e QM-ve.

Ideas Partnership ka iniciuar si në vijim:

- **Rekrutimi i një avokuesi të komunitetit** nga distrikti që të jetë si urë lidhëse dhe që të forcojë marrëdhëniet në mes familjeve dhe shkollës; dhe që të mbështesë fëmijët vijnë shkollimin e rregullt dhe të qëndrojnë aty;
- **Punëtorë vullnetarë nga komunitetet;**
- **Mësim plotësues** për fëmijët jashtë shkollës dhe ata që e kanë braktisur shkollimin në mënyrë që ata të arrijnë të regjistrohen në shkollë;
- **Mësim i pasdites ditëve të shtunë** për fëmijët, pak argëtim dhe një shujtë të lehtë të shëndetshme për t'i tërhequr ata nga rruga për një orë ose dy;
- **Mbledhja dhe shpërndarja e veshmbathjeve**

Projekti ACCESS ka kontribuar në trajnime, përgatitje të programeve dhe materialeve të trajnimit si në vijim:

- **Metodologjia e trajnimit** në kuadër të “Programit për përfshirje sociale” dhe zbatimi në 11 shkolla pilote. 6 TiT (Trajnime të trajnerëve) nga personeli i trajnuar i Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe 66 mësimdhënës të trajnuar.
- **Materiale pedagogjike për “Mësim shtesë për të kthyerit (të riatdhesuarit)”**. Mësimdhënësit e trajnuar dhe TiT në përgatitje e sipër.
- **Moduli për trajnimin e mësimdhënësve për mësim në gjuhën romë.**
- Përgatitja dhe zbatimi i trajnimeve për personelin e Qendrave mësimore (QM).
- Gjashtë muaj **trajnim për aftësitë e ndërmjetësimin** dhe 4 muaj **trajnim për përfshirje sociale.**



Rekomandimet MASHT-i

- Planifikimi për Strategjinë e re për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2016 - 2021 duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet, aktivitetet dhe veprimet e tyre konkrete duhet të jenë të arritshme, dhe në këtë mënyrë, të sigurohen edhe fondet.
- MASHT-i duhet të nxjerrë një udhëzim administrativ për rregullimin e pozitës, rolit, detyrave dhe përgjegjësive të ndërmjetësuesve, si dhe për përcaktimin e roleve dhe detyrave të MASHT-it, DKA-ve dhe shkollave për të siguruar mbështetjen dhe bashkëpunimin me ndërmjetësuesit e arsimit.
- MASHT dhe DKA-të duhet të institucionalizojnë profilin e ndërmjetësuesve të arsimit, siç janë paraqitur në raportin e studimit, duke i inkorporuar ato në strukturën e shkollës dhe stafit komunal mbështetës.

DKA-të

- Të zbatojnë pjesën arsimore të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2016 - 2021 dhe Planit të Veprimit ashtu siç është planifikuar;
- Të sigurojnë qasje në arsimin parashkollor për fëmijët e komuniteteve;
- Të rrisin vetëdijen dhe të mbështesin shkollat për ngritjen e vetëdijes në komunë dhe komunitete lidhur me të drejtën dhe rëndësinë e arsimit për të gjithë, për regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë etj.
- Të sigurojnë trajnime dhe materiale pedagogjike për mësimdhënësit.
- Të shfrytëzojnë përvojën e fituar në projekte të ndryshme dhe ta zbatojnë atë në praktikë.



4.4.3. Parandalimi i braktisjes së shkollimit dhe mbetjes së fëmijëve jashtë shkollimit

Sipas Ligjit për arsimin parauniversitar (Neni 15), vijimi i nxënësve në arsimimin e obligueshëm është përgjegjësi e prindërve dhe do të përbëjë kundërvajtje për prindin e fëmijës së moshës së arsimimit të obligueshëm:

- nëse fëmija i moshës së tillë nuk regjistrohet në shkollë e cila mund të jetë shkollë komunale, institucion trajnimi, shkollë speciale ose shkollë private e licencuar e përshatshme për moshën e fëmijës dhe nivelin mësimor; ose nëse nuk bëhen organizime alternative, për arsimimin e fëmijës, që janë miratuar nga MASHT; ose
- nëse pa ndonjë shkak të arsyeshëm, të përkufizuar si sëmundje ose si shkak i pashmangshëm nuk sigurohet vijimi i rregullt i tij apo saj në institucionin arsimor në kohët e përcaktuara nga Këshilli drejtues për fillimin e sesioneve.

Sipas ligjit, nëse një nxënës pa ndonjë arsye nuk arrin të regjistrohet, nuk e vijon ose e ndërpret arsimimin e obligueshëm, prindërit e tij apo saj do të dënohen për kundërvajtje, nëse mungesa është rezultat i veprimit të qëllimshëm ose neglizhencës nga ana e prindërve. Me qëllim të promovimit të vijimit dhe zvogëlimit të braktisjes së shkollimit, komuna e organizon transportin e sigurt dhe efikas për nxënësit në arsimin e obligueshëm, në mënyrë që ata të vijojnë shkollimin. Ligji gjithashtu përcakton se për të ndihmuar komunat dhe institucionet arsimore dhe ato të trajnimit që të merren në mënyrë efektive me rastet e braktisjes së shkollimit dhe të sigurojnë vijim të rregullt, MASHT do të përgatisë dhe nxjerrë udhëzime.

Udhëzimi Administrativ (19/2012) për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim-

in dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit (EPBMR) në arsimimin e obligueshëm është hartuar për ta parandaluar dhe për t'iu përgjigjur braktisjes së shkollimit të rregullt dhe mos regjistrimit në arsimin e obligueshëm. Udhëzimi administrativ përcakton braktisësin, si në vijim:

- një nxënës i cili e ndërpret shkollimin para përfundimit të arsimimit të obligueshëm sipas ligjit;
- një nxënës i cili pas përfundimit të arsimimit të obligueshëm e vazhdon shkollimin, mirëpo e ndërpret atë para përfundimit të synuar; dhe
- një fëmijë ose një i ri i cili nuk është regjistruar dhe nuk e vijon shkollimin e obligueshëm sipas ligjit.

Të anketuarit e studimit "Fëmijët e Kosovës jashtë shkollës", i kryer nga IPK-ja (2014), kanë identifikuar tri karakteristika të përbashkëta individuale për fëmijët ose adoleshentët të cilët ishin jashtë shkolle, ose që e kishin braktisur atë; shumica e tyre me gjasë janë fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ata ishin regjistruar në shkollë me vonesë dhe kishin marrë nota të ulëta të arritjes. Karakteristikat sociale të identifikuara janë si në vijim:

- ata vijnë nga familje të varfra;
- ata shpesh duhet të punojnë për të mbështetur veten e tyre ose familjet e tyre;
- ata shpesh kanë një traditë familjare të braktisjes apo shkallë të lartë të mungesës nga shkolla;
- ata shpesh vijnë nga familje me një histori të abuzimit me substanca dhe/ose me mungesë të kujdesit prindëror; dhe
- ata shpesh nuk jetojnë me prindërit apo banojnë në një familje me një prind.

Sipas udhëzimit administrativ (19/2012), ekipi për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obligueshëm (EPBMR)) duhet të krijohet në nivel të komunës dhe shkollës. Ekipi në nivel komunal përbëhet nga 9 anëtarë (përfaqësues të mësimdhënësve, EPBMR-së së shkollës, ekspertë nga institucionet dhe shoqëria civile), dhe duhet të ketë takime çdo tre muaj. Ekipi në nivel shkolle përbëhet nga 5 anëtarë të rregullt: përfaqësuesit e nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe ekspertëve të tjerë kur është e nevojshme.

Detyrat e ekipit në nivel shkolle janë si në vijim:

- të rrisë vetëdijen dhe komunikimin brenda dhe jashtë shkollës me qëllim të zvogëlim-it dhe parandalimit të braktisjes së shkollimit dhe rritjes së numrit të nxënësve të regjistruar në shkollë;
- të përgatisë një strategji në nivel shkolle dhe një plan punë kundër braktisjes dhe mos-regjistrimit të fëmijëve dhe adoleshentëve në shkollë;
- të koordinojë aktivitetet brenda dhe jashtë shkollës, siç janë: trajnimi i mësimdhënësve, takimet me prindër, puna me komunitetin;
- EPBMR t'i kushtojë kujdes të veçantë fëmijëve me NVA dhe grupeve të tjera të cënueshme që e braktisin arsimin e obligueshëm.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), misioni në Kosovë ka bërë një hulumtim lidhur me braktisjen e shkollimit në Kosovë në vitin 2011. Gjetjet kryesore të studimit treguan një mungesë të konsiderueshme të dhënave zyrtare të besueshme në lidhje me braktisjet e shkollimit, kryesisht për shkak të mekanizmave të pamjaftueshëm të monitorimit nga ana e shkollave dhe institucioneve të tjera përgjegjëse. Me qëllim që të rritet vetëdija në mesin e akterëve kyç për nevojën e shtimit të përpjekjeve të tyre për rritjen e vijimit të shkollimit dhe zvogëlimin e braktisjes së shkollës, sidomos në mesin



e grupeve të cënueshme, OSBE u ka rekomanduar palëve të interesuara që të zbatojnë plotësisht kornizën ligjore dhe politikat që rregullojnë të drejtën për arsimim - përfshirë Planin e Veprimit kundër braktisjes së shkollimit 2009-2014. (OSBE 2012). Rekomandimet ishin këto më poshtë:

MASHT

- Të sigurojë zbatimin e detyrimeve ligjore të institucioneve vendore të arsimit për të mbledhur të dhëna të sakta afatgjate sasiore dhe cilësore lidhur me braktisjen e shkollimit, të ndara sipas gjinisë, komunitetit dhe sipas ndonjë kategorie tjetër relevante.
- Të kërkojë përdorimin e një sistemi të menaxhimit të informatave për arsim në të gjitha shkollat e Kosovës, me standarde të qarta dhe të drejtpërdrejta për atë se si shkollat duhet përcjellë braktisjet e shkollimit.
- Të sigurojë që transferimet shkollore dhe arsyet e tjera për nxënësit të cilët e braktisin shkollimin të regjistrohen në të gjitha rastet.
- Të sigurojë udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit se si të zbatojnë kërkesat e mbledhjes së të dhënave dhe elementeve të tjera të Planit të Veprimit kundër braktisjes së shkollimit.

DKA-të

- Të punojnë ngushtë me të gjithë drejtorët e shkollave për të monitoruar braktisjen e shkollimit dhe shkallën e vijimit dhe rregullisht dhe sistematikisht të raportojnë tek MASHT-i.
- Të bashkëpunojnë me MASHT-in dhe me të gjithë drejtorët e shkollave për të ngritur vetëdijen lidhur me udhëzuesin për mbledhjen e të dhënave në Planin e veprimit kundër braktisjes së shkollimit dhe zbatimin e tyre.
- Në mënyrë pro-aktive të hetojnë dhe korrigjojnë rastet e mos-regjistrimit në shkolla, duke përfshirë këtu edhe përcjelljen e vijimit të shkollimit të fëmijëve të moshës shkollore në komunat përkatëse.

Drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit:

- Të monitorojnë në mënyrë aktive shfaqjen dhe arsyen për mos-vijimin dhe braktisjen e shkollimit në intervale ditore, mujore dhe vjetore - si dhe brenda ciklit të vitit shkollor - të raportojnë këto gjetje në drejtoritë komunale të arsimit çdo gjysmë-vjetor, me të dhëna të ndara sipas gjinisë, komunitetit dhe ndonjë kategorie tjetër relevante.
- Në mënyrë pro-aktive të kërkojnë nxënësit që mungojnë dhe prindërit e tyre për të identifikuar faktorët prapa mungesës së një fëmije nga shkolla dhe të inkurajojnë vijimin e shkollimit.

Organizatrat ndërkombëtare dhe qeveritare:

- Të inkurajojnë dhe mbështesin institucionet e Kosovës që pa vonesë dhe në mënyrë efektive të monitorojnë dhe parandalojnë braktisjet e shkollimit, dhe të përmirësojnë kapacitetet e tyre për përcjelljen e vijimit dhe të reagojnë lidhur me boshllëqet e vijimit në segmente të ndryshme të popullatës.

Në vitin 2013 Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetjen e UNICEF-it ka bërë një studim bazik për fëmijët jashtë shkollimit në shtatë komuna dhe 14 shkolla. Sipas rezultateve të studimit, EPBMR-të nuk janë themeluar në të gjitha komunat dhe shkollat, dhe edhe aty ku janë themeluar, ato nuk kanë ndonjë plan veprimi se si të parandalojnë dhe si të përgjigjen braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkolla. Përveç kësaj, IPK-ja raporton se DKA-të dhe shkollat nuk kanë krijuar mekanizma efektiv të ndërhyrjes dhe llogaridhënies për të monitoruar, informuar dhe raportuar për fëmijët jashtë shkollimit, mungesat dhe



incidentet diskriminuese. Veçanërisht, identifikimi dhe mbledhja e të dhënave për fëmijët të cilët kurrë nuk kanë qenë të regjistruar në shkollë mungon.

Në bazë të gjetjeve dhe konkluzioneve të studimit, IPK jep rekomandimet me planet orientuese për:

- themelimin dhe funksionimin e EPBMR-ve;
- Identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës;
- mekanizmat e intervenimit për fëmijët jashtë shkollës dhe parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjeve të shkollimit;
- trajnimin e ekipeve shkollore për zbatimin e standardeve për shkollat miqësore për fëmijët;
- regjistrimin e fëmijëve në arsimin parafillor dhe klasën 1; dhe
- ritjen e kohës që ata e kalojnë në shkollë gjatë ditës.



4.4.4. Promovimi i barazisë gjinore në arsim

Çështjet gjinore në arsim janë të përcaktuara në dokumentet vijuese:

- Plan i Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011 -2016 (2011)
- Ligji Nr 04 / L -032 për Arsimin Parauniversitar (2011)
- Ligji Nr 05 / L -020 për Barazi Gjinore (2015)
- Ligji Nr 05 / L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2015)

Plan i Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011 -2016 (2011) promovon përfshirjen sociale si një koncept gjithëpërfshirës që përfshin pjesëmarrjen e plotë e të gjithëve, pa marrë parasysh dallimet e tyre sociale të tilla si gjinia, përkatësia etnike, klasa sociale dhe aftësia e kufizuar në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore.

Një nga qëllimet e Ligjit Nr. 04 / L -032 për Arsimin Parauniversitar (2011) është, që të përgatisë nxënësin për një jetë të përgjegjshme në frymë të mirë të mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë me anëtarët e të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës (Neni 2.5). Në planifikim, menaxhim dhe ofrim të sistemit të arsimit parauniversitar, MASHT, komunat dhe institucionet arsimore dhe / ose aftësuese duhet të kenë parasysh normat, ndërkombëtarisht të pranuar, të Arsimit për të Gjithë (APGJ/ EFA),

Qëllimi i Ligjit Nr. 05 / L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2015) është të krijojë një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë, ose për parandalimin e shumë çështjeve, duke përfshirë seksin, gjininë, identitetin



gjinor dhe orientimin seksual në mënyrë që të zbatohet parimin e trajtimit të barabartë. Qëllimi i Ligjit për Barazi Gjinore (2015) është që të garantojë, mbrojë dhe promovojë barazinë ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë. Ai përcakton masat e përgjithshme dhe specifike për të siguruar dhe mbrojtur të drejtat e barabarta të burrave dhe grave, dhe definon institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Neni 20 i Ligjit për Barazi Gjinore ka për qëllim ndalimin e diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë duke deklaruar se diskriminimi në bazë të gjinisë në kuadër të institucioneve arsimore në të gjitha nivelet është i ndaluar, duke përfshirë qasjen në arsim, procesin e pranimit, qasjen në shërbime, objekte dhe përfitime të tilla si, bursa, vlerësimin e rezultateve, marrjen e gradave shkencore dhe titujve, qasjen për aftësim profesional, arsim, sport dhe fusha të tjera. Veprimet e mëposhtme përbëjnë diskriminim në bazë të gjinisë:

- Çdo kufizim mbi baza gjinore, apo pengesa në krijimin e lehtësive të nevojshme, për t'u arsimuar në institucionet publike ose private që ofrojnë arsimim apo kualifikime dhe shërbime aftësuese të tjera;
- Ofrimin e mundësive të ndryshme për meshkujt dhe femrat në zgjedhjen e fushës së veçantë të studimit, trajnimit apo diplomimit, dhe në lidhje me kohëzgjatjen e klasave, përveçse kjo përligjet nga një qëllim i ligjshëm dhe mjetet për arritjen e atij qëllimi janë ato që duhen dhe të nevojshme.

Ligji për Barazinë Gjinore vlen për meshkujt, femrat dhe personat që kanë një karakteristike të mbrojtur të identitetit gjinor apo përcaktimit të seksit, si dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë arsimin (Neni 2).

4.4.4.1. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e barazisë gjinore në arsim

Ligji për Barazi Gjinore (2015) i tregon institucionet e ndryshme që janë përgjegjëse për barazinë gjinore, të cilat janë:

- Institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimin të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi, (Neni 6).
- Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) është Agjenci ekzekutive që vepron brenda Zyrës së Kryeministrit (ZK) dhe ka për detyrë të bashkërendojë përgatitjen e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, monitorojë zbatimin e tij, si dhe raportojë çdo vit tek Qeveria për zbatimin e tij. (Neni 11).
- Të gjitha ministritë dhe komunat janë të obliguara të caktojnë zyrtarët/et përkatës/e për barazi gjinore me kapacitete profesionale dhe të ndajnë burime të mjaftueshme nga buxheti, për të koordinuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji. (Neni 12).
- Avokati i Popullit është institucion i barazisë që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit. (Neni 13).

MASHT-i ka emëruar një zyrtar për të punuar për barazinë gjinore dhe ka themeluar një grup pune për çështjet gjinore në arsim në vitin 2011. Grupi punues është i mandatuar për të identifikuar çështjet gjinore në arsimin bazik dhe në nivelet e tjera arsimore, të cilat kërkojnë veprim dhe për të koordinuar me partnerë të ndryshëm që trajtojnë çësht-



je me interes për këtë fushë.

Rolet dhe përgjegjësitë e grupit të punës:

- Të punojë me akterë të ndryshëm që trajtojnë çështjet gjinore në arsim për të identifikuar çështjet kyçe të cilat duhet të trajtohen;
- Të koordinojë përpjekjet e përbashkëta me partnerë të ndryshëm;
- Të bëjë shqyrtime periodike të intervenimeve (përgjigjeve) institucionale dhe të tjerave në lidhje me çështjet gjinore; dhe
- Publikimi i punëve/rezultateve vjetore me rekomandime për vitin e ardhshëm.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse për të siguruar qasje të barabartë për vajzat dhe djemtë në arsimin e obligueshëm, dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit janë të mandatuara për të alokuar fonde të mjaftueshme për transport pa pagesë, që do ta bëjë të mundur ndjekjen e shkollës për të gjithë nxënësit. Mësimdhënësit në klasa kanë përgjegjësinë për të siguruar barazinë gjinore në klasë dhe edukimin e barazisë gjinore, siç parashihet në ligj.

4.4.4.2. Funksonimi i kuadrit ligjor dhe institucioneve përgjegjëse për barazi gjinore

Profili Gjinor i Kosovës (Färnsveden U et al. 2014) paraqet rezultatet e studimit të kryer në vitin 2014 me synim për të analizuar dallimet gjinore në të gjitha nivelet e kornizës kombëtare, akterëve kyç, sundimit të ligjit, drejtësisë, të drejtave të njeriut, politikës, situatës sociale dhe ekonomike, dhunës në bazë gjinore, dhe sektorëve të tjerë. Sipas raportit, Kosova ka një kornizë mjaft gjithëpërfshirëse ligjore dhe disa mekanizma në drejtim të barazisë gjinore, por zbatimi i strategjive dhe planeve të veprimit mbetet një sfidë për disa arsye, të tilla si:

- Strategjitë rrallë mbështeten me fonde të mjaftueshme për zbatim;
- Institucionet qeveritare në të gjitha nivelet shpesh nuk e kuptojnë se si të merren me integrimin gjinor në punën e tyre;
- Zyrtarët për barazi gjinore brenda ministrive dhe komunave janë të margjinalizuar; disa ndonjëherë përfshihen në planifikimin programatik, buxhetimin, vlerësimin e ndikimit, dhe/ose analizimin e drafteve të ligjeve ose politikave nga perspektiva gjinore;
- Akterë të tjerë si OSHC-të e grave konsultohen rrallë nga palët e interesuara ndërkombëtare, aktive në Kosovë, kur përcaktohen prioritetet.

(Färnsveden U et al. 2014.)

Në raport thuhet se edhe ABGJ përballet me sfida duke përfshirë të kuptuarit e dobët në mesin e institucioneve se "gjinia" i referohet grave dhe burrave dhe se si të integrohet gjinia në punën e tyre; stafi i pamjaftueshëm në divizionin ligjor; buxheti i pamjaftueshëm për kryerjen e mandatit të tyre, veçanërisht për hulumtime; dhe ministritë nuk i marrin seriozisht përgjegjësitë për raportim, duke përfshirë sigurimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. (Färnsveden U et al. 2014).

4.4.4.3. Balanca aktuale gjinore në arsim

Regjistrimi i fundit në vitin 2011 tregoi se pothuajse 50% e popullsisë së Kosovës janë femra. (ASK 2011). Në vitin 2012 Banka Botërore ka raportuar se në Kosovë "femrat janë të nën-përfaqësuar në çdo nivel të arsimit, përpos në universitet. Pabarazia më e madhe

gjinore në regjistrim ndodh në nivelet e mesme të larta speciale dhe të mesme të larta të përgjithshme. "(Banka Botërore 2012.)

Statistikat e fundit të SMIA-s tregojnë se situata në lidhje me pabarazitë gjinore ka ndryshuar.

Në vitin 2014 - 2015 regjistrimi i përgjithshëm në arsimin parauniversitar ishte 383.320 me balancë gjinore 51,9 % meshkuj dhe 48,1 % femra. Në Tabelën 20 gjinia e nxënësve në nivele të ndryshme të arsimit është paraqitur në vitin 2014 - 2015. Ajo tregon se pjesëmarrja e vajzave është 3 – 4 % më e vogël në nivelin parashkollor, nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët. Pabarazitë më të mëdha gjinore në regjistrim ndodhin në arsimin e përgjithshëm të mesëm dhe të përgjithshëm profesional. Regjistrimi i meshkujve në arsimin e mesëm është 53 % e regjistrimit të përgjithshëm. Në shkollat e mesme të përgjithshme regjistrimi i meshkujve është vetëm 44,6 % e regjistrimit të përgjithshëm dhe në nivelet profesionale 61,4 %.

Tabela 20. Gjinia e nxënësve në nivele të ndryshme arsimore në 2014 - 2015

Niveli arsimor	Gjithsej	Meshkuj	%	Femra	%
Parashkollor	3774	1960	52	1814	48
Parafillor	22154	11406	51,5	10748	48,5
Fillor dhe i mesëm i ulët	273649	141168	51,6	132481	48,4
I mesëm i lartë (Gjithsej)	83743	44385	53	39358	47
* Profesionale	41940	25758	61,4	16182	38,6
* Gjimnaz	41803	18627	44,6	23176	55,4
Gjithsej	383320	198919	51,9	184401	48,1

Duket se femrat më shumë zgjedhin gjimnazin se sa shkollat profesionale. Një nga arsyet për mungesë të ekuilibrit gjinor në shkollat profesionale është fakti se shkollat profesionale kanë ofruar më shumë kurse (71%) për meshkujt sesa për femrat (Färnsveden U et al. 2014.)

Femrat janë ende të nën-përfaqësuara në nivelin e mesëm të lartë. Në vitin 2012 Banka Botërore sugjeroi se "me shumicën e popullsisë që jeton në zonat rurale, kjo potencialisht mund të shpjegohet nga faktorë të tillë si a) perceptim i ulët i kthimit të arsimimit të femrave në zonat rurale, b) vështirësitë ekonomike dhe c) distanca penguese për institucionet e mesme arsimore, të cilat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zonat rurale".

Gjinia e mësimdhënësve

Tabela 21 tregon balancën gjinore të mësimdhënësve në arsimin parauniversitar. Ekziston, pak a shumë, numër i njëjtë i mësimdhënësve meshkuj dhe femra në arsimin parauniversitar, por ka dallime të mëdha në arsimin parashkollor dhe nivelet e mesme të larta. Edukimi parashkollor është i dominuar nga mësuesit femra pasi ka vetëm dy mësues meshkuj që punojnë në institucionet parashkollore në tërë Kosovën. Modelet e rolit të meshkujve në institucionet parashkollore janë të nevojshme pasi që rreth 11% e fëmijëve në nivel parashkollor vijnë nga familjet pa baba.

Në arsimin parafillor dhe të mesëm të ulët ka pak më shumë mësimdhënës femra dhe në nivelin e mesëm të lartë (61,2 %) e mësimdhënësve janë meshkuj. Statistikat e SMIA-s nuk japin informata specifike nëse mësimdhënësit në arsimin e mesëm të lartë janë duke punuar në arsim të përgjithshëm ose profesional.



Tabela 21. Gjinia e mësimdhënësve në nivele të ndryshme në 2014 - 2015

Niveli arsimor	Gjithsej	Meshkuj	%	Femra	%
Parashkollor	528	2	0,4	526	99,6
Parafillor, fillor dhe i mesëm i	17594	8455	48,1	9139	51,9
I mesëm i lartë	5358	3277	61,2	2081	38,8
Gjithsej	23480	11734	50	11746	50

4.4.4.4. Sfidat në promovimin gjinor në arsim

Grupet e pafavorizuara

Vajzat dhe gratë nga komuniteti rom, ashkali, dhe egjiptian kanë nivelet më të ulëta të arsimimit, shpesh për shkak të mësimdhënësve të pamjaftueshëm të etnisë së tyre, mungesës së teksteve, dhunës dhe diskriminimit në shkollë, çështjeve të sigurisë, financave të pamjaftueshme familjare, detyrave për përkujdesje në shtëpi dhe martesave të hershme. Përveç kësaj, vajzat me aftësi të kufizuara gjithashtu nuk kanë qasje në arsim, meqë prindërit kanë tendencë për t'i izoluar ata në shtëpi." (Färnsveden U et al. 2014.)

Gjinia në shkallën e braktisjes

Në vitin akademik 2008 - 2009, femrat përbënin 55 % të braktisjes në arsimin bazë (Banka Botërore 2012). Sipas Profilit Shtetëror Gjinor të Kosovës (Färns-veden U et al 2014) deri në vitin 2009 më shumë vajza e kanë braktisur shkollën e mesme, por që nga atëherë situata ka ndryshuar dhe në vitin 2014 më shumë se 70 % që e kishin braktisur shkollën ishin djem. (Färnsveden U et al. 2014.)

Megjithatë, shkalla e braktisjes në mesin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është kryesisht e lartë, veçanërisht në mesin e vajzave të këtyre komuniteteve, si pasojë e martesave të hershme dhe perceptimeve të rrënjësura thellë që kanë të bëjnë me rolet e gjinore.

4.4.4.5. Adresimi i pabarazive gjinore në arsim

Sipas Bankës Botërore (2012), "adresimi i pabarazive gjinore në Kosovë do të kërkojë veprime në disa fronte, duke përfshirë rritjen e arsimit dhe aftësive, përmirësimin e shëndetit, krijimin e më shumë vendeve të punës, forcimin e shërbimeve të punësimit, si dhe heqjen e barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e grave në ndërmarrësi dhe qasje në pozita udhëheqëse. "Banka Botërore ka sugjeruar zgjidhjet e mëposhtme:

- Rritjen e shkallës së regjistrimit në shkollë;
- Përmirësimin e rëndësisë dhe cilësisë së arsimit,
- Zhvillimin e mundësisë së dytë arsimore për të rriturit, studimet e të cilëve janë ndërprerë nga lufta, që do të përmirësonin rezultatet e punësimit për burrat dhe gratë.

Gjithashtu, do të jetë e rëndësishme për të kuptuar dhe adresuar kufizimet specifike të arsimimit më të mirë të femrave. Masat e mundshme mund të përfshijnë:

- Uljen e distancës për shkolla;
- Ngritjen e vetëdijes në lidhje me përfitimet e arsimimit të femrave; dhe
- Dhënien e parave sipas kushteve për vajzat nga familjet e varfra.

(Banka Botërore 2012.)



4.4.4.6. Edukimi i barazisë gjinore në Kosovë

Neni 21 i Ligjit për barazi gjinore përcakton edukimin e barazisë gjinore në shkolla si vijon:

- Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore mjetet mësimore të përdorura duhet të bazohen në barazinë gjinore dhe edukimin për barazinë gjinore duhet përfshirë në kurrikulat shkollore në të gjitha nivelet.
- Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor – edukativ, hartimi i materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimi i materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektives gjinore dhe eliminimin e stereotipave negative, paragjytimeve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore.
- Përfshirja në programet e shkollave, e aktiviteteve edukative dhe trajnuese që synojnë sensibilizimin e të rinjve për barazinë gjinore dhe përgatitjen e tyre për qytetari demokratike.
- Të ketë përfshirje të barabartë të femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimit profesional dhe joprofesional dhe në këshillim për ato profesione të cilat konsiderohen tradicionalisht vetëm për femra dhe vetëm për meshkuj.

MASHT-i është përgjegjës për të siguruar që kurrikula dhe praktikat e mësimdhënies të jenë të ndjeshme ndaj gjinive, si dhe për zhvillimin e kurrikulave në lidhje me barazinë gjinore. Shkollat dhe mësimdhënësit luajnë role të rëndësishme në përmbushjen e nevojave të ndryshme të djemve dhe vajzave. " (Färnsveden U et al. 2014.)

4.4.4.7. Programet që promovojnë edukimin për barazi gjinore

Programi për Arsimin Themelor (PATH/BEP) (Shtojca 3) ka integruar gjininë në të gjitha aspektet e programit të tij. Projekti ka prodhuar një numër të madh të udhëzuesve dhe materialeve për mësimdhënësit, drejtorë të shkollave, nxënës dhe prindër, duke përfshirë ndjeshmërinë gjinore në prodhimin e materialeve. Auditime të koleksioneve të mini-librave dhe lexuesve të klasave të hershme për të siguruar janë bërë për përfshirjen e gjuhës gjinore, ekuilibrit të personazheve kryesore të femrave dhe meshkujve, dhe për shmangien e stereotipave gjinore. BEP ka prodhuar një listë për vetë-vlerësimin e mësimdhënësve për barazinë gjinore në klasë, dhe një listë kontrolli për përzgjedhjen e librave neutrale sa i përket gjinisë. USAID-i ka trajnuar 59 krye-trajnerë të cilët që nga shtatori i vitit 2014 kanë realizuar disa trajnime të menaxhimit dhe zhvillimit profesional me bazë në shkollë lidhur me gjithpërfshirjen dhe çështje gjinore.

Që nga shtatori i vitit 2014, me kërkesë të Zyrës së Kryeministrit, USAID-i ka përfshirë çështje që lidhen me të drejtat e lesbikeve, homoseksualëve, bi-seksualëve dhe trans-seksualeve - LHBT (LGBT) në të gjitha aktivitetet e tyre. Katër zyrtarë nga MASHT-i janë trajnuar dhe kanë marrë materiale lidhur me çështjet e LHBT-së të cilat u janë dhënë drejtorëve të shkollave për rritjen e vetëdijesimit. Trajnimet e mbajtura nga krye-trajnerët prej muajit shtator të vitit 2014 kanë përfshirë jo vetëm çështjet gjinore por edhe ato të LGBT-së.



4.5. Trajnimi i mësime dhënësve

Trajnimi i mësime dhënësve para shërbimit dhe gjatë shërbimit

Mësime dhënësit dhe qëndrimet që ata mbajnë në lidhje me gjithëpërfshirjen janë më të rëndësishmet për të bërë punë në arsimin gjithëpërfshirës. Të gjithë mësime dhënësit duhet të jenë të trajnuar dhe të pajisur me qëndrimet, vlerat dhe aftësitë e duhura për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse dhe për të mësuar nxënësit me nevoja të ndryshme.

Trajnimi i mësime dhënësve para dhe gjatë shërbimit duhet të synojë në përgatitjen e mësime dhënësve të klasave të rregullta për arsim gjithëpërfshirës. Trajnimi i mësime dhënësve duhet të ofrojë njohuri që e bën teorinë dhe arsyetimin për arsimim gjithëpërfshirës të qartë, si dhe përvoja praktike në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës duke përfshirë diferencimet që lidhen me strategjitë, përmbajtjen, materialet dhe vlerësimin.

Trajnimi i mësime dhënësve duhet të përgatis mësime dhënësit për përdorimin e vlerësimit të vazhdueshëm si një mjet për punën e tyre. Ai duhet të udhëheqë ata në vendosjen e qëllimeve të qarta dhe konkrete të të mësuarit dhe përdorimin e rezultateve të vlerësimit si bazë për planifikimin e përvojave të ardhshme mësimore për të gjithë nxënësit. Në veçanti, trajnimi duhet t'u sigurojë mësime dhënësve informatat dhe mjetet për të zhvilluar në mënyrë efektive marrëdhëniet në mes të një PIA-s dhe vlerësimit të vazhdueshëm.



Ekzaminimi dhe vlerësimi i nevojave për mbështetjen e nxënësve me NVA duhet të bëhet sa më herët në karrierën e tyre shkollore. Në mënyrë që të ndodhë kjo, mësime të mëdha duhet të jenë të trajnuar për të vëzhguar dhe realizuar vlerësime ekzaminuese të nxënësve në klasat e tyre, dhe që të përdorin mjetet ekzaminuese dhe të interpretojnë rezultatet e vlerësimit. Atyre duhet t'u sigurohen materiale udhëzuese që u ndihmojnë në identifikimin e nxënësve me NVA (Mitchell 2008.)

Gjendja ekzistuese

Trajnimi i mësimeve para shërbimit në Fakultetin e Edukimit në nivel Bachelor, përfshirë trajnimin për mësime të arsimit parashkollor dhe fillor siguron tre kurse lidhur me nevojat e veçanta/arsimit gjithëpërfshirës: një kurs i detyrueshëm për "Arsimin me nevoja të veçanta" dhe dy kurse zgjedhore, "Vështirësitë në mësim-nxënie" dhe "logopedi". Niveli Master përmban vetëm një kurs të quajtur "Arsimi gjithëpërfshirës".

Departamenti i pedagogjisë i Fakultetit të Edukimit ofron kurse trajnimit për nivelin BA në "Pedagogji speciale" dhe "Vështirësitë në mësim-nxënie" për edukatorët, dhe në nivelin MA, një kurs për Arsimin gjithëpërfshirës.

FE është duke planifikuar të fillojë programin MA për Arsim gjithëpërfshirës me 60 ECTS në vitin 2016. Grupi i synuar janë edukatorët, mësuesit klasorë dhe pedagogët.

Studentët e tjerë që studiojnë për mësime të mëdha të mëdha nga fakultetet e tjera kanë mbetur pa asnjë trajnim për arsimin me nevoja të veçanta/arsimit gjithëpërfshirës. Në tetor të vitit 2015 do të ketë këto ndryshime si në vijim në programet për trajnimin e mësimeve të mëdha:

- Të gjithë mësime të mëdha të mëdha do të trajnohen për lëndën specifike në fakultetin e tyre, por në mënyrë që ata të bëhen mësime të mëdha ata duhet të kryejnë nivelin Master në arsim në Fakultetin e Edukimit;
- Edukatorët e fëmijërisë së hershme duhet të përfundojnë nivelin Bachelor.

Kurset ekzistuese janë të përqendruara kryesisht në nevojat e arsimit special dhe kalimi prej nevojave të veçanta në qasje gjithëpërfshirëse është i nevojshëm. Kurset për arsimin gjithëpërfshirës janë të nevojshme për të kuptuar lidhur me arsimin gjithëpërfshirës dhe duhet të sigurohet që qasja e arsimit gjithëpërfshirës të jetë e mishëruar në të gjitha trajnimet e mësimeve të mëdha përfshirë edhe trajnimet e mësimeve të mëdha të mëdha në mënyrë që të gjithë mësime të mëdha të pajisen me njohuri dhe aftësi lidhur me atë se si duhet menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse.

Në klasat gjithëpërfshirëse, mësime të mëdha duhet të merren me stile të ndryshme të mëdha të mëdha, nevoja të veçanta arsimore, dhe me përkatësi të ndryshme kulturore të nxënësve.

Fakulteti i Edukimit ka ofruar kurse të trajnimit gjatë shërbimit për të avancuar mësime të mëdha me nivelin Bachelor. Si pjesë të këtyre studimeve, Fakulteti i Edukimit ka ofruar një kurs për arsimin gjithëpërfshirës.

FE ka zhvilluar një program MA për mësime të mëdha të AAP-së i cili do të fillojë në 2016-2017.



Trajnimet e nevojshme

Trajnimi i personelit mbështetës

Sistemi i arsimit gjithëpërfshirës ka nevojë për personel mbështetës, si mësimdhënës mbështetës, mësimdhënës udhëtues dhe asistentë të shkollave. Trajnimi i tyre do të mund të ofrohet si trajnim para dhe gjatë shërbimit në Fakultetin e Edukimit. Trajnimet të avancuara gjatë shërbimit janë të nevojshme për mësimdhënësit e qendrave burimore.

Trajnimet për zhvillim profesional

Programi i trajnimit për zhvillim profesional (ZHP) për arsimin gjithëpërfshirës i cili është zbatuar nga projektet finlandeze gjatë viteve 2000 – 2012 mund të shërbejë si bazë për zhvillimin e programeve të trajnimit gjatë shërbimit. Gjatë viteve 2000 – 2012 janë trajnuar pesë grupe me rreth 35 profesionistë të arsimit në secilin grup. Trajnimi për ZHP përbëhet nga 60 kredi. Secili pjesëmarrës në trajnim ka vijuar kursin për pesë ditë çdo muaj për 1,5 vite. Trajnimi për ZHP është akredituar nga MASHT-i. Modulet e trajnimit për ZHP mund të ofrohen edhe si kurse të shkurta të trajnimit të pavarur.

Trajnimi i personelit për trajnimin e mësimdhënësve

Me qëllim të ofrimit të programeve efektive duhet t'i kushtohet vëmendje edhe kualifikimeve dhe aftësive të edukatorëve të mësimdhënësve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.

Lidhja e trajnimit të mësimdhënësve me shkollat

Është tejet e rëndësishme që studentët të njihen me metodat hulumtuese në arsim. Ata duhet të mësojnë se si të mbledhin dhe analizojnë të dhënat empirike nga terreni. Një shembull i mirë i këtij lloji praktikash është detyra për studentët e nivelit BA në FE në Prishtinë, si më poshtë.

Studentët e Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës ishin dërguar nëpër shkollat e qyteteve të tyre për të monitoruar klasat, duke u përqendruar në vështirësi në të nxënë. Si rezultat, brenda një viti studentët kishin identifikuar më shumë se 2000 nxënës me vështirësi në mësim-nxënie. Profesori nga Fakulteti i Edukimit i kishte vizituar studentët gjatë këtyre vizitave monitoruese të këtyre shkollave dhe gjatë këtyre vizitave kishte ofruar zgjidhje praktike dhe metoda për mësimdhënësit si të merren me vështirësi në mësim-nxënie në klasë. Procedurat zyrtare të vlerësimit të organizuara nga MASHT-i janë afatgjate, dhe në këtë mënyrë shkolla mund të përfitojë nga studentët - mësimdhënës në trajnimet gjatë punës.

Rekomandimet

Trajnimi i mësimdhënësve

- Të ofrohen mundësi dhe trajnimet për trajnerët e mësimdhënësve (duke përfshirë edhe trajnerët e mësimdhënësve lëndor) që të familjarizohen me dhe të përfshijnë qasjen gjithëpërfshirëse të arsimit në të gjitha trajnimet;
- Të ri-orientohen dhe të harmonizohen programet e trajnimit të mësimdhënësve (para dhe gjatë shërbimit) me qasjen e arsimit gjithëpërfshirës në mënyrë që të ndërtohen kapacitetet pedagogjike të mësimdhënësve për të plotësuar nevojat e ndryshme në një klasë gjithëpërfshirëse dhe për të menaxhuar atë;
- Të ofrohen kurse të trajnimit lidhur me parimet dhe praktikën e arsimit gjithëpërfshirës



për të gjithë profesionistët e arsimit (në fillim edukatorët e fëmijërisë së hershme, mësuesit klasor dhe mësuesit lëndor);

- Të sigurohet që qasja e arsimit gjithëpërfshirës të mishërohet në të gjitha programet e trajnimit lëndor për mësuesit që trajnohen;
- Të ofrohet trajnim për diferencimet e kurrikulës, vlerësimin dhe ekzaminimin në klasën gjithëpërfshirëse;
- Të ofrohet trajnim për përdorimin e PIA-ve;
- Të trajnohen më shumë edukatorë dhe mësues nga komunitetet e pakicave;
- Të përgatiten programe të trajnimit për mësuesit që të punojnë si mësues udhëtues dhe mbështetës;
- Të përgatiten programe të trajnimit për asistentët;
- Të bashkëpunohet me komunat dhe shkollat në mënyrë që të gjendet dhe të sigurohet punë praktike për studentët mësues në shkolla.



5. Sfidat e hasura dhe udhërrëfyesi për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në shkollat e Kosovës

Sipas Deklaratës së Salamank-as dhe Kornizës për Veprim lidhur me nevojat e veçanta të Arsimit (1994), realizimi i vizionit në praktikë kërkon krijimin e politikave arsimore, praktikave pedagogjike dhe mjediseve mësimore të cilat përfshijnë të gjithë fëmijët. Përfshirja shkon përpara paralelisht me aftësinë, për të siguruar shërbime mbështetëse për fëmijët kur është e nevojshme në shkollat e rregullta në lagjet e tyre.

Me gjithë rezultatet pozitive të arritura në Kosovë përmes zhvillimit të infrastrukturës ligjore për arsimin gjithëpërfshirës siç paraqitet në kapitullin e mëparshëm, sfidat mbesin në realizimin e vizionit të gjithëpërfshirjes të përcaktuar në ligj dhe në dokumente të tjera arsimore në praktikën pedagogjike në nivel komunal dhe shkollor.

Pikë fillestare për zhvillimin e gjithëpërfshirjes në arsim është që të identifikohen të gjitha pengesat në mjedis, qëndrimet dhe mënyra në të cilën shkolla është e organizuar dhe funksionon. Analiza e situatës e bërë në vitin 2014 nga Programi i Binjakëzimit në 61 shkolla pilote tregoi se ka shumë sfida me të cilat shkollat përballen në fillimin e zbatimit të KKK-së dhe gjithëpërfshirjes si parim udhëheqës të tij. Këto sfida janë përshkruar më poshtë.

Sfidat e hasura nga shkollat e Kosovës

Qëndrimet, vetëdija dhe njohuritë

- 1) Mungesa e njohurive dhe trajnimeve për arsimin gjithëpërfshirës: Drejtorët dhe mësindhënësit nuk janë të njohur me konceptin e gjithëpërfshirjes. Koncepti “Nx-



ënës me nevoja të veçanta arsimore" i referohet nxënësve me kufizime fizike, vizuale, kufizime në dëgjim dhe kufizime intelektuale. Trajnimi është i nevojshëm në mënyrë që drejtorët e shkollave të menaxhojnë një shkollë gjithëpërfshirëse dhe që mësimit të menaxhojnë klasat gjithëpërfshirëse.

Qëndrimet ndaj diversitetit në shkolla dhe në komunitetet përreth duket të jenë ende kryesisht negative. Disa prej drejtorëve të shkollave, ku nuk ka asnjë nxënës nga komunitetet pakicë, kanë treguar se janë krenar që kanë një shkollë homogjene kulturore, ose sidomos në shkollat e mesme ku nuk kanë asnjë nxënës me NVA. Si një shembull i qëndrimeve negative në komunitet, një nga shkollat pilot kishte kërkuar të krijohet një klasë e bashkangjitur në shkollë, në mënyrë që të akomodohen nxënësit me aftësi të kufizuara, por për shkak se anëtarët e komunitetit nuk donin të kenë "kategori të fillë të fëmijëve" në shkollë, nuk është krijuar kjo klasë e bashkangjitur, dhe fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mbetur pa qasje në shkollë.

Qasja

- 2) Nxënësit nga komunitetet pakicë në shumicën e shkollave janë të integruar në klasat e zakonshme. Gjuha e mësimit është kryesisht gjuha shqipe e cila shkakton vështirësi në mësim, veçanërisht për nxënësit nga komuniteti rom, dhe vështirësitë në të mësuar lehtë dërgojnë në braktisjen e shkollimit. Mësimit të nxënësit nuk janë të trajnuar për të përmbushur shumëllojshmërinë kulturore në klasa, dhe nxënësit nga komunitetet pakicë në shumicën e shkollave nuk marrin ndonjë mbështetje shtesë. Në disa shkolla janë OJQ-të lokale të cilat ofrojnë mbështetje veçanërisht për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- 3) Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore: Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në 61 shkollat pilot është vetëm 0,4% nga regjistrimi i përgjithshëm dhe shumica e këtyre nxënësve janë të ndarë në klasat e bashkëngjitura. Numri i nxënësve me vështirësi në mësim-nxënie siç janë vështirësitë në lexim, shkrim dhe matematikë është i panjohur. Këta nxënës nuk janë identifikuar dhe ata nuk marrin asnjë mbështetje shtesë.
- 4) Qasja në shkollë: Numri i vogël i nxënësve me NVA në krahasim me vendet tjera (në Finlandë rreth 22% e nxënësve marrin mbështetje të veçantë arsimore) tregon që nxënësit me NVA ose nuk janë identifikuar në shkolla, ose fëmijët me aftësi të kufizuara mungojnë në shkollë. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk kanë qasje në shkollë është i panjohur.

Identifikimi i NVA-ve dhe mbështetja

- 5) Identifikimi dhe mbështetja për nxënësit me NVA: Identifikimi dhe mbështetja për nxënësit me NVA mungon në shumicën e shkollave. Shkollat nuk kanë mjete për të identifikuar nevojat e veçanta arsimore dhe për të përgatitur programe dhe plane për mbështetjen individuale. Mësimit të nxënësit nuk kanë njohuri, shkathtësi dhe mbështetje për të identifikuar dhe mbështetur nxënësit me nevoja të ndryshme.
- 6) Ekipe vlerësuese komunale janë themeluar rishtazi dhe ende nuk janë funksionale përveç në komunën e Ferizajt dhe Gjilanit. Shkollat nuk janë të vetëdijshme për ekzistencën dhe disponueshmërinë e shërbimeve të ekipeve vlerësuese;
- 7) Qasja në kurrikulë: Diferencimet e kurrikulës nuk janë në përdorim në shkolla. Të gjithë nxënësit në klasë janë duke ndjekur të njëjtën përmbajtje dhe strategji të kurrikulës, dhe kështu nxënësit me NVA nuk e kanë qasjen e duhur në kurrikulë dhe mësim.
- 8) Planet individuale arsimore (PIA): PIA-t janë në përdorim vetëm për nxënësit në klasat e bashkangjitura ose në shkollat speciale. Mësimit të nxënësit në shkollat e



rregullta nuk janë të trajnuar dhe as të njohur me përdorimin e PIA-ve.

- 9) Vlerësimi: Për shkak të mungesës së përdorimit të PIA-ve dhe strategjive alternative të vlerësimit, nxënësit me NVA vlerësohen në mënyrë të barabartë me të gjithë të tjerët, pa i kushtuar vëmendje nevojave të tyre individuale. Kjo shkakton përsëritjen e klasës dhe çon lehtë në braktisjen e shkollimit.
- 10) Sistemet mbështetëse mungojnë: Sistemet mbështetëse veçanërisht për nxënësit me NVA nuk janë të organizuara. Asistentët e shkollave, mësime dhënësit mbështetës, pedagogët, psikologët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor me disa përjashtime mungojnë nëpër shkolla. Një nga shkollat pilot ka krijuar një sistem brenda shkollës për të siguruar mbështetje për nxënësit me NVA dhe mësime dhënësit e tyre. Mbështetja e jashtme mungon në shumicën e shkollave. Mësime dhënësit udhëtues nga qendra burimore nuk i kanë vizituar shkollat dhe ekipet multi-profesionale janë funksionale vetëm në dy komuna

Mjedisi fizik

- 11) Ndërtesat shkollore nuk janë të arritshme për nxënësit me aftësi të kufizuara. Shumë shkolla kanë ndërtuar pjesët e pjerrëta për nxënësit me vështirësi fizike, por megjithatë nuk është bërë shumë në shkolla për të krijuar mjedis mësimor pa pengesa për të gjithë.
- 12) Infrastruktura dhe mirëmbajtja e shkollave: Ndërtesat shkollore shkaktojnë shumë probleme: në shumicën e shkollave buxheti është shpenzuar për ngrohje, kulmet rrjedhin, klasat janë të nxehta në verë dhe të ftohta në dimër, ka probleme me lagështinë, dyshemetë në disa shkolla janë të dëmtuara, madje edhe të rrezikshme. Gypat e ujësjellësit dhe të kanalizimit mungojnë në shkollë. Niveli i dobët higjienik i tualeteve nuk ofron qasje për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike dhe pamore.
- 13) Hapësira shkollore: shkollat e mbipopulluara dhe që punojnë në dy ndërrime e pengojnë funksionimin e shkollave. Mungesa e hapësirës është një problem i zakonshëm në shkolla edhe pse shkollat janë duke punuar kryesisht në dy ndërrime. Puna në dy ndërrime e bën organizimin e klasave, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shkollës, dhe kështu edhe zbatimin e KKK-së sfidues.
- 14) Klasat e mbi-populluara kanë efekte të drejtpërdrejta në metodat e mësime dhënies, procesin dhe rezultatet e mësimit. Në qytetet e mëdha ekzistojnë shkolla filllore dhe të mesme të ulëta, me një numër mesatar më shumë se 30 nxënës dhe në shkollat e mesme deri në 48 nxënës për klasë.
- 15) Klasat: Një klasë tipike përmban tavolina për dy nxënës dhe karrige të cilat janë të vendosura tradicionalisht në rreshta. Në shumë shkolla tavolinat dhe karriget janë të vjetruara. Muret janë kryesisht bosh dhe ka shumë jehonë në klasa, si edhe në korridoret kryesisht të mëdha në shkollë. Shumica e klasave janë me dritare të mëdha dhe pa perde që i bën klasat shumë të nxehta gjatë verës. Dërrasat e zeza janë shpesh në gjendje të keqe ose të punuara nga materiali që ato nuk mund të përdoren siç duhet.

Mësimdhënia dhe mësim-nxënia

- 16) Materialet për mësimdhënie dhe mësim-nxënie: KKK thekson një perspektivë me nxënësin në qendër dhe të bazuar në kompetenca e cila kërkon që materialet dhe burimet e mësimdhënies dhe mësim-nxënies t'i motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë progresin e tyre në një mënyrë kuptimplote. Tekstet shkollore konsiderohen si burime të vlefshme të të mësuarit, por qasja e nxënësit në informata nuk duhet të kufizohet vetëm në tekstet shkollore (KKK, f.56). Mësimdhënësit duhet të përdorin shumëllojshmëri të burimeve mësimore si: tekstet alternative të lëndës brenda një fushe kurrikulare; materialet e krijuara nga vetë mësimdhënësit; burimet



e gatshme nga faqet e internetit në dispozicion; platformat e e-mësimit (mësimi elektronik); e-bibliotekave; dhe burime të ndryshme nga jeta e përditshme.

Aktualisht edhe materialet themelore për mësimdhënie dhe mësim-nxënie kryesisht mungojnë ose janë të vjetruara në shumicën e klasave. Mungesa e pajisjeve dhe furnizimeve ndikon negativisht në strategjitë e përdorura për mësimdhënie dhe mësim-nxënie dhe kështu edhe në rezultatet e mësimi. Për nxënësit me aftësi të kufizuara nuk ka mjete ndihmëse në dispozicion.

- 17) Strategjitë e kufizuara të mësimdhënies: Strategjitë e mësimdhënies në përdorim janë të kufizuara për shkak të mungesës së hapësirës, materialeve, pajisjeve, furnizimeve dhe trajnimeve.

Udhërrëfyese për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen për shkollat e Kosovës

Në gjithëpërfshirje, është përgjegjësi e sistemit të rregullt që të arsimojë të gjithë fëmijët, dhe prandaj ekziston nevoja që shkollat të ndryshojnë ashtu që të plotësojnë nevojat e ndryshme të të gjithë nxënësve. Transformimi kërkon ndryshime në përmbajtje, qasje, struktura dhe strategji që përdoren në shkollë dhe klasë. Menaxhmenti i shkollës duhet të jetë i përkushtuar ndaj transformimeve. Mësimdhënësit e kanë një rol të rëndësishëm pasi që në shkolla gjithëpërfshirëse ata duhet të gjejnë mënyra për të njohur nxënësit e tyre, për të identifikuar nevojat e tyre të ndryshme, për të diferencuar në mënyrë të përshtatshme praktikatat e kurrikulës dhe të vlerësimit, dhe për të siguruar mbështetjen e duhur në përputhje me nevojat e të gjithë nxënësve. Mësimdhënësit duhet të jenë të përgatitur dhe të trajnuar mirë për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse me nevojat të ndryshme. Mbështetja nga komuniteti përreth është e nevojshme që të përfshihen të gjithë fëmijët nga fqinjësia.

Pikë së pari, ka nevojë për një vizion të përbashkët të shkollës gjithëpërfshirëse që mbulon të gjithë fëmijët e moshës së duhur. Rritja e vetëdijes dhe trajnimit në mesin e personelit të shkollës, prindërve dhe anëtarëve të komunitetit është e nevojshme për të bërë të gjithë të kuptojnë rëndësinë e arsimit për të gjithë, të drejtat e çdo fëmije për arsimim dhe zhvillimin e shkollës për t'u bërë përfshirëse. Të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të angazhohen për vizionin e përbashkët. Elementet e tjera të nevojshme për zhvillim janë të lidhura me identifikimin, qasjen në shkollë, ndryshimet në shkollë, qasjen në kurrikulë, ndryshimet në klasë, burimet dhe mbështetjen. Këto elemente për shkollën gjithëpërfshirëse janë paraqitur në figurën 2 dhe Tabela 21 përmban ide të asaj se çka mund të bëjnë shkollat për të zhvilluar këto elemente. Në fund të kapitullit janë dhënë rekomandimet për shkollat.

Figura 2 Elementet për shkollën gjithëpërfshirëse




Tabela 21. Çka mund të bëjnë shkollat për të zhvilluar elementet që shkollën e bëjnë më gjithëpërfshirëse

Çka nevojitet?	Çka duhet bërë?
Vetëdija	<ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e vetëdijes në shkollë dhe në komunitet lidhur me <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat e të gjithë fëmijëve për arsimim • Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar • Ligjet dhe dokumentet e tjera që i përcaktojnë këto të drejta
Njohuritë	<ul style="list-style-type: none"> - Parimet e arsimit gjithëpërfshirës - Si menaxhohet arsimi gjithëpërfshirës - Drejtori dhe mësimdhënësit marrin pjesë në trajnime gjatë shërbimit - Informatat ndahen dhe trajnimet organizohen për anëtarët e Këshillit Drejtues të Shkollës, prindërve dhe anëtareve të komunitetit
Përkushtimi	<ul style="list-style-type: none"> - E tërë shoqëria, komuniteti, shkolla, menaxhmenti, mësimdhënësit, prindërit duhet të jenë të përkushtuar.
Përfshirja e komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> - Anëtarët e komunitetit janë aktiv në zhvillimin dhe mbështetjen e shkollës - Prindërit në mënyrë aktive e mbështesin zhvillimin e shkollës - Grupet e pakicave marrin pjesë në zhvillimin e shkollës
Identifikimi	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e situatës në mesin e fëmijëve të moshës shkollore nga komuniteti që nuk kanë qasje në shkollë - Identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore - Ekipet vlerësuese komunale për mbështetje në identifikim

Qasja në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> - Lehtësira për të gjithë fëmijët për të pasur qasje në shkollë - Sigurimi i qasjes fizike përfshirë sipërfaqet e pjerrëta, tualetet e përshtatura dhe hapësirat adekuate për karroca lëvizëse, klasat me fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të jenë të vendosura në dhomat e kateve përdhese. - Transporti i siguruar për ata që kanë nevojë.
Ndryshimi në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i qasjes fizike - Shërbimet mbështetëse në dispozicion - Dhomat burimore me mësimdhënësit mbështetës - Standardet për shkolla miqësore për fëmijët të zbatuara
Qasja në kurrikulë	<ul style="list-style-type: none"> - Qasje në mësim për të gjithë - Diferencimet kurrikulare të zbatuara përfshirë adaptimet e përmbajtjes, strategjive të mësimdhënies, materialeve dhe vlerësimit - Përdorimi i PIA-ve kur nevojitet.
Ndryshimet në klasë	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i klasave gjithëpërfshirëse <ul style="list-style-type: none"> • Atmosfera e klasës: respekti, mirëkuptimi, motivimi dhe stimulimi • Mbështetja e vetëbesimit pozitiv të të gjithëve • Organizimet për një mjedis mësimor optimal • Planifikimi dhe zbatimi i njësive mësimore për t`u shërbyer nevojave të ndryshme (p.sh. stilet te mësuarit, gjuha e përdorur, dallimet kulturore dhe gjinore në materiale) • Angazhime optimale për të gjithë • Përgjigjet e pritshme për nxënësit, menaxhimi i kohës dhe tranzicionet • Mbështetja në klasë • Menaxhimi i sjelljes në klasë - Diferencimet e përmbajtjes mësimore, strategjive, materialeve dhe praktikave vlerësuese mësimore. - Metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe mësim-nxënies në përdorim - Pajisje, furnizime, mjete ndihmëse në dispozicion
Burimet	<ul style="list-style-type: none"> - Burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale në dispozicion në shkollë - Proporcion optimal mësimdhënës-nxënës - Mësimdhënës të kualifikuar - Mësimdhënës mbështetës - Ekipi mbështetës në shkollë i themeluar - Asistentët shkollor (shpresohet në të ardhmen) - Pajisje, furnizime, mjete ndihmëse në dispozicion
Mbështetja	<ul style="list-style-type: none"> - Mbështetje e brendshme: mësimdhënësit mbështetës, klubet e leximit, klubet e gjuhës, vullnetarët - Mbështetje e jashtme: Mësimdhënës udhëtues, ekipe vlerësuese komunale, OJQ-të, anëtarët e komunitetit



Rekomandimet për shkollat:

- Të rrisin vetëdijen e tërë stafit shkollor për arsimin gjithëpërfshirës dhe për kuadrin ligjor në arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë (Ligjin dhe dokumentet e tjera politike);
- Përkushtimi i stafit menaxhues dhe tërë stafit shkollor për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe hapjes së dyerve për të gjithë fëmijët në shkollë;
- Të përgatiten planet zhvillimore shkollore me qasje të arsimit gjithëpërfshirës;
- Mësimdhënësit të marrin pjesë në trajnime për arsimin gjithëpërfshirës dhe të organizojnë trajnime më bazë në shkollë për arsimin gjithëpërfshirës;
- Të ndahen informacionet lidhur me gjithëpërfshirjen tek anëtarët e Këshillit Drejtuesit të shkollës, prindërit dhe anëtarët e komunitetit;
- Të përfshihen anëtarët e komunitetit, duke përfshirë edhe prindërit e nxënësve nga grupet e pakicave me nevoja të veçanta arsimore në zhvillimin e shkollës gjithëpërfshirëse;
- Të organizohen ngjarje vetëdijesimi për arsimin gjithëpërfshirës në komunitet;
- Të bëhen analiza të situatës në komunitet për t'i gjetur fëmijët e moshës shkollore që nuk e vijnë shkollimin;
- Të sigurohet mjedis miqësor për fëmijët, ku çdo nxënës të ndjehet i sigurt nga aspekti fizik, emocional dhe psikologjik;
- Të sigurohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale në dispozicion në shkollë (p.sh. raporti optimal mësimdhënës-nxënës, mësimdhënës të kualifikuar);
- Të organizohen klasat ashtu që të jenë më nxënësin në qendër dhe miqësore ndaj fëmijëve (madhësia e klasës, përdorimi i materialeve dhe metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësim-nxënies, diferencimet, praktikat e vlerësimit, përdorimi i TIK-ut, pajisjet, mjetet ndihmëse);
- Të krijohet sisteme të mbështetjes për nxënës dhe mësimdhënës (ekipet mbështetëse, mësimdhënësit mbështetës, mësimdhënës mbështetës të klasave të bashkangjiturra, mësimdhënës udhëtues, ekipet vlerësuese komunale, asistentët);
- Të krijohen dhoma burimore me mësimdhënës mbështetës në shkollë;
- Të identifikohen nxënësit me vështirësi në të nxënë/nevoja të veçanta arsimore;
- Të identifikohen nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim dhe të krijohen klubet e leximit për t'i mbështetur ata;
- Të identifikohen nxënësit në fazën e hershme në rrezik të braktisjes së shkollimit dhe të analizohen faktorët dhe kushtet që e shkaktojnë braktisjen;
- Të ftohen anëtarët e komunitetit për të mbështetur nxënësit që mund ta braktisin shkollën për shkak të gjendjes së dobët socio-ekonomike të familjes;
- Të ofrohet mbështetje për nxënësit nga grupet e pakicave.



6. Rekomandime të kombinuara

Rekomandimet për MASHT-in

- Të sigurohet se parimet e arsimit gjithëpërfshirës që janë paraparë në Ligj, PSAK, dhe KKK të zbatohen në praktikë në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar;
- Të sigurohet se parimet e arsimit gjithëpërfshirës prezantohen tek të gjithë akterët relevant, siç është personeli në MASHT, Inspektoratet rajonale, DKA-të, drejtorët dhe trajnerët e mësimdhënësve (gjatë dhe para shërbimit);
- Të sigurohet se identifikimi i hershëm i NVA-ve është funksional dhe mbështetja ofrohet qysh nga edukimi në fëmijërinë e hershme dhe në arsimimin parafillor dhe fillor;
- Të sigurohet se fazat e tranzicionit nga edukimi në shtëpi/ i fëmijërisë së hershme në arsimimin parafillor/arsimimin fillor dhe gjithashtu nga arsimi i mesëm i ulët në arsimin e mesëm të lartë / profesional të jenë të përgatitura mirë për nxënësit me NVA;
- Të fuqizohen ekipet komunale vlerësuese përmes ofrimit të trajnimeve të mjaftueshëm për ta, dhe të forcohet bashkëpunimi i ekipeve vlerësuese me shkolla;
- Të planifikohet se si të bëhet rritja e numrit të mësimdhënësve ndihmës në shkolla përmes:
 - përgatitjes së udhëzimeve administrative për mbështetjen e mësimdhënësve në të gjitha shkollat (jo vetëm në shkollat me klasa të bashkëngjitura) duke përfshirë udhëzimet për themelimin e dhomave burimore dhe ekipeve mbështetëse;
 - planifikimit dhe zbatimit të kurseve të trajnimit gjatë dhe para shërbimit për mbështetjen e mësimdhënësve në bashkëpunim me IPK-në dhe Fakultetin e



Edukimit;

- udhëzimit të DKA-ve për shfrytëzimin e burimeve njerëzore ekzistuese për të punuar si mësimdhënës ndihmës, në veçanti në shkollat ku numri i nxënësve është në rënie e sipër;
- Të përcillet nëse transformimi i klasave të bashkëngjitura në klasa burimore është i përgatitur mirë paraprakisht. Përqendrimi duhet të jetë në fuqizimin e klasës dhe mësimdhënësve lëndor që të mirëpresin nxënësit me NVA. Duhet pasur parasysh gjërat në vijim:
 - Nxënësit në klasat e bashkëngjitura duhet të akomodohen në klasat e përshatshme për moshën e tyre;
 - Mësimdhënësit klasor dhe lëndor duhet të jenë të trajnuar për të menaxhuar klasat gjithëpërfshirëse dhe të përgatitur mirë për të plotësuar nevojat e nxënësve me NVA;
 - Mësimdhënësit duhet të jenë të trajnuar në përdorimin e PIA-ve dhe në diferencimin e kurrikulës (përmbajtje, strategji të mësimdhënies, materiale dhe vlerësime);
 - Mbështetja e ofruar për nxënësit me NVA dhe mësimdhënësit klasor/lëndor duhet të planifikohet si mirë para akomodimit të nxënësve me NVA në klasat e rregullta;
- Të fillohet me përqendrimin lidhur me mënyrën se si të trajtohen vështirësitë në lexim dhe shkrim; në trajnimin e mësimdhënësve klasorë lidhur me 1) se si të përdoren mjete të ekzaminimit për të identifikuar vështirësitë në lexim dhe shkrim, dhe 2) se si të mbështeten nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim; rezultatet e mira dhe përvojat e fituara nga klubet e leximit duhet të shfrytëzohen.
- Të forcohet kapaciteti i qendrave burimore për të ofruar mbështetje efektive cilësore për shkollat e rregullta;
- Të mobilizohen qendrat burimore për të filluar trajnimin sistematik të të gjitha shkollave për arsimim gjithëpërfshirës. Qendrat burimore janë autorizuar nga MASHT për ofrimin e 16 kurseve të akredituara për arsimin gjithëpërfshirës, NVA dhe tema të tjera të ndërlidhura me shkollat, prindërit dhe anëtarët e komunitetit.
- Të organizohen trajnime të vazhdueshme për mësimdhënësit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar mbi përdorimin e PIA-s, dhe të përcillet dhe të monitorohet përdorimi dhe cilësia e PIA-ve;
- Të planifikohet si të krijohet një sistem i asistentit të mësimdhënësit me trajnim në Kosovë;
- Të organizohet mësimdhënie sipas fushave të aktivitetit për nxënësit me aftësi të kufizuara të shumëfishta dhe të rënda intelektuale përmes trajnimit të mësimdhënësve, alokimit të burimeve njerëzore dhe materialeve për mësimdhënie; nxënësit të cilët mësojnë sipas fushave të aktivitetit kanë nevojë në shumicën e rasteve për asistent shkollor personal, pajisje speciale dhe pajisje ndihmëse. Ndihma dhe bashkëpunimi me OJQ-të lokale do të jenë të dobishme në përgatitjet dhe në zbatimin e mësimdhënies sipas fushave të aktivitetit.
- Për të kuptuar rolin specifik të nxënësve të shurdhër në sistemin arsimor, ata përfaqësojnë një minoritet gjuhësor, dhe rezultatet e tyre të të nxënësve, tërësisht varen nga gjuha e mësimin. Ata kanë nevojë për një mjedis mësimor të pasur me gjuhën e shenjave për të arritur rezultate të mira. Nxënësit e shurdhër duhet të kenë klasat e tyre me mësimdhënës që e njeh rrjedhshëm gjuhën e shenjave, ose në rastin e gjithëpërfshirjes duhet të sigurohen përkthyes apo asistent me orar të plotë të gjuhës së shenjave.
- Të planifikohet dhe organizohet arsimimi i fëmijëve të shurdhër-verbër;
- Të forcohet bashkëpunimi brenda MASHT-it dhe me komunat për përmirësimin e të



dhënave statistikore për fëmijët jashtë shkollës, fëmijët me NVA dhe fëmijët jashtë sistemit arsimor si dhe braktisjet e shkollimit. Ekipe vlerësuese komunale do të ofrojnë informacione të dobishme në lidhje me nxënësit me NVA.

Rekomandimet për DKA-të

- Të planifikohet dhe menaxhohet zbatimi efektiv i KKK-së me parimin e saj kryesor të gjithëpërfshirjes në nivel komunal;
- Të sigurohet që parimet e arsimit përfshirës t'u prezantohen të gjithë akterëve relevant , siç janë stafi i DKA-ve, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit;
- Të sigurohet që ekipe vlerësuese komunale të themelohen dhe zyrtari për arsim gjithëpërfshirës të emërohet;
- Të planifikohet dhe menaxhohet procesi drejt arsimit gjithëpërfshirës në komuna dhe të mbështetet puna e zyrtarit të arsimit gjithëpërfshirës në koordinim dhe mbështetje të shkollave;
- Të punohet në bashkëpunim me shkollat, ofruesit e shërbimeve të fëmijërisë së hershme dhe me OJQ-të, për të rritur vetëdijesimin mbi arsimin gjithëpërfshirës në mesin e prindërve dhe komunitetit, duke përfshirë aktivitete të vetëdijesimit;
- Të përmirësohen kushtet për cilësi të arsimit parashkollor për të gjithë, dhe, në veçanti për fëmijët me prejardhje të pavolitshme, me vonesa dhe dëmtime zhvillimore;
- Të sigurohet që drejtorët e shkollave të jenë trajnuar për të menaxhuar një shkollë gjithëpërfshirëse dhe mësimdhënësit janë të trajnuar për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse duke organizuar trajnime të vazhdueshme për gjithëpërfshirje;
- Të transformohen klasat e bashkangjitura në dhoma burimore dhe të përgatitet mirë procesi i transformimit, për t'u siguruar që mësimdhënësit klasor dhe lëndor të jenë të trajnuar për të menaxhuar klasën gjithëpërfshirëse dhe për të përmbushur nevojat e nxënësve me NVA në klasë; për t'u siguruar që mbështetje e mjaftueshme ofrohet për nxënësit me NVA dhe mësimdhënësit e tyre;

- T'u ofrohen shkollave mësimdhënë mbështetës dhe dhoma burimore. Mësimdhënësit mbështetës dhe dhomat burimore janë të nevojshme në të gjitha shkollat, jo vetëm në ato me klasë të bashkangjitura. DKA-të mund të fillojnë me një nga mundësitë e mëposhtme:

1. Varësisht prej numrit të shkollave në komunë të punësojnë 1 – 3 mësimdhënë "udhëtues" mbështetës për të punuar në komunë dhe mbështetur shkollat;
2. Të themelohen dhoma burimore në të gjitha shkollat në të cilat mësimdhënësit "udhëtues" mbështetës mund të ofrojnë ndihmë individuale ose në grupe të vogla;
3. Të transformohen disa shkolla në "qendra të grumbulluara (klaster)" për të ofruar mbështetje profesionale dhe materiale për shkollat e tjera të komunës. Themelimi i qendrave të grumbulluara kërkon këto në vijim:
 - a) Punësimin e mësimdhënësve mbështetës në qendrat e grumbulluara;
 - b) Trajnimin e mësimdhënësve për të përfituar njohuri dhe shkathtësi se si të menaxhohet një klasë gjithëpërfshirëse dhe për mbështetjen e nxënësve me NVA;
 - c) Ndarjen e buxhetit për të prodhuar materiale mësimore për shkollën.

Këto shkolla preferohet të jenë shkollat e tanishme gjithëpërfshirëse, dhe pilot shkollat e KKK-së të cilat janë duke u mbështetur nga Projekti i Binjakëzimit dhe ku Instituti Ped-



agogjik i Kosovës dhe Projekti i Binjakëzimit janë duke ndërtuar kapacitete në mesin e mësimit dhe menaxhmentit. Komunitet me rritje të numrit të nxënësve mund të përdorin mësimit klasor për të punuar, pasi të jenë trajnuar, si mësimit mbështetës. MASHT-i në bashkëpunim me IPK-në dhe Fakultetin e Edukimit duhet të planifikojnë se si t'i trajnojnë këta mësimit për të punuar si mësimit mbështetës

- Roli i mësimit mbështetës duhet t'u sqarohet drejtorëve të shkollave dhe mësimit në shkollat e rregullta. Mësimit bashkëpunuese ndërmjet mësimit mbështetës dhe mësimit të tjerë duhet të forcohet dhe mësimit të trajnohen në metodat bashkëpunuese të mësimit.
- Të bëhen monitorime të rregullta për t'u siguruar se:
 - planet zhvillimore shkollare përgatiten me qasje gjithëpërfshirëse dhe zbatohen si të tilla;
 - shkollat janë miqësore për fëmijë dhe gjithëpërfshirëse;
- Të rishikohet buxheti në mënyrë që:
 - t'u ofrohen shkollave burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale (p.sh. porcion optimal mësimit-nxënës, mësimit të kualifikuar, materiale mësimit, pajisje ndihmëse);
 - të mbështetën aktivitetet për shkolla gjithëpërfshirëse;
- Të mobilizohen ekipet vlerësuese komunale për të punuar me shkollat në identifikimin e nxënësve me NVA dhe të sigurohen informata të dobishme për SMIA që të mbledhë të dhëna statistikore për numrin e nxënësve me NVA në shkollë apo jashtë saj;
- Të fillohet me përqendrimin se si të trajtohen vështirësitë në lexim dhe shkrim; në trajnimin e mësimit klasorë lidhur me 1) se si të përdoren mjetet e ekzaminimit për të identifikuar vështirësitë në lexim dhe shkrim, dhe 2) se si të mbështetën nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim; rezultatet e mira dhe përvojat e fituara nga klubet e leximit duhet të shfrytëzohen.
- Të ofrohen trajnime për të gjithë mësimit në përdorimin e PIA-s, dhe të përcillet e monitorohet përdorimi dhe cilësia e PIA-ve;
- Të bëhen plane në bashkëpunimin ndër-sektorial në komuna për të hulumtuar dhe përfshirë në sistemin arsimor të gjithë fëmijët e moshës shkollare të cilët nuk janë duke e vijuar shkollimin;
- Të sigurohet që fazat e kalimit prej arsimimit në shtëpi / arsimimit në fëmijëri të hershme në arsimim para-shkollor/arsimim fillor dhe gjithashtu nga arsimimi i mesëm i ulët në arsimim të mesëm të lartë / arsimim profesional të përgatitet mirë për nxënësit me NVA.

Rekomandime për trajnimin e mësimit

- Të ofrohen mundësi dhe trajnime për trajnuesit e mësimit (duke përfshirë edhe trajnerë të mësimit lëndorë) për t'u familjarizuar dhe pasur qasje gjithëpërfshirëse arsimore në të gjitha trajnimet;
- Të riorientohen dhe harmonizohen programet për trajnimin e mësimit (para dhe gjatë shërbimit) me qasjen e arsimimit gjithëpërfshirës me qëllim të ngritjes së kapaciteteve pedagogjike të mësimit për të përmbushur nevojat e llojllojshme në klasat gjithëpërfshirëse dhe për menaxhimin e tyre;
- Të ofrohen kurse të trajnimit për parimet dhe praktikën e arsimimit gjithëpërfshirës për të gjithë profesionistët arsimorë (edukatorët e moshës së hershme fëmijërore, mësimit klasor dhe lëndor);
- Të sigurohet që qasja e arsimimit gjithëpërfshirës të ngulitet në të gjitha programet e trajnimit lëndor për mësimit pjesëmarrës në trajnime;
- Të ofrohen trajnime për përiferencimet e kurrikulës, vlerësim dhe ekzaminim në klasa gjithëpërfshirëse;
- Të ofrohen trajnime për përdorimin e PIA-s;



- Të trajnohen më shumë edukatorë dhe mësime dhënë nga komunitetet e pakicave;
- Të përgatiten programe trajnimi për mësime dhënë për të punuar si mësime dhënë udhëtues dhe mbështetës;
- Të përgatiten programe trajnuese për asistentë;
- Të bashkëpunohet me komuna dhe shkolla në mënyrë që të mundësohet mbajtja e praktikës profesionale të studentëve në shkolla.

Rekomandimet për Qendrat burimore

- Regjistrimi në shkollë speciale duhet të zvogëlohet dhe duhet përqendruar më shumë në ofrimin e shërbimeve për shkollat e rregullta;
- Të punësohen ose emërohen më shumë mësime dhënë udhëtues për të kontribuar më shumë në shkollat e rregullta;
- Të përfshihen të gjithë mësime dhënësit e qendrave burimore në ofrimin e mbështetjes së tyre për shkollat e rregullta;
- Të bëhen më të dukshme qendrat burimore në sistemin arsimor; shkollat dhe mësime dhënësit duhet të dinë se çfarë lloji të shërbimeve ata mund të presin dhe të marrin nga qendrat burimore;
- Të bashkëpunohet më shumë me shkollat e rregullta dhe të mobilizohen mësime dhënësit udhëtues për të komunikuar me shkollat e rregullta me qëllim të ofrimit të mbështetjes nxënësve me vështirësi në mësim-nxënie/aftësi të kufizuara dhe mësime dhënësit të tyre në shkollat e rregullta;
- Të forcohet roli i qendrave burimore si ofrues të shërbimeve mbështetëse; tani për tani shumica e qendrave burimore funksionojnë kryesisht si shkolla speciale;
- Të mobilizohen mësime dhënësit e trajnuar që të fillojnë trajnimet sistematike të të gjitha shkollave për arsimim gjithëpërfshirës dhe për tema të tjera të ndërlidhura. Qendrat burimore i kanë 16 kurse të akredituara të cilat ata mund t'i ofrojnë për mësime dhënësit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit.
- Të fillohet me programin për mësime dhënësie në përputhje me fushat e aktivitetit për nxënësit me aftësi të kufizuara intelektuale të shumta dhe të rënda, pasi që mësime dhënësit të jenë trajnuar, dhe për të siguruar që burimet njerëzore (mësime dhënësit e trajnuar, asistentët e shkollave) dhe materialet (pajisjet e veçanta dhe pajisjet ndihmëse) të jenë në dispozicion;
- Të planifikohet në bashkëpunim me MASHT-in se si të organizohet arsimimi i të verbërve dhe shurdhërve;
- Të bashkëpunohet lidhur me trajnimin e mësime dhënësit për të ofruar praktikë profesionale për studentët në shkolla.

Rekomandimet për shkolla:

- Të ngritët vetëdija e gjithë personelit të shkollës për arsimimin gjithëpërfshirës dhe për kornizën ligjore për arsimim gjithëpërfshirës në Kosovë (ligjet dhe dokumentet e tjera të politikave);
- Përkushtimi i menaxhmentit dhe personelit të shkollës në tërësi është i domosdoshëm për zbatimin e arsimimit gjithëpërfshirës dhe për mirëpritjen e të gjithë fëmijëve në shkollë;
- Të përgatiten planet zhvillimore të shkollave me qasjen e arsimimit gjithëpërfshirës;
- Të mundësohet mësime dhënësit të marrin pjesë në trajnimet për arsimim gjithëpërfshirës dhe të organizohen trajnime me bazë në shkollë për arsimim gjithëpërfshirës;
- Informatat për gjithëpërfshirje të ndahen me anëtarët e Organizatës qeverisëse të shkollës, prindërit dhe anëtarët e komunitetit;
- Të përfshihen anëtarët e komunitetit, përfshirë prindërit e nxënësve nga grupet e pakicave dhe atyre me nevojë të veçanta për arsim në zhvillimin e shkollës gjithëpërfshirëse;



- Të organizohen aktivitete për ngritjen e vetëdijes për arsimimin gjithëpërfshirës në komunitet;
- Të bëhen analiza të situatave në komunitet për të gjetur fëmijët e moshës shkollore që nuk vijojnë shkollimin;
- Të sigurohet një mjedis i këndshëm për fëmijët ku secili nxënës mund të ndihet fizikisht dhe emocionalisht i sigurt, i cili i plotëson edhe kërkesat e tyre psikologjike;
- Të sigurohet që në shkollë të ketë në dispozicion burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale (p.sh: përpjesëtim optimal mes mësimit dhe nxënësve, mësimit të kualifikuar);

Të organizohen klasat në atë mënyrë që të jenë me nxënësin në qendër dhe miqësore për fëmijët (madhësi optimale e klasës, përdorim i materialeve dhe metodave të ndryshme të mësim-nxënies dhe mësimit, diferencim, praktika vlerësuese, përdorim i TIK-ut, furnizimeve dhe pajisjeve ndihmëse);

- Të krijohen sisteme mbështetëse për nxënësit dhe mësimit (ekipe mbështetëse, mësimit ndihmës, mësimit të klasave të bashkëngjitura, ekipe komunale vlerësuese, asistentë);
- Të krijohen dhoma burimore me mësimit mbështetës në shkollë;
- Të identifikohen nxënësit me vështirësi në mësim-nxënie/nevoja të veçanta për arsimim;
- Të identifikohen nxënësit me vështirësi në lexim dhe shkrim dhe të themelohen klubet e leximit për t'i mbështetur ata;
- Të identifikohen në fazë të hershme nxënësit që janë në rrezik për ta braktisur shkollimin duke e përcjellë këtë me një analizë të faktorëve dhe kushteve që e shkaktojnë këtë situatë;
- Të ftohen anëtarët e komunitetit për të mbështetur nxënësit të cilët ka gjasa ta braktisin shkollën për shkak të gjendjes së vështirë socio-ekonomike të familjes;
- Të ofrohet mbështetje për nxënësit nga grupet e pakicave.

Referencat

Arnesen A-L., Birzea C., Dumont B., Essomba M.A., Furch E., Vallianatos A. & Ferrer F. 2008. Politika dhe përvoja për mësimdhënie socio-kulturore dhe diversitet. Raport anketues mbi arsimin fillestar të mësimdhënësve në diversitetin socio-kulturor. Këshilli i Evropës. http://www.coe.int/t/dg4/education/diversity/Source/Volume_1_En.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2011. Ligji Nr. 04/L-020 për amandamentimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2015. Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2015. Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, . 2008. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.
Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2011. Ligji Nr. 04/L –032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. 2008. Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Anëtarëve të tyre në Kosovë.

Balkan Sunflowers.

<http://www.balkansunflowers.org>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 2008.

<http://www.kushtetutakosoves.info/?cid=1,245>.

Këshilli i Evropës. 1995. Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe raporti sqarues. Seria e traktateve të Këshillit të Evropës, N. 157. Strasburg.

[https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/1_atglance/PDF_H\(95\)10_FCNM_ExplanReport_en.pdf](https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/1_atglance/PDF_H(95)10_FCNM_ExplanReport_en.pdf)

Këshilli i Evropës. 2009. Konkluzionet e këshillit për një kornizë strategjike të bashkëpunimit Evropian në Arsim dhe aftësim ("ET 2020") takimi i 2941 Këshillit për Arsim, Rini dhe Kulturë.

http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/educ/107622.pdf

Deaf Blind Education:

<http://www.deafblindinfo.org> (14.7.2015)

Devetaku-Gojani H. & Mehmeti S. 2014. Fëmijët jashtë shkollës në Kosovë. Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë. Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Agjencia Evropiane për Zhvillimin e Arsimit me Nevoja të Veçanta. 2007. Vlerësimi i mjedisit gjithëpërfshirës. Çështje kyçe për politika dhe praktikë.

https://www.european-agency.org/sites/default/files/assessment-in-inclusive-settings-key-issues-for-policy-and-practice_Assessment-EN.pdf

ASISTENCA E BE-së PËR KOSOVËN, Arsimimi për të ardhmen.

http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/education_for



[the future en.pdf](#)

EURLex. 2011. Edukimi dhe Përkujdesja në Fëmijërinë e Hershme: Të ju mundësojmë të gjithë fëmijëve tanë fillimin më të mirë të mundshëm në botën e së nesërme
<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:52011DC0066>

Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë. 2012. Përmirësimi i ofrimit të arsimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian: Praktikrat më të mira dhe Rekomandimet. Doracak për Zyrtarët Komunal
http://www.ecmikosovo.org/ëp-content/Publications/Hand_book_and_manuals/2012-10_ECMI_Kosovo_Manual_on_Improving_the_Delivery_of_Education_for_Roma_Ashkali_and_Egyptian_Communities_Good_Practices_and_Recommendations/alb.pdf

Komisioni Evropian. Arsimim dhe trajnim për gjithëpërfshirje sociale.
http://ec.europa.eu/education/policy/strategic-frameëork/social-inclusion_en.htm

Këshilli i Evropës. 2013. Strategjia për Barazi Gjinore 2014-2017. Komisioni për Barazi Gjinore. Zëvendësministri. Dokumentet CM.
<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=2105977&Site=CM>

Färnsveden U., Qosaj-Mustafa A. & Farnsworth N. 2014. Profili gjinor në nivel vendi. Korniza e Kosovës për barazi gjinore. Analizë e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë. ORGUT Consulting AB.
http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_20757/cf_347/Orgut_Kosovo_Gender_Profile_FINAL_2014-05-08.PDF

Gashi A. & Serhati J. 2013. Vënia në hartë e politikave arsimore të AAP dhe përvojat në gjithëpërfshirje sociale dhe kohezioni social në Ballkanin Perëndimor, Turqi dhe Izrael. Raporti i shtetit: Kosovë. 2013. Fondacioni Evropian për Trajnime.

Qeveria e Kosovës, Zyra e Kryeministrit. 2008. Strategjia për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2009 -2015. Republika e Kosovës.

Qeveria e Kosovës. Zyra për Qeverisje të Mirë – Zyra e Kryeministrit, Të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Barazia Gjinore. 2009. Plani i Veprimit për Implementimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009-2015. Republika e Kosovës.
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Plani_i_Veprimit_per_zbatimin_e_Strategjise_per_integrimin_e_Komunitetit_RAE_2009-2015.pdf

Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. 2008. Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës. Republika e Kosovës.

Gowing E. & Saqipi B. 2010. Raporti për Vlerësimin e Nevojës së Ngritjes së Kapaciteteve të Drejtorive Komunale të Arsimit në Kosovë. Projekti i BE-së i Qasjes Tërë-sektoriale EU SWAp Project.

Udhëzime për Modifikimet dhe Përshtatjet e Nevojshme për Zhvillimin e Qasjes në Programet dhe Kualifikimet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional për Nxënësit me Aftësi të Kufizuara. 2011. EU KOSVET V - Zhvillimi i Sigurimit të Cilësisë, Akreditimit dhe Zhvillimit i AKK & KKK në Kosovë.



GIZ-Përmirësimi i arsimit fillor.

<https://www.giz.de/en/ëorldëide/21123.html>

Indeksi për gjithëpërfshirje – fakte dhe opinione. 2014. Save the Children.

Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014. 2013 - 2014 Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë* Anketa me Indikatorë të Shumëfishtë - Klaster, Të gjeturat kyçë. Prishtinë, Kosovë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

http://www.childinfo.org/files/Kosovo_%28UNSCR_1244%29_2013_2014_Key_Findings_Report_%28Roma_Ashkali_and_Egyptian_Communities%29.pdf

Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2011. Regjistrimi i popullsisë dhe banimit në Kosovë 2011 Rezultatet finale. Raporti i cilësisë. 2011. <http://unstats.un.org/unsd/censuskb20/Attachment488.aspx>

Qendra e Arsimit të Kosovës (QAK). 2014. Analizë e shkurtër e situatës në sektorin e arsimit në Kosovë. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

<http://kfos.org/wp-content/uploads/2015/03/BRIEF-SITUATION-ANALYSIS-.pdf>

Manninen Jyri. 2014. Raport vlerësues. Vlerësim i akterëve cilësor relevant nga viti i parë i implementimit të kurrikulës së re të Kosovës. Projekti i Binjakëzimit KS 11 IB OT 02.

Matero Marja. 2014. Raport për analizën e mjedisit mësimor dhe vlerësimi i nevojave të shkollave pilote. Projekti i Binjakëzimit KS 11 IB OT 02.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2014. Udhëzimi Administrativ Nr. 24/2014: Shndërrimi i klasave të bashkangjitura në dhoma të burimeve. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2013. Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2013 Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukativo-arsimore profesionale parauniversitare. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2013. Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2013: Përdorimi i Planit Individual të Arsimit. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2013. Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2013: Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2013. Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2013: Qendrat Burimore. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2012. Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2012: Kualifikimet për personelin që punon me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2012. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012: Kriteret për zgjedhjen e asistentëve dhe instruktorëve për Arsim gjithëpërfshirës dhe obligimet e tyre. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2012. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012: Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore. Republika e Kosovës.



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2012. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012: Kriteret për zgjedhjen e asistentëve dhe instruktorëve për arsim gjithëpërfshirës dhe obligimet e tyre. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2011. Udhëzimi Administrativ Nr. 7/2011: Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2011. Korniza e Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2011. Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0 – 6. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 2011. Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2011- 2016.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2011. Ligji Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2006. Ligji Nr. 02/L-52 për Arsimin Parashkollor. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2013. Ligji Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Afësimin Profesional në Republikën e Kosovës. Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2010. Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2010 – 2015). Republika e Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2007. Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Komponenti i arsimit 2007-2017. Republika e Kosovës.

Mitchell D. 2008. Çka funksionon vërtetë në arsimin special dhe gjithëpërfshirës: Aplikimi i strategjive mësimore të bazuara në evidenca.

OBEZh. 2010. Arsimimi i mësimdhënësve për diversitet: takimi i sfidës (Educating teachers for diversity: Meeting the challenge).

<http://www.oecd.org/edu/ceri/44575633.pdf>

OBEZh. 2010. Kuti e veglave për mësimdhënien e diversitetit (Toolkit on Teaching for Diversity).

<http://www.oecd.org/edu/ceri/toolkitonteachingfordiversity-encounteringandacknowledgingdiversityintheclassroom.htm>

OSBE Misioni në Kosovë. 2010. Profilet e komuniteteve në Kosovë. <http://www.osce.org/kosovo/75450?doenload=true>

OSBE Misioni në Kosovë. 2012a. Raporti mbi Vlerësimin e të Drejtave të Komuniteteve Edicioni i Tretë. <http://www.osce.org/kosovo/92244?doenload=true>

OSBE Misioni në Kosovë. 2012b. Kontribut për Rishikimin e Progresit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2009–2015.



<http://www.osce.org/kosovo/77413?download=true>

OSBE Misioni në Kosovë. 2012c. Implementimi i Masave të Legjislationit me ndikim në të Drejtat e Njeriut në Kosovë. <http://www.osce.org/kosovo/94360?doenload=true>

OSBE Misioni në Kosovë. 2011. Implementimi i Planit të Veprimit për Strategjinë e Integritetit të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. <http://www.osce.org/kosovo/77413?doenload=true>

OSBE Misioni në Kosovë. 2012d. Përcjellja e braktisjes dhe mos-vijimit të shkollave në Kosovë. 2012. <http://www.osce.org/sq/kosovo/95113?doenload=true>

Rus C. 2010. Arsimit cilësor Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Pako të trajnimeve. Këshilli e Evropës.

Savolainen H. & Matero M. & Kokkala H. (edit.). 2006. Kur të gjithë nënkuptojnë të gjithë: Përvoja në tre shtete Afrikane me EFA dhe fëmijë me aftësi të kufizuara. Helsinki: Ministria e Punëve të Jashtme në Finlandë.

Standardet për shkollat mike për fëmijë. 2012. Instituti Pedagogjik i Kosovës. MASHT. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/standardet-per-shkollat-mike-per-femije.pdf>

UNESCO 2000. Korniza e Dakar-it për veprim për arsim për të gjithë: Të takojmë angazhimet tona kolektive, teksti i adoptuar nga Forumi Botëror i Arsimit në Dakar, Senegal, 26-28 Prill 2000,

UNESCO 2000. Dosja e hapur e materialit mbështetës e arsimit gjithëpërfshirës për menaxher dhe administratorë. www.unesdoc.unesco.org

UNESCO 2001. Të kuptojmë dhe t'u përgjigjemi nevoja të fëmijëve në klasa gjithëpërfshirëse: udhëzues për mësimdhënës. www.unesdoc.unesco.org

UNESCO 2004. Ndryshimi i praktikave të mësimdhënies: Aplikimi i ndryshimeve të kurikulës për t'iu përgjigjur diversitetit të nxënësve. Autor: Perner, Darlene. <http://unesdoc.unesco.org/images/0013/001365/136583e.pdf>

UNESCO 2004. Të përqafojmë diversitetin: Kutitë e veglave për mjedise gjithëpërfshirëse, miqësore për nxënie. Bangkok: UNESCO: Zyra Rajonale Aziatike dhe Pacifike për Arsim.

UNESCO 2005. Udhëzuesi për gjithëpërfshirje: të sigurojmë qasje në arsim për të gjithë, Paris.

UNESCO 2009. Udhëzuesi i politikave për gjithëpërfshirje në arsim. Paris: UNESCO.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara. 2007.

Banka botërore. 2012. Kosovë: Boshllëqet gjinore në arsim, shëndetësi dhe mundësi ekonomike. Njësia Evropiane dhe e regjionit të Azisë qendrore për uljen e varfërisë dhe menaxhim ekonomik. <http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2013/08>



[/01/000442464_20130801100834/Rendered/PDF/759300WP0ENGLI0Box0379792B00PUB-LIC0.pdf](#)

Zylfiu H., Mehmeti S. & Mekolli S. 2014. Roli i ndërmjetësuesve për integrimin e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në sistemin e arsimit. Një studim i punës së ndërmjetësuesve gjatë punës së tyre 2013. Raport studimi.



Shtojca 1

Konceptet themelore

Nxënësi i cili e braktisë shkollimin sipas UA Nr. 19/2012 është

- një nxënës i cili ndërpret arsimimin para se të përfundojë arsimin e obligueshëm me ligj;
- Një nxënës i cili vazhdon arsimimin pas përfundimit të arsimit të obligueshëm, mirëpo i cili e ndërpret atë para përfundimit;
- Një fëmijë ose një i ri i cili nuk është regjistruar në shkollë dhe nuk e vijon arsimin e obligueshëm me ligj.

Klasa e bashkangjitur

Klasë e bashkangjitur është një term i cili përdoret në Kosovë për një klasë speciale e cila është e vendosur në ndërtesën e shkollës së përgjithshme. Nxënësit janë me nevoja të veçanta arsimore dhe mësimdhënësit që punojnë në klasë të bashkangjitura janë mësimdhënës me kualifikim special.

Shkollë mike për fëmijë

Një shkollë miqësore për fëmijë është një shkollë e cila u ofron arsim cilësor të gjithë fëmijëve, duke i adresuar të gjitha çështjet që kanë ndikim në mirëqenie, të drejta dhe duke ofruar mjedis miqësor gjatë procesit mësimor për secilin fëmijë. Në shkollat miqësore për fëmijë, fëmija është në qendër të vëmendjes në shkollë në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe implementohen në shkollë. Koncepti është bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF).

Komunitetet

Ligji Nr. 03/L-047 Për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (Neni 1.4.) i përcakton komunitetet si grupe tradicionale kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore ose religjioze të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkallitë, egjiptianët, goranët, malazezët, kroatët dhe komunitetet e tjera.

Diferencimi i kurrikulës

Diferencimi i kurrikulës është procesi i modifikimit ose adaptimit të kurrikulës sipas niveleve të nxënësve në një klasë. Diferencimi mund të bëhet duke ndryshuar përmbajtjen, metodën e mësimdhënies dhe kontekstin e nxënies, si dhe metodat e vlerësimit.

Aftësia e kufizuar

'Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të njëjtë si pjesa tjetër e shoqërisë.' (Konventa e KB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2007).

Aftësi të kufizuar mund të trajtojmë ndërveprimin ndërmjet personit dhe mjedisit të tij ose saj. Ndërhyrjet dhe veprimet e synuara që u mundësojnë njerëzve me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në të gjitha sferat e jetës prandaj duhet të lëvizin përtej konceptit të rehabilitimit dhe trajtimit mjekësor. Të mundësuarit që njerëzit të marrin pjesë në jetën sociale mund të arrihet në shkollë të madhe duke u adresuar barrierat të cilat i pengojnë personat me aftësi të kufizuara në jetën e tyre të përditshme.



Diversiteti

Diversiteti është një koncept i cili mund të përdoret për të diferencuar grupe dhe njerëz nga njëri tjetri. Në arsim, diversiteti mund të trajtohet si karakteristikë që mund të ndikojë në mënyrat e ndryshme në të cilat realizohet potenciali zhvillimor dhe mësim-nxënia, përfshirë këtu diferencat kulturore, gjuhësore, etnike, fetare dhe socio-ekonomike.

Integrimi

Integrimi i referohet arsimimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, të cilët janë të vendosur në shkolla të rregullta dhe të përgjithshme me disa përshtatje dhe resurse, por me kusht që nxënësi mund t'i përshtatet strukturës ekzistuese dhe mjedisit shkollor. Mund të përbëhet nga të mësuarit me afat të shkurtuar në klasë të rregullta në pjesë të caktuara të ditës, shpeshherë për lëndë më pak 'akademike', mirëpo pjesën më të madhe e kalojnë në shkollë në një klasë speciale. Integrimi konsiderohet në disa shtete si aranzhim tranzicional, para se të zbatohet gjithëpërfshirja e plotë.

Barazia gjinore

Barazia gjinore nënkupton dukshmëri, fuqizim, përgjegjësi dhe pjesëmarrje të barabartë për femrat dhe meshkujt në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, dhe një qasje të barabartë për dhe në shpërndarjen e resurseve ndërmjet femrave dhe meshkujve. (Këshilli i Evropës 2013.)

Gjithëpërfshirja dhe arsimiti gjithëpërfshirës

Gjithëpërfshirja është proces i fuqizimit të kapaciteteve në sistemin e arsimit për t'i arritur të gjithë nxënësit pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, gjininë, përkatësinë etnike, gjuhën, aftësitë e kufizuara dhe dëmtimet. Si parim i përgjithshëm, gjithëpërfshirja duhet të udhëzojë të gjitha politikatat dhe praktikatat arsimore, duke filluar nga fakti që arsimiti është një e drejtë themelore njerëzore dhe bazë për një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë. Arsimiti gjithëpërfshirës kërkon rikonstruimin e kulturave, strukturave, përvojave dhe metodologjive në shkolla. Shkollat duhet të transformohen ashtu që të kujdesen për të gjithë fëmijët në komunitete dhe anëtarët e komunitetit janë të nevojshëm për të mbështetur shkollat dhe për të mirëpritur të gjithë fëmijët në shkollë. (UNESCO 2009.)

Segregacioni/Ndarja

Nxënësit me nevoja të veçanta në procesin arsimor vendosen në hapësira të ndara mësimore, të tilla si shkolla speciale ose klasë speciale.

Vështirësitë në mësim-nxënie

Fëmija ka vështirësi në mësim nëse ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim sesa shumica e fëmijëve të asaj moshe; ose nëse fëmija ka një paaftësi e cila e ndalon ose e pengon atë nga përdorimi i pajisjeve arsimore të llojit që ofrohen në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore apo aftësuese. (Ligji i Arsimit Parauniversitar, neni 39.)

Ofrimi i arsimit special

'Ofrimi i arsimit të posaçëm për fëmijët do të thotë ofrimi i arsimit që i shtohet ose dallon nga arsimiti që në përgjithësi bëhet për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore dhe aftësuese të themeluara në komunë. Ofrimi i arsimit special nuk kufizohet vetëm për fëmijët me vështirësi në mësim-nxënie, por ai gjithashtu zbatohet edhe për fëmijët me dhunti të veçanta, të cilët mund të kërkojnë modifikim të modeleve të zakonshme të progresit në sistemin e arsimit të obligueshëm, përfshirë edhe kurrikulën. (Ligji i Arsimit Parauniversitar, neni 39.)

Gjithëpërfshirja sociale

Gjithëpërfshirja sociale përfshin pjesëmarrjen e plotë të të gjithë njerëzve në jetën ekonomike, sociale e kulturore, pavarësisht dallimeve të tyre sociale (të tilla si gjinia, etniteti, shtresa sociale dhe aftësia e kufizuar). (KESP 2011 -2016)



Shtojca 2

Traktate dhe deklarata ndërkombëtare të njohura nga Republika e Kosovës

Konventa e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (1948)

- Siguron të drejtën për arsim pa pagesë dhe të obligueshëm për të gjithë fëmijët.
<http://www.un.org/en/documents/udhr>

Deklarata për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (1975)

- Deklarata për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (1975) përcakton "person me aftësi të kufizuar" secilin person të paaftë për të siguruar vetvetiu plotësisht ose pjesërisht, nevojat e jetës normale individuale ose sociale, si rezultat i mungesës ose pamjaftueshmërisë, qoftë kongjenitale ose jo, në aftësitë e tij ose saj fizike ose në aftësitë mendore.
- Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën për --- arsim, aftësim profesional dhe riaftësim, ndihmë, këshillim, shërbime të punësimit dhe shërbime të tjera të cilat u mundësojnë atyre zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të tyre deri në maksimum, dhe që do të shpejtojnë proceset e integritit të tyre social ose ri-integritit.
- Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë që nevojat e tyre të veçanta të merren parasysh në të gjitha shkallët e planifikimit ekonomik dhe social.
- Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të jetojnë me familjet e tyre, ose me prindër strehues dhe të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet sociale, kreative ose rekreative. Asnjë person me aftësi të kufizuara nuk i nënshtrohet trajtimeve të diferencuara për sa i përket vendbanimit të tij ose saj, përpos atyre që janë të domosdoshme për shkak të rrethanave të tij ose saj, ose nëse nga trajtimi mund të dal një përmirësim. Nëse qëndrimi i një personi me aftësi të kufizuara në një institucion të specializuar është i domosdoshëm, atëherë mjedisi dhe kushtet e jetës në atë institucion duhet të jenë aq të përafërta sa të jetë e mundur me ato të jetës reale të një personi të moshës së tij ose saj.
- Personat me aftësi të kufizuara duhet të mbrohen nga shfrytëzimi, të gjitha rregulloret dhe trajtimet e një natyre diskriminuese, abuzive ose degraduese.

<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RightsOfDisabledPersons.aspx>

Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës (1989)

Konventa (Neni 23) përcakton të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore ose fizike për të bërë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushtet që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe e lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në jetën e bashkësisë. Ajo thotë, që një fëmijë me aftësi të kufizuara duhet të ketë qasje efektive në arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integritim shoqëror dhe zhvillim vetjak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

Neni 29 për arsim thotë, që arsimimi i fëmijës duhet të jetë i drejtuar për të zhvilluar në mënyrë sa më të plotë personalitetin, talentin dhe aftësitë mendore e fizike të fëmijës. Për më tepër, theksohet zhvillimi i respektit për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit të origjinës dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti. Fëmija duhet të përgatitet për një jetë të përgjegjshme në shoqëri të lirë, në frymë të mirëkuptimit, paqes, tolerancës,



barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone.

[http://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version\(3\).pdf](http://www.unicef.org/tfymacedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf)

Deklarata Botërore e Arsimit për të Gjithë, Jomtien Tajlandë (1990)

Deklarata Botërore e Arsimit për të Gjithë (APGj) riafirmon nocionin e arsimit si një të drejtë njerëzore themelore dhe u ka kërkuar shteteve intensifikimin e përpjekjeve për të adresuar nevojat elementare mësimore të të gjithëve. Me qëllim të realizimit të këtij synimi, koalicioni i gjerë i qeverive kombëtare, grupeve të shoqërisë civile dhe agjencive zhvillimore të tilla si UNESCO dhe Banka Botërore është zotuar për të arritur gjashtë objektiva specifike të arsimit:

- Zgjerimin dhe përmirësimin e edukimit dhe përkujdesjes në fëmijërinë e hershme, posaçërisht për fëmijët më të rrezikuar dhe të pafavorizuar.
- Të sigurohet që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, posaçërisht vajzat, të cilat janë në rrethana të vështira dhe ata që i përkasin minoriteteve etnike, kanë qasje të lirë dhe cilësore për të përfunduar arsimin fillor dhe të obliguar.
- Të sigurohet plotësimi i nevojave mësimore për gjithë të rinjtë dhe të rriturit me qasje të barabartë në mësimnxënie për të gjithë dhe në programet e shkathtësive jetësore.
- Të arrihet 50% e përmirësimit të shkrim-leximit të të rriturve deri në vitin 2015, posaçërisht e grave, dhe qasje të barabartë në arsimin bazik dhe të vazhdueshëm për të gjithë të rriturit.
- Largimin e pabarazive gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm deri në vitin 2005, dhe arrijen e barazisë gjinore në arsim deri në vitin 2015, me fokus në sigurimin e integritetit të plotë dhe të barabartë të vajzave në arsimin fillor me cilësi të mirë.
- Përmirësimin e të gjitha aspekteve të cilësisë së arsimit dhe sigurimin e cilësisë së shkëlqyeshme për të gjitha rezultatet e matshme dhe të njohura mësimore të arritura nga të gjithë, posaçërisht në shkrim-lexim, numërim dhe shkathtësi esenciale jetësore.

<http://www.unesco.org/new/en/education/themes/leading-the-international-agenda/education-for-all/the-efa-movement/jomtien-1990/>

Rregullat standarde për Mundësi të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara (1993)

Rregulli 6 për Arsimin përcakton që shteti duhet të njohë parimin e mundësive të barabarta në arsimin fillor, të mesëm dhe terciar për fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, në mjedise integruese. Ata duhet të sigurojnë që arsimimi i personave me aftësi të kufizuara është pjesë integrale e sistemit të tyre të arsimit dhe duhet të ofrohet në "mjedise të integruara" dhe në "mjedise të përgjithshme shkollore."

<http://www.un.org/esa/socdev/enable/dissre00.htm>

Deklarata e Salamankës (1994)

Deklarata e Salamankës ishte traktati i parë ndërkombëtar që ka mbështetur të drejtat e njeriut në perspektivën e arsimit, duke deklaruar që gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja janë qenësore për dinjitetin dhe kënaqësinë e njeriut, si dhe për ushtrimin e të drejtave të njeriut.

- "... shkollat duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët pa dallim të parakushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose të tjera." Këtu duhet të përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata të talentuar, fëmijët e rrugës dhe



ata që punojnë, fëmijët nga popullsia rurale dhe shtegtuese, fëmijët e pakicave gjuhësore, etnike ose kulturore dhe fëmijët nga vende ose grupe të tjera të pafavorizuara ose marginalizuara."

Deklarata proklamon që:

- Çdo fëmijë ka të drejtën themelore për arsim dhe secilit duhet t'i jepet mundësia të arrijë dhe të mbaj nivele të pranueshme të mësimnxënies;
- Çdo fëmijë ka karakteristika, interesa, aftësi dhe nevoja unike mësimore;
- Dizajnimi i sistemeve arsimore dhe implementimi i programeve arsimore duhet të bëhet në mënyrë që të merren parasysh diversiteti i gjerë i këtyre karakteristikave dhe nevojave;
- Personat me nevoja të veçanta arsimore duhet të kenë qasje në shkollat e rregullta, të cilat duhet t'i përfshijnë ata në pedagogjinë me nxënësin në qendër dhe e të cilat plotësojnë nevojat e tyre;
- Shkollat e rregullta me këtë orientim gjithëpërfshirës janë mjete efektive në luftimin e qëndrimeve diskriminuese, krijimit të komuniteteve mirëpritëse, ngritjes së një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe arritjes së arsimimit për të gjithë. Për më shumë ato ofrojnë një arsimim efektiv për shumicën e fëmijëve (pa nevoja të veçanta) dhe përmirëson efikasitetin dhe efektivitetin përfundimtar të kostos në tërë sistemin e arsimit.

http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF

Korniza për veprim e forumit botëror të arsimit e Dakar-it (2000)

Forumi botëror i arsimit i Dakar-it rikonfirmoi vizionin e Deklaratës botërore mbi arsimin për të gjithë (Jomtien 1990), mbështetur nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Forumi u përkushtua për arritjen e qëllimeve që vijojnë:

- Zgjerimin dhe përmirësimi i kujdesit dhe arsimimit fëmijëror , sidomos për fëmijët më të rrezikuar dhe të pafavorizuar;
- Deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, veçanërisht vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që u përkasin pakicave kombëtare, të kenë qasje të plotë, të lirë dhe arsimim të obligueshëm fillor të cilësisë së mirë;
- Nevojat e mësimimit të të gjithë të rinjve dhe të rriturve të përmbushen, me qasje të barabartë në programet përkatëse të mësimimit dhe të aftësive jetike;
- Arritjen e përmirësimimit për 50 për qind të nivelit të shkrim-leximit të të rriturve deri në vitin 2015, sidomos për gratë, dhe qasje të barabartë në arsimin fillor dhe vazhdimin e arsimit për të gjithë të rriturit;
- Eliminimin e pabarazive gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm deri në vitin 2005, dhe arritjen e barazisë gjinore në arsim deri në vitin 2015, me fokus në sigurimin e qasjes së plotë dhe të barabartë të vajzave në arsimimin bazik të cilësisë së mirë; dhe
- Përmirësimi i të gjitha aspekteve të cilësisë së arsimit dhe sigurimi i përsosmërisë për të gjithë në mënyrë që rezultatet e njohura dhe të matshme mësimore të arrihen nga të gjithë, sidomos në shkrim-lexim, matematikë dhe aftësitë thelbësore të jetës.

<http://www.unesco.org/education/wef/en-conf/dakframeng.shtm>

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të OKB-së, OZHM (2000)

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM) janë përpiluar themeluar pas Samitit të Mijëvjeçarit të OKB-së në vitin 2000 dhe miratimit të Deklaratës së Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit deri më 2015 ishin:

1. Çrrënjësja e varfërisë së skajshme dhe urisë;



2. Arritja e arsimit fillor të përgjithshëm;
3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave;
4. Reduktimi i vdekshmërisë së fëmijëve;
5. Përmirësimi shëndetit të nënave;
6. Luftimi i HIV / AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera;
7. Qëndrueshmëria e mjedisit;
8. Partneriteti global për zhvillim;

http://www.who.int/topics/millennium_development_goals/about/en/

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007)

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2007 është një traktat ndërkombëtar që identifikon "të drejtat e personave me aftësi të kufizuara si dhe si detyrimet e Shteteve Palë të Konventës për të promovuar, mbrojtur dhe siguruar këto të drejta. Ajo thotë se aftësia e kufizuar është një koncept evolutiv dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi i dëmtimeve të personave me çrregullime dhe pengesa qendrimore dhe mjedisore që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

Konventa deklaron se të gjithë anëtarët e shoqërisë kanë të njëjtat të drejta, duke përfshirë të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale. Ajo gjithashtu thekson se "të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jenë të lirë nga diskriminimi në gëzimin e të drejtave të tyre. Kjo përfshin të drejtën për të qenë i lirë nga diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar, por edhe në ndonjë bazë, si raca, ngjyra, seksi, gjinia, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, origjina kombëtare a shoqërore, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër".

Neni 8 për ngritjen e vetëdijes fton shtetet palë të marrin përsipër të ndërmarrin masa të menjëhershme, efektive dhe të përshtatshme:

- Për të rritur vetëdijesimin e shoqërisë, duke përfshirë punën me familjet, lidhur me personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të nxitjes së respektit për të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuar;
- Për të luftuar stereotipat, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme lidhur me personat me aftësi të kufizuar, përfshirë dhe ato në bazë të gjinisë dhe moshës, në të gjitha fushat e jetës;
- Për të nxitur rritjen e vetëdijesimit lidhur me aftësitë dhe kontributin e personave me aftësi të kufizuar.

Neni 24 i Konventës deklaron të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsimim pa diskriminim dhe mbi bazën e mundësive të barabarta dhe sigurimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. E drejta për arsimim kërkon që:

- Personat me aftësi të kufizuar të mos jenë të përjashtuar nga sistemi i arsimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar dhe që fëmijët me aftësi të kufizuar të mos jenë të përjashtuar nga arsimimi pa pagesë dhe i obligueshëm fillor, ose arsimit mesëm, për shkak të aftësisë së kufizuar;
- Personat me aftësi të kufizuar mund të kenë qasje në arsimin fillor gjithëpërfshirës, cilësor dhe pa pagesë dhe arsimin e mesëm njësoj si të gjithë fëmijët e tjerët në komunitetet ku ata jetojnë;
- Sigurohet akomodimi i arsyeshëm i kërkesave individuale;
- Personat me aftësi të kufizuar marrin mbështetjen e kërkuar, brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm për të mundësuar arsimimin e duhur të tyre;



- Sigurohen masa mbështetëse efikase dhe të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në përputhje me qëllimin për përfshirjen e tyre të plotë.

Personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të mësojnë aftësitë për zhvillim shoqëror dhe jetësor për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në arsim dhe si pjesëtarë të komunitetit dhe për të mundësuar realizimin e kësaj të drejte, masa përkatëse duhet të merren, duke përfshirë:

- Lehtësimin e të mësuarit të Brail-it, shkrimeve alternative, mënyrave argumentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit dhe orientimit, aftësive të lëvizshmërisë, lehtësimin e mbështetjes dhe mentorimit të moshatarëve;
- Lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe nxitjen e identitetit lingistik të personave që nuk dëgjojnë;
- Të sigurohet që arsimimi i individëve, dhe në veçanti fëmijëve, të cilët janë të verbër, të shurdhër, apo që janë të shurdhër edhe të verbër, të jepet në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror të tij/saj;
- Të punësohen mësimdhënës, duke përfshirë mësimdhënës me aftësi të kufizuara, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo Brail-it, dhe të trajnojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore

<http://www.un.org/disabilities/convention/conventionfull.shtml>



Shtojca 3

Projektet në mbështetje të zhvillimit të arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë

Gjatë 15 viteve ka pasur projekte të shumta të financuara nga donatorët me qëllimin e përmirësimit të cilësisë në sistemin arsimor. Projektet lidhur me arsimin gjithëpërfshirës janë prezantuar në këtë shtojcë.

Finlanda

Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës ka mbështetur sektorin e arsimit në Kosovë, veçanërisht në fushën e arsimit special dhe gjithëpërfshirës gjatë viteve 2000 - 2013 përmes katër projekteve me shumën e përgjithshme prej 8.5 milion euro. Këto programe dhe rezultatet e tyre ishin si në vijim:

Faza e parë "Përkrahja Finlandeze për Sektorin e Arsimit në Kosovë (FSDEK)," ka filluar përpjekjet dhe aktivitetet për të futur arsimin gjithëpërfshirës/nevojat e veçanta në sistemin arsimor në Kosovë në vitin 2000 - 2003. Gjatë këtij projekti, rreth 35 profesionistë të arsimit kanë marrë pjesë në një trajnim të gjerë të zhvillimit profesional për arsimin special. Përveç kësaj, rreth 20 trajnerë janë trajnuar në trajnimin TESFA/DShEPGj (Drejt shkollave efektive për të gjithë). Me mbështetjen e projektit, filloi edhe krijimi i klasave të bashkangjitura.

Faza e dytë "Përkrahja Finlandeze për Sektorin e Arsimit në Kosovë FSDEK II" është zbatuar në vitin 2004 - 2008. Projekti ishte i fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimin profesional në fushën e arsimit gjithëpërfshirës/nevoja të veçanta. Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte për të kontribuar në reformën arsimore në Kosovë përmes zhvillimit të një sistemi arsimor gjithëpërfshirës që do të ishte i dobishëm për të gjithë nxënësit që përballen me pengesa në të mësuarit dhe do të modelojë respektin dhe bashkëjetesën paqësore ndërmjet të gjithëve. Qëllimi i projektit ishte që ta vë filozofinë e arsimit gjithëpërfshirës në qendër të të gjitha programeve të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve, duke marrë masa që të gjithë mësimitdhënësit në Kosovë të jenë më të trajnuar për t'i mësuar nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, dhe kështu të rritet përfshirja në shkollat e Kosovës.

Si rezultat i mbështetjes së dhënë për MASHT-in:

- 3 kurse të zhvillimit profesional me rreth 105 pjesëmarrës janë realizuar. Çdo kurs i zhvillimit profesional ka zgjatur 1,5 vjet dhe pjesëmarrësit janë trajnuar çdo muaj për 5 ditë;
- Rreth 1000 mësimitdhënës nga gjithë Kosova morën pjesë në trajnimin TESFA për arsimin gjithëpërfshirës;
- Reforma në qendra burimore për t'i transformuar shkollat speciale në qendra burimore kishte filluar në 3 ish-shkolla speciale, projekti kishte punësuar 6 mësimitdhënës udhëtues për të punuar në qendrat burimore dhe për të mbështetur shkollat e rregullta;
- Fushatë vetëdijesimi me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe njohurive mbi çështjet e aftësisë së kufizuar dhe arsimit gjithëpërfshirës ishte bërë për tre muaj në mbarë Kosovën; dhe
- Antologjia "Zhvillimi i Arsimit Gjithëpërfshirës në Kosovë - Sfidat dhe Rezultatet" me përvojat e fituara gjatë vitit 2000 -2008 është botuar.

Si rezultat i mbështetjes së dhënë Fakultetit të Edukimit:

- 13 studentë të diplomuar nga Programi Master në arsimin gjithëpërfshirës, i cili qe zbatuar në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Jyväskylä në Finlandë;

- Zhvillimi i tre kurseve të trajnimit të mësimdhënësve para-shërbimit është mbështetur: 1) Arsimit me nevoja të veçanta dhe metodologjia (i detyrueshëm për të gjithë studentët e Fakultetit të Edukimit); 2) vështirësitë në mësimnxënie (kurs opsional); dhe 3) Elementet e logopedisë (opsional); dhe
- Një qender mësimorë me pajisje të TIK-ut, hapësira për konferencë dhe punë kërkimore është themeluar në Fakultetin e Edukimit pranë Universitetit të Prishtinës.
- 3 konferenca në fushën e zhvillimit profesional në bashkëpunim me KEDP janë organizuar;
- 16 anëtarë të stafit kanë marrë mbështetje për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë kanë pasur mundësi për të krijuar rrjete profesionale ndërkombëtare; dhe
- Mbështetja është ofruar për botimin e disa dorëshkrimeve të shkruara nga profesorë të Universitetit të Prishtinës.

Faza e tretë "Përkrahja Finlandeze Institucionale për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës" ishte program i mbështetur nga Universiteti Jyväskylä në vitin 2009 - 2010. Ky program ka vazhduar kontributin e programeve të mëparshme, duke përfshirë p.sh. vazhdimin e programit të zhvillimit profesional. Projekti ka mbështetur MASHT-in në përgatitjen e udhëzimeve kombëtare të planeve të individualizuara arsimore dhe në zgjerimin e reformës së qendrave burimore që kishte filluar gjatë FSDEK II.

Faza e katërt e mbështetjes finlandeze ishte "Mbështetja Finlandeze për Sistemin e Arsimit Gjithëpërfshirës në Kosovë" (FSIESK) që ishte projekt dyvjeçar, i zbatuar në vitin 2011 - 2013. Projekti ishte disenjuar për të mbështetur elementet e zbatimit të arsimit gjithëpërfshirës në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011 - 2016 dhe Planin Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me NVA në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2010 - 2015. Rezultatet kryesore të projektit ishin, si në vijim:

- Një studim ndërhyrës për vështirësitë në lexim dhe shkrim u realizua në 8 shkolla, katër prej tyre si shkolla model të cilat janë mbështetur me krijimin e klubeve të leximit në shkollë, dhe katër shkolla kontrolluese me rreth 1700 nxënës. Rezultatet e studimit treguan se mbështetja e dhënë nëpërmjet klubeve të leximit është efektive për nxënësit që kanë vështirësi në lexim dhe shkrim. Një mjet vlerësimi grupor për leximin dhe shkrimin ishte zhvilluar për kontekstin e Kosovës.
- Udhëzimi Administrativ për përdorimin e PIA-ve ishte publikuar nga MASHT-i në katër gjuhë: gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke dhe një kurs për përdorimin e PIA-ve ishte akredituar nga MASHT-i, ishin organizuar trajnime për rreth 200 pjesëmarrës, një grup mësimdhënësish ishin trajnuar për të punuar si trajnerë të PIA-ve.
- 8 kurse trajnimi të FSIESK-ut janë akredituar nga MASHT-i: 1) Vështirësitë biheviore; 2) Vështirësi në lexim; 3) Drejt shkollave efektive për të gjithë (TESFA/DShEPGj); dhe 4) Plani I individualizuar arsimor (PIA); 5) Mësimi i bazuar në fushat e aktivitetit; 6) Mësimi i fëmijëve me Autizëm; dhe 7) Ndërtimi i rrjetit për mbështetje për NVA, dhe 8) PIA; dhe trajnime me 20 tema dhe 64 ditë trajnimi me më shumë se 883 pjesëmarrës që përfaqësonin profesionistët në të gjitha nivelet e sistemit arsimor dhe anëtarët e stafit të departamenteve të mirëqenies sociale të komunave.
- Udhëzimi Administrativ për Qendrat Burimore (QB) është hartuar; funksionimi dhe rritja e kapaciteteve të QB-ve ishte forcuar; dhe trajnime për stafin e QB-ve me temat në vijim ishin realizuar: 1) Zhvillimi i rrjeteve mbështetëse për fëmijë me NVA, për menaxhim të QB-ve dhe mësimdhënësit udhëtues; 2) Si mund të punojnë QB-të si ofrues të shërbimeve në shkollat e zakonshme; 3) Metodologjitë e reja të të mësuarit dhe mësimdhënies; 4) Përdorimi i PIA-ve ; 5) Prodhimi i materialeve shitesë dhe alternative për komunikim; 6) Trajnim të përshtatur për QB-të ; 7) Mësimi i fëmijëve autistik; dhe 8), si një nismë e re në Kosovë, FSIESK ka ofruar trajnime dhe punëtori në mësimin sipas fushave të aktivitetit në mënyrë që të përmirësohet arsimimi i nxënësve me aftësi të kufizuara të rënda intelektuale dhe të shumëfishta.



Asociacioni Kosovar për Promovimin e Arsimit Gjithëpërfshirës (KAPIE) ka realizuar projektin Mbështetje në reformën e arsimit gjithëpërfshirës në vitin 2014 - 2015. Objektivi i përgjithshëm i projektit të financuar nga Ambasada Finlandeze në Prishtinë ishte për të forcuar sistemin mbështetës dhe për të rritur përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në mësimnxënie. Objektivat specifike ishin për të rritur vetëdijen dhe kapacitetet e autoriteteve komunale të arsimit të organizojnë sistem mbështetjeje për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për të forcuar aftësitë e mësimitdhënësve për të adresuar nevojat e ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në mësimnxënie, në lexim dhe drejtshkrim në shkollat e zakonshme.

Projekti ka mbështetur 4 shkolla fillore të rregullta në 2 komuna për t'i bërë ato më gjithëpërfshirëse. Mësimitdhënësit në këto shkolla ishin trajnuar në arsimin gjithëpërfshirës, si të përdoren planet individuale arsimore, si të përdoren mjetet e vlerësimit të leximit dhe drejtshkrimit dhe si të prodhohen materiale alternative për të organizuar mësimin shtesë për nxënësit me vështirësi në lexim. Shkollat ishin mbështetur për të krijuar dhe organizuar 'Klube të leximit' për nxënësit me vështirësi të mëdha në lexim dhe drejtshkrim. Mësimitdhënësit ishin trajnuar mbi parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe se si t'i përdorin planet individuale arsimore.

Përveç kësaj, projekti ka mbështetur MASHT-in në zhvillimin e doracakut për mësimitdhënie të bazuar në fushat e aktivitetit, duke ngritur kapacitetet e DKA-ve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, trajnimin e trajnerëve për përdorimin e PIA-s dhe trajnimin e mësimitdhënësve në klasë të bashkangjitura për prodhimin dhe përdorimin e materialeve alternative mësimore për nxënësit me NVA.

KAPIE ka filluar fazën e dytë të projektit "Mbështetje për Reformën e Arsimit Gjithëpërfshirës, 2015 - 2016" që ka për qëllim:

- Forcimin e aftësive të mësimitdhënësve për të adresuar nevojat e ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta, krijimin e praktikave të mira dhe ofrimin e mjeteve praktike për mësimitdhënësit në mbështetjen e nxënësve me vështirësi në lexim dhe drejtshkrim.
- Mbështetjen e 34 shkollave fillore për të krijuar praktikat e mira për mbështetje të fëmijëve me vështirësi në lexim dhe drejtshkrim duke përfshirë trajnimin e mësimitdhënësve lidhur me vështirësitë në lexim dhe drejtshkrim dhe krijimin e klubeve të leximit.
- Mbështetjen e MASHT-it në fushën e mësimitdhënies sipas fushave të aktivitetit, në ngritjen e kapaciteteve të DKA-ve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, në hartimin e strategjisë 5-vjeçare për fëmijët me nevoja të veçanta dhe në organizimin e konferencës për arsimin gjithëpërfshirës.

UNICEF

UNICEF-i ka mbështetur MASHT-in në përpilimin e Standardeve për zhvillim dhe mësim të hershëm të fëmijëve të moshës 0 - 6, dhe Standardet për shkollat miqësore për fëmijë në Kosovë.

Standardet për zhvillim dhe mësim të hershëm për fëmijët e moshës 0 - 6 janë bërë në vitin 2011 dhe pas kësaj të gjithë edukatorët në Kosovë kanë marrë pjesë në një program trajnimi gjatë shërbimit me 6 module që është realizuar për 7 ditë. Standardet mund të përdoren nga kushdo që është i interesuar në zhvillimin e fëmijërisë së hershme.

Në vitin 2012 UNICEF-i në bashkëpunim me MASHT-in dhe Institutin Pedagogjik të Kosovës ka zhvilluar Standardet për shkollat mike për fëmijë në Kosovë për të përmbushur nevo-



jën që doli nga ndryshimet e bëra në fushën e kurrikulës dhe për të mbështetur qëllimin e krijimit të shkollave të efektshme, të shëndetshme, të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, me një pjesëmarrje aktive të prindërve dhe komunitetit. (Shtojca 5) Përveç këtyre, një numër i mjeteve për vlerësim të jashtëm dhe vetë-vlerësim për matjen e performancës së shkollës janë hartuar dhe do të pilotohen. Mjeti thekson gjithëpërfshirjen në performancën e shkollës.

Në kuadër të projektit për "Zbatimin të standardeve të shkollave mike për fëmijë – Drejt shkollave gjithëpërfshirëse", UNICEF-i në bashkëpunim me IPK-në ka kryer një studim bazik që ka të bëjë me fëmijët jashtë shkollës në Kosovë në 7 komuna dhe 14 shkolla në vitin 2013. Me këtë projekt janë ndihmuar komunat në analizimin e profileve të fëmijëve që e braktisin shkollën. Si rezultat, komunat kanë përgatitur planet e veprimit për parandalimin e braktisjes.

UNICEF-i është duke bërë ngritjen e kapaciteteve në mesin e stafit të SMIA-s në MASHT për të përdorur, planifikuar dhe shpërndarë të dhënat e mbledhura arsimore.

Save the Children

Save the Children është duke punuar në Kosovë që nga viti 1999. Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe kontribuon në cilësinë e lartë të arsimit për të gjithë me fokus të veçantë në arsimin parashkollor, parafillor dhe fillor dhe arsimimin e fëmijëve nga grupet e marginalizuara. Ajo ka qenë e fokusuar në adresimin e legjislacionit dhe politikave, avokimin dhe mobilizimin e shoqërisë civile dhe prindërve të fëmijëve me NVA dhe gjithashtu në ndërtimin e kapaciteteve për përmirësimin e cilësisë në arsim.

Save the Children ka mbështetur trajnimin e edukatorëve për metodologjitë dhe themelimin e 4 qendrave burimore rajonale, ku 514 edukatorë parashkollorë janë trajnuar për të punuar me fëmijë me nevoja të veçanta.

Programi i edukimit për të promovuar kujdesin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme me qëllim të rritjes së vetëdijes mbi rëndësinë e KZHFH-së dhe vazhdimin e punës me partnerët duke u fokusuar në fushat kyçe për intervenime është zbatuar në disa kopshte dhe shkolla fillore në 9 komuna të 7 rajoneve.

Projekti i Save the Children "Promovimi i arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta" kishte për qëllim:

- Ngritjen e vetëdijes për të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore duke themeluar një organ të vetë-qëndrueshëm të avokimit që përfshin OJQ-të lokale të tilla si Handikos-i dhe shoqatat e prindërve, duke përfshirë edhe vetë fëmijët.
- Mbështetjen e praktikave rehabilituese të bazuara në komunitet në 8 qendra rehabilituese të Handikos-it me bazë në komunitet me qëllim për të stimuluar dhe për të avancuar aftësitë fizike dhe psiko-sociale të qindra fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve parashkollorë dhe fillore në implementimin e praktikave të arsimit gjithëpërfshirës dhe shërbimeve për të gjithë fëmijët, e sidomos të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.
- Rritja e vetëdijes së prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore për të drejtën/detyrën për t'i regjistruar fëmijët e tyre në institucionet parashkollorë dhe parafillorë/shkollën fillore, dhe për të rritur përfshirjen e institucioneve arsimore, sektorëve të tjerë përkatës, si dhe anëtarëve të shoqërisë civile, për të lehtësuar procesin e përgjithshëm të arsimit gjithëpërfshirës.
- Mbështetja e trajnimit të mësimeve, edukatorëve, drejtorëve të shkollave,



ekipeve profesionale dhe punëtorëve në nivele formale dhe jo-formale në metodologjitë e arsimit gjithëpërfshirës.

- Krijimi i Ekipe Burimore të Projektit, të përbërë nga profesione të ndryshme për të mbështetur dhe këshilluar edukatorët dhe mësime dhënësit gjithëpërfshirës në zbatimin e projekteve të arsimit gjithëpërfshirës.
- Sigurimi i materialeve të ndryshme didaktike, lodrave të përshtatshme për fëmijë në mënyrë që fëmijët të kenë qasje në arsim cilësor, duke u mundësuar edukatorëve kryerjen e aktiviteteve të ndryshme pa probleme dhe përmirësimin e procesit.
- Përmirësimi i qasjes për fëmijët me nevoja të veçanta përmes intervenimeve në rehabilitimin e strukturave të ndryshme në institucionet parashkollore.

<https://kosovo.savethechildren.net/ehat-we-do/education>

Indeksi për gjithëpërfshirjen është përshtatur për kontekstin e Kosovës në vitin 2007 nga Save the Children dhe është përfshirë në Planin Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2010-2015, si pjesë e PSAK 2011-2016. (Shtojca 6.)

USAID

Programi i Arsimit Themelor

Programi pesë vjeçar i arsimit themelor (PATH/BEP) i financuar nga USAID-i dhe Qeveria e Kosovës ka filluar në vitin 2010. Qëllimi kryesor i projektit është të përmirësojë kapacitetet institucionale të Qeverisë së Kosovës në sektorin e arsimit dhe të përmirësojë cilësinë e arsimit fillor. Motoja e projektit është "Zhvillimi i shkathtësive të nxënësve të shekullit 21 me shkollat dhe komunitetet". Për këtë qëllim BEP kërkon të përmirësojë kapacitetet e shkollave të Kosovës për të ofruar shkathtësi relevante për nxënësit e tyre. Projekti i përfshinë tre komponentë:

- Ngritja e kapaciteteve të menaxhmentit të shkollës në mjedisin e decentralizuar;
- Përforsimi i vlerësimit të rezultateve të mësim-nxënies; dhe
- Përmirësimi i zhvillimit profesional të mësime dhënësit gjatë shërbimit.

PATH punon në përmirësimin e shkathtësive të leximit të nxënësve dhe për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë qytetarët pavarësisht gjinisë, orientimit seksual ose etnisë. Projekti ka prodhuar një numër të madh të librave udhëzues dhe materialeve për mësime dhënësit, drejtorët, nxënësit dhe prindërit.

1) Vlerësimi i leximit

USAID-i ka filluar me studimin "Vlerësimi i leximit në klasat e hershme" (EGRA) në 40 shkollë - rurale dhe urbane - në vitin 2012. 800 nxënës janë zgjedhur me metodën e rastësishme nga klasat e dyta dhe janë testuar në fund të vitit shkollor. Testimi i dytë me nxënës të tjerë është realizuar në vitin 2014, dhe testimi përfundimtar në vitin 2015. Mësime dhënësit janë trajnuar dhe u janë dhënë materiale: libra leximi për klasat 1 dhe 2, "minilibra" të cilat nxënësit mund t'i presin, ngjisin, vizatojnë në to, ngjyrosin dhe lexojnë, dhe "libra të mëdha", të cilat nxënësit mund t'i përdorin për mësimin e gjithë grupit. Rezultatet e studimit pritet të tregojnë se si këto materiale shtesë që përdoren në mësimin e leximit mund të përmirësojë rezultatet në aftësitë e leximit.

2) Gjithëpërfshirja

USAID-i ka realizuar trajnime të shumta për zhvillim profesional me bazë në shkollë me 59 krye-trajnerët të cilët janë ekspertë nga fusha të ndryshme, si dhe trajnime për menaxhim për drejtorët e shkollave. Çështjet që lidhen me gjithëpërfshirjen dhe veçanërisht me çështjet gjinore kanë qenë të përfshira në të gjitha këto trajnime dhe janë prodhuar edhe materiale. BEP ka prodhuar një listë kontrolli për vet- vlerësimin e mësime dhënësit lidhur me barazinë gjinore në klasë, dhe një listë kontrolli për përzgjedhjen e librave neu-



tral sa i përket aspektit gjinor.

Që nga shtatori i vitit 2014, me kërkesë të Zyrës së Kryeministrit, USAID-i ka përfshirë çështje që lidhen me të drejtat e lesbikeve, homoseksualëve, bi-seksualëve dhe trans-seksualëve (LGBT) në të gjitha aktivitetet e tyre. Katër zyrtarë nga MASHT-i janë trajnuar në këtë fushë dhe materialet që kanë të bëjnë me LGBT-në u janë dhënë drejtorëve për ngritjen e vetëdijes. Trajnimet e kryera nga krye-trajnerët që nga shtatori i vitit 2014 kanë përfshirë jo vetëm çështjet gjinore por edhe çështjet e LGBT-së.

Përveç kësaj, USAID-i punon edhe me komunitetet pakicë në të gjitha aktivitetet e veta duke përfshirë prodhimin e materialeve dhe publikimin e tyre. Dy nga krye-trajnerët përfaqësojnë komunitetet pakicë.

3) Trajnimet për vlerësimin formativ

USAID-i është duke realizuar programin e trajnimit për vlerësimin formativ, i cili do të arrijë tek të gjithë mësimdhënësit e Kosovës. Janë prodhuar Standardet për vlerësimin formativ si dhe broshura.

GIZ

GIZ është duke zbatuar projektin e Zhvillimit të kapaciteteve në arsimin themelor (CDBE) në Kosovë (2010 - 2018) i implementuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Projekti synon të përmirësojë cilësinë e arsimit themelor në gjashtë komuna pilote në fushat e menaxhimit të arsimit, zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe përfshirjen e lëndëve të orientuara në të ardhmen në kurrikulat e shkollave shtetërore. Si pjesë e aktiviteteve për menaxhimin e arsimit, drejtorët e shkollave dhe drejtoritë komunale të arsimit janë mbështetur në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e gjithëpërfshirjes.

BE/Këshilli i Evropës

Programi i Binjakëzimit për mbështetjen e zbatimit të Planit strategjik të sektorit të arsimit në Kosovë 2011 – 2016 (Binjakëzimi Nr. KS 11 IB OT 02) i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga Omnia, Autoriteti i përbashkët i arsimit në rajonin Espoo (Finlandë) në partneritet me KulturKontakt Austria ka filluar në muajin Mars të vitit 2014 dhe do të zgjasë gati 3 vjet.

Objektivi i përgjithshëm i programit është të rrisë cilësinë e arsimit parauniversitar në Kosovë, të inkurajojë arsimin gjithëpërfshirës dhe të promovojë diversitetin kulturor, dialogun dhe bashkëpunimin. Qëllimi i programit është të përmirësojë cilësinë dhe relevancën e arsimit përmes implementimit të kurrikulës së re të modernizuar (KKK), ndërtimi i kapaciteteve të edukatorëve, zbatimi i masave të sigurimit të cilësisë në arsim dhe mbështetja për ofrimin e mjeteve dhe pajisjeve relevante shkollore dhe dorëzimin e instalimit të tyre në shkolla në mënyrën e duhur. Komponentët dhe aktivitetet kryesore të programit janë këto në vijim:

Komponenti 1: Zhvillimi i kurrikulës dhe zbatimi i saj në klasë

- Pilotimi dhe zbatimi i KKK-së së re dhe kurrikulës bërthamë
- Ngritja e kompetencave të mësimdhënies në pajtueshmëri me KKK
- Forcimi i bashkëpunimit dhe lidhshmërisë në sektorin e arsimit parauniversitar në Kosovë

Komponenti 2: Sigurimi i cilësisë në arsim

- Mbështetja zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në bazë të praktikave të mira



të BE-së

- Sigurimi i cilësisë me bazë në shkollë
- Mekanizmat dhe instrumentet efektive të monitorimit

Komponenti 3: Mjetet dhe pajisjet shkollore

- Analiza dhe zhvillimi i mjediseve mësimore për mbështetjen e KKK-së
- Prokurimi për mbështetjen e KKK-së
- Monitorimi dhe mbështetja e dorëzimit dhe përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve shkollore.

Projekti bashkëpunon ngushtë me MASHT-in, DKA-të, shkollat, dhe autoritetet e organizatave të tjera relevante për fushën e arsimit në Kosovë. Pasi që gjithpërfshirja është njëra nga parimet kryesore të KKK-së, ajo është ngulitur në të gjitha aktivitetet e programit.

Mbështetja e BE-së për Trajnimin e Mësimdhënësve dhe ngritjen e kapaciteteve të Komunave dhe Drejtorëve të Shkollave

Projekti i financuar nga BE-IPA 2009 "Trajnimi i Mësimdhënësve dhe Ngritja e Kapaciteteve të Komunave dhe Drejtorëve të Shkollave" është zbatuar nga GIZ. Projekti ka mbështetur përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të përmirësuar hartimin dhe ofrimin e trajnimit të mësimdhënësve në shërbim dhe ngritjen e kapaciteteve për drejtorët e shkollave në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte që të përmirësojë cilësinë e arsimit nëpërmjet zhvillimit të sistemit të qëndrueshëm të trajnimit të plotë të mësimdhënësve, veçanërisht trajnim gjatë shërbimit, në arsimin fillor dhe të mesëm, duke përfshirë AAP-në dhe për të ofruar trajnime themelore të menaxhimit për drejtorët e shkollave, në mënyrë që të përmirësohen kapacitetet e menaxhimit në shkollë, në nivelin lokal dhe komunal.

Programi ka dhënë propozimet për hartimin e një programi për zhvillim profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë për të përmirësuar praktikën në shkollat e zgjedhura në Kosovë. Qëllimi ishte që të ngritën kapacitetet e mësimdhënësve në nivel komunal dhe shkollore për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe mësim-nxënies, dhe ishte pjesë e projektit të Trajnimit të Mësimdhënësve dhe Ngritjes së Kapaciteteve të Komunave dhe Drejtorëve të Shkollave.

<http://www.kosovoprojects.eu/en/content/teacher-training-and-capacity-building-school-directors-kosovo>

Bërja e shkollave më të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara - Financimi i BE-së për ndërtimin e objekteve të zakonshme shkollore

Arsyet kryesore për mospërfshirje në shkollat e rregullta të fëmijëve dhe nxënësve me aftësi të kufizuara janë mungesa e objekteve shkollore dhe materialeve mësimore të qasshme, dhe mungesa e vetëdijes për promovimin e arsimit gjithpërfshirës në mesin e drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve. Projektet e financuara nga BE-ja kanë adresuar këto nevoja duke financuar ndërtimin e objekteve shkollore të zakonshme të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet e qasjes për personat me aftësi të kufizuara dhe kështu të lehtësohet qasja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë. BE-ja gjithashtu ka mbështetur përshtatjen e procesit mësimor dhe përshtatjen e pajisjeve të TIK-ut në shkollë me nxënës me nevoja të veçanta në Kosovë. Ajo promovon qasjen në shkollat e zakonshme për aftësinë e kufizuar në arsim përmes hartimit dhe zhvillimit të kurrikulës së re të qasshme dhe gjithpërfshirës, dhe moduleve të trajnimit për kualifikimet 'bërthamë'.



http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/education_for_the_future_en.pdf

Projekti i Binjakëzimit i BE-së kundër homofobisë dhe transfobisë, me kohëzgjatje dy vjeçare i udhëhequr nga Instituti austriak Ludwig Boltzmann për të drejtat e njeriut dhe i mbështetur nga Instituti Kombëtar Finlandez për Shëndetësi dhe Mirëqenie ka filluar në mars të vitit 2014. Ky projekt plotëson mbështetjen bilaterale finlandeze për OJQ-të në Kosovë për LHBT (lesbiket, homo-seksualët, biseksualët dhe trans-seksualët).

Projekti ka për qëllim trajtimin e homofobisë dhe transfobisë si një fytyrë e diskriminimit që dobëson vlerat thelbësore të çdo shoqërie: barazinë dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut. Në rrugën drejt një shoqërie gjithëpërfshirëse, është e rëndësishme që të bëhet ndryshimi i legjislacionit kundër diskriminimit, politikave që implementohen dhe të rritet vetëdija në mes të palëve të interesuara që mbajnë pushtetin për të ndryshuar shoqërinë dhe për të nxitur kohezionin social. Të gjitha aktivitetet e projektit përpunohen të forcojnë qëndrimin profesional të grupeve të interesit dhe autoriteteve përkatëse në njohjen dhe pranimin e faktit se njerëzit janë "normalisht të ndryshëm".

Aktivitetet kryesore të projektit janë këto në vijim:

- Sigurimi analizave dhe rekomandimeve për të kapërcyer mangësitë në legjislacion kundër diskriminimit dhe në struktura institucionale në lidhje me bazat e orientimit dhe identitetit seksual.
- Mbështetja e zhvillimit të një sistemi të përhershëm, neutral dhe të pavarur të monitorimit dhe vlerësimit në lidhje me respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e trajtimit të barabartë të personave LGBT.
- Ngritja e kapaciteteve për autoritetet e Kosovës : nxitja e standardeve profesionale në punën me një shoqëri të ndryshme dhe në veçanti me personat LGBT.
- Trajnime për ngritjen e vetëdijes për profesionistët për të forcuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në promovimin e anti - diskriminimit dhe trajtimit të barabartë brenda grupit të kolegëve të tyre profesional (administratë, gjyqësi, polici, arsim).
- Shkëmbimin e njohurive, përvojës dhe krijimin e një strategjie të komunikimit të përshtatur për nevojat ekzistuese në Kosovë. Përfshirja e gazetarëve dhe përfaqësuesve të medieve në kërkimin për përdorimin e gjuhës gjithëpërfshirës në mediet e Kosovës veçanërisht në lidhje me çështjet LGBT.
- Përmirësimi i qasjes për komunitetin LGBT në këshillim ligjor dhe psikologjik në partneritet me partnerët e shoqërisë civile.
- Mbështetja e punës strategjike të Grupit Këshillues dhe koordinues kombëtar për të Drejtat e komunitetit LGBT për të mbështetur një rrjet aktiv, të frytshëm, të orientuar në partneritet dhe të qëndrueshëm të qeverisë , shoqërisë civile , komunitetit ndërkombëtar dhe akterëve rajonal.

<http://bim.lbg.ac.at/en/kosovo-project-against-homophobia-and-transphobia-twinning>



Projektet dhe donatorët që mbështesin arsimimin e komuniteteve pakicë

UNICEF

UNICEF-i ka kontribuar në:

- Zhvillimin e standardeve për shkollat miqësore për fëmijë,
- Projekti "Përmirësimi i ofrimit të arsimit për romët, ashkali të dhe egjiptianët," i implementuar në Fushë Kosovë në vitin 2011 - 2012,
- Doracak për zyrtarët komunal për të përmirësuar ofrimin e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (ECMI Kosova 2012);
- Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë Anketat klaster e treguesve të shumëfishtë (MICS) e kryer në vitin 2013 - 2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.
 - Programi global MICS është zhvilluar, nga UNICEF-i në vitet 1990 si një program ndërkombëtar i anketimeve të ekonomive familjare për të mbledhur të dhëna të krahasueshme në nivel ndërkombëtar në një gamë të treguesve për gjendjen e fëmijëve dhe grave.
 - Sondazhet MICS i masin treguesit kryesorë që u lejojnë vendeve për të gjeneruar të dhëna për përdorim në politikat dhe programet, dhe për të monitoruar progresin drejt Qëllimeve Zhvillimore të Mijëvjeçarit dhe përkushtimeve të tjera ndërkombëtare.
 - MICS ofron 1) informacion të përditësuar për vlerësimin e situatës së fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian, grave dhe burrave si dhe ofron të dhëna për monitorimin e strategjive ekzistuese dhe planeve të veprimit për përfshirjen e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, 2) të dhënat për hartimin e programeve të ardhme të ndërhyrjeve dhe mbështetjen e planifikimit të bazuar në dëshmi të institucioneve të Kosovës, 3) të dhënat për të informuar aspiratat dhe planifikimin e Kosovës për në BE dhe në procesin e zgjerimit të BE-së duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë në statistika, mbledhjen e të dhënave, në sistemet e menaxhimit dhe monitorimit.

Save the Children: Promovimi i arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe fëmijët e varfër

Save the Children është fokusuar në sigurimin e qasjes dhe arsimit cilësor për grupmoshat 5 deri 14 vjet. Gjithashtu, ka promovuar arsimimin e fëmijëve të varfër të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian përmes një programi i cili ka për qëllim:

- Ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e arsimit në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe grupeve të tjera të marginalizuara, duke i mësuar komunitetet se si t'i mbështesin fëmijët e tyre dhe të bashkëpunojnë me shkolla.
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe komunitetit, duke i ndihmuar ata të bëhen të ndjeshëm dhe gjithëpërfshirës për sa i përket kulturës në qasjen e tyre dhe arritjen deri te komunitetet RAE dhe grupeve tjera të marginalizuara.
- Krijimi i mekanizmave për identifikimin e fëmijëve jashtë shkollave në bashkëpunim me OJQ-të lokale dhe organizatat e tjera partnere përmes vizitave derë më derë.
- Mbështetja e proceseve të menaxhimit të shkollave dhe ofrimi i trajnimeve për metodologji cilësore në arsimin gjithëpërfshirës.
- Klasa dhe aktivitet pasuruese, me qëllim të zvogëlimit të barrierave për të mësuar dhe për të mbështetur diversitetin, nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve, orë jashtë-kurrikulare dhe plotësuese, mbështetje nga vetë moshatarët dhe krijimit të lidhjeve të



fëmijëve në shkollë, duke i bërë bashkë fëmijët nga kultura të ndryshme përmes artit, muzikës, dramës, dhe sporteve.

- Avokimi për rritjen e alokimeve të burimeve nga ana e autoriteteve komunale për të mbështetur metodologjinë arsimore gjithëpërfshirëse, përmes Indeksit për gjithëpërfshirje.
- Avokimi dhe rritja e vetëdijes për rëndësinë e investimit në kujdesin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme (ECCD).
- Mbështetje e Qendrës për zhvillim të fëmijërisë së hershme për moshat 3-6 vjeçare në komunën e Mitrovicës për fëmijët dhe prindërit e tyre nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

<https://kosovo.savethechildren.net/what-we-do/education>

Projekti “Mozaik”

Save the Children ka zbatuar një projekt Mozaik në pesë institucione parashkollore publike në Prizren, Obiliq, Pejë, Prishtinë dhe Kamenicë. Mozaiku është një model unik dygjuhësh dhe multi-kulturor për parashkollorët. Projekti kishte dy komponente kryesore: futjen e një qasje dygjuhëshe në kopshte dhe zhvillimin e qasjes pedagogjike me fëmijën në qendër që përfshin trajnime për moshën përkatëse në aftësitë e zgjidhjes së konflikteve fëmijërore. Filozofia e Mozaik-ut është që fëmijët të mësohen në ambient multi-kulturor në moshën më të hershme të mundshme, për të mësuar tolerancën dhe respektin për diversitetin e kulturave, dhe për të ndihmuar komunitetet e ndryshme etnike që të bashkëpunojnë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin.

Gjithsej 173 fëmijë nga grupmoshat 3-5 nga komuniteti shqiptar, serb, boshnjak dhe turk ishin regjistruar në gjashtë grupe të Mozaik-ut, duke siguruar qasje në arsimin cilësor gjithëpërfshirës. 12 edukatorë ishin trajnuar në tema të veçanta për një qasje pedagogjike multi-kulturore dhe dygjuhësore. Programi i Mozaik-ut është pranuar nga MASHT-i si model i ri arsimor në Kosovë dhe MASHT-i është duke financuar zbatimin e programit në tri kopshte, në Obiliq, Pejë dhe Prishtinë.

<https://kosovo.savethechildren.net/ehat-we-do/education>

Arsimi gjithëpërfshirës për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian

Save the Children së bashku me partnerin strategjik, OJQ-në "Iniciativa 6" i mëson komunitetet si t'i mbështesin fëmijët e tyre dhe si të angazhohen me shkollat dhe kështu të rrisin numrin e nxënësve që ndjekin shkollën dhe arrijnë arsimore të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian.

Iniciativa 6

Iniciativa 6 është organizatë joqeveritare, e cila është themeluar në vitin 2003. Që nga themelimi Iniciativa 6 është angazhuar në përmirësimin e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, të drejtave të fëmijëve, shëndetësisë dhe në fushat tjera me interes për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Iniciativa 6 është organizatë me përvojë në fushën e arsimit formal dhe joformal. Ajo ka kontribuar në rritjen e numrit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në arsimin parafillor, fillor, të mesëm dhe universitar; zvogëlimin e braktisjes së shkollimit; vetëdijesimin e komuniteteve për rëndësinë e arsimit, edukimin shëndetësor, respektimin e drejtave të fëmijëve, etj. Ajo ka marrë pjesë në zhvillimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe në hartimin e Planit të veprimtimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Prizren.

<http://rae-edu.net/iniciativa-6>



Balkan Sunflowers Kosova

Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) është një organizatë ndërkombëtare, e themeluar në vitin 1999 për të ndihmuar refugjatët kosovarë. BSFK ka realizuar disa programe arsimore që synojnë integrimin e suksesshëm të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që nga viti 2003. Në mesin e këtyre programeve janë p.sh. Rrjeti i qendrave mësimore, Programi i Ndërmjetësimit në Shkolla, Programi i avokimit strategjik, Partneriteti për Pajtim përmes fëmijërisë dhe Zhvillimit të hershëm në Evropë dhe Mbështetja për Transmetimet për pakicat në Kosovë, Vetëdijësimi për Regjistrimin në Kosovë.

- 1) Projekti i rrjetit të Qendrave mësimore ka filluar në vitin 2008 me një numër të përgjithshëm prej 5 Qendrave mësimore - Fushë Kosovë, Graçanicë, Shtime, Plemetin, dhe Obiliq. Qendrat mësimore u kanë ofruar mbështetje fëmijëve të vegjël për të mësuar dhe për të pasur sukses në shkollë. Programet janë zhvilluar në gjuhën shqipe dhe serbe dhe janë ndihmuar nga personeli i trajnuar dhe vullnetarët që kryesisht ishin nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Rreth 50 të rinj, vullnetarë nga komunitetet pakicë kanë punuar 2 deri në 3 orë në ditë si tutorë për të ndihmuar fëmijët e vegjël në mësim. Rreth 500 fëmijë në ditë dhe kanë marrë pjesë në aktivitetet e Qendrave mësimore për parashkollorë, klube të gjuhës, ndihmë rreth detyrave të shtëpisë, dëfrim dhe mbështetje, dreka, materiale shkollore. Qendrat mësimore kanë shërbyer më shumë se 100 000 shujta të ngrohta për fëmijët çdo vit dhe fëmijët kanë marrë qindra libra shkollore.

Si rezultat i aktiviteve të Qendrave mësimore, regjistrimi i nxënësve nga komunitetet pakicë është rritur dhe numri i fëmijëve nga komunitetet që kanë lënë shkollën ka rënë në mënyrë dramatike. Fëmijët janë bërë më të sigurt. Ata i kryenin detyrat e shtëpisë dhe ishin më aktiv në klasë dhe në shtëpi për të treguar se çka kanë mësuar. Përveç kësaj, numri i fëmijëve të pakicave të regjistruar në institucionet parashkollore është rritur si pasojë e faktit se prindërit e kishin kuptuar më mirë vlerën e arsimit parashkollor.

Në këtë proces, kanë përfituar edhe të rinjtë që punonin si vullnetarë. Ata kanë pasur më shumë vetë-respekt, ndjenjë të fuqishme të përkatësisë, kanë vërejtur se ata mund të arrijnë diçka dhe kanë ndjerë kënaqësi në zhvillimin e fëmijëve më të vegjël pjesë e të cilëve ishin edhe ata. Ata morën libra shkollore dhe materiale, një pagë të vogël, disa aktivitete zbavitëse, dhe një sasi të trajnimit. Ata gjithashtu e kishin përmirësuar suksesin në shkollë dhe ishin më të motivuar. Këta të rinj janë model për fëmijët, shokët e tyre, dhe komunitetin. 6 prej tyre janë duke studiuar në universitet.

- 2) Programi i Ndërmjetësuesve të Shkollave, është themeluar në vitin 2010 i mbështetur nga OSBE-ja, Njerëzit në nevojë / Agjencia Çeke e Zhvillimit, Ambasada Holandeze dhe Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë. Projekti synonte në rritjen e qasjes në arsim për fëmijët nga komunitetet e pafavorizuara, veçanërisht nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke inkurajuar regjistrimin e tyre në shkolla dhe parandalimin e braktisjes së shkollës.

Programi ka mbështetur punën e 15 ndërmjetësuesve të shkollave në dhjetë komuna dhe 35 shkolla në Kosovë. Ndërmjetësit janë trajnuar nga ekspertët e arsimit dhe meqë ata i përkasin komuniteteve ku ata punojnë, ata kanë qasje më të lehtë në familje se sa çdo punëtor tjetër social. Detyrat kryesore të ndërmjetësuesve janë: regjistrimi i fëmijëve në shkollë, parandalimi i ndërprerjes së shkollimit, individualizimi i problemeve me të cilat nxënësit mund të përballen në lidhje me shkollimin e tyre dhe vendosja e veprimeve korigjuese dhe ndërmjetësimet mes familjeve, shkollave dhe administratave komunale.

BSFK në bashkëpunim me OSBE ka publikuar një Doracak trajnimi për ndërmjetësim në Shkollat e Kosovës, i cili ka për qëllim normalizimin e figurës së ndërm-



jetësuesit të shkollës në kontekstin e Kosovës.

- 3) Programi i Avokimit të Strategjisë synon rritjen e vetëdijesimit dhe kapacitetit të zyrtarëve komunal për zbatimin e "Strategjisë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian" në 9 komuna. Programi i Avokimit të Strategjisë është miratuar në vitin 2008 nga Qeveria e Kosovës dhe është mbështetur me Planin e veprimit. Projekti synon gjithashtu të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet OJQ-ve, organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të tjera që punojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që të fuqizojnë qytetarët dhe shoqërinë civile për të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e politik-bërjes dhe vendimmarrjes lidhur me strategjinë në nivel lokal.

<http://www.balkansunflowers.org/>

The Ideas Partnership

The Ideas Partnership, i themeluar në vitin 2009, ka ofruar mbështetje për fëmijët dhe familjet e komuniteteve pakicë në Fushë Kosovë. Në vitin 2012, me mbështetjen e këtij projekti, 120 fëmijë nga Fushë Kosova janë regjistruar në shkollë, të cilët përndryshe nuk do të ishin regjistruar, dhe u ka ndihmuar shumicës së nxënësve për të qëndruar në shkollë. Aktivitetet e projekteve të Ideas Partnership përfshijnë:

- Mësimin plotësues për fëmijë dhe përgatitjen e tyre për të filluar shkollën;
- Rekrutimin e avokatit të komunitetit nga rrethina për të vepruar si urë ndërmjet familjeve dhe shkollave, për t'i forcuar marrëdhëniet e tyre; dhe për të mbështetur fëmijët në ndjekjen e shkollës dhe qëndrimin në të;
- Punëtorët vullnetarë nga komuniteti;
- Mësimin të shtunave pasdite për fëmijë për t'u dhënë atyre aftësi, pak argëtim dhe ushqim të lehtë e të shëndetshëm, dhe për t'i larguar ata nga rruga për një apo dy orë;
- Mbledhjen dhe shpërndarjen e rrobave dhe këpucëve në bazë të nevojave;
- Seanca arti dhe vallëzimi për fëmijë;
- Mësime për ata që nuk mund të shkojnë në shkollë.

<http://theideaspartnership.org/>

Mbështetja e BE-së/ Këshillit të Evropës për arsimimin e fëmijëve nga komunitetet pakicë

"Regjistrimi i fëmijëve të komunitetit RAE në arsimin fillor në Kosovë", mbështetur nga BE-ja, nisi në vitin 2010. Projekti synonte të rrisë vetëdijen në mesin e komuniteteve RAE për rëndësinë e arsimit dhe rritjen e shkollës së regjistrimit të fëmijëve RAE.

Inter-kulturalizmi dhe Procesi i Bolonjës

Projekti i BE-së/KE-së për "Interkulturalizmin dhe Procesin e Bolonjës", është realizuar ndërmjet viteve 2008 dhe 2011, me mbështetjen e Këshillit të Evropës, dhe në bashkëpunim me MASHT-in dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti ishte krijimi i kushteve të qëndrueshme për forcimin e mirëkuptimit ndërkulturor në mes të të gjitha komuniteteve në Kosovë bazuar në të drejtat e njeriut dhe edukimin ndërkulturor në perspektivën e të mësuarit gjatë gjithë jetës në pajtim me standardet apo praktikën më të mira evropiane. Qëllimi i projektit ishte që të mbështeteshin reformat në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Kosovë që ndihmojnë në vetëdijesimin dhe mirëkuptimin ndërkulturor, duke pasur parasysh standardet dhe praktikën më të mira evropiane dhe për të lehtësuar më tej integrimin *de facto* të Kosovës në Procesin e Bolonjës.



Ky projekt ka përkrahur shtatë fushat kryesore të punës së Këshillit të Evropës në fushën e arsimit: legjislacionin, edukimin për qytetari demokratike, trajnimin e mësimeve, mësimin e kulturës romë, mësimin e historisë, politikën e gjuhës dhe arsimin e lartë. Projekti u përqendrua në:

- Ngritjen e kapaciteteve (trajnimi i autoriteteve relevante përgjegjëse për proceset e reformave arsimore, p.sh. përpilimin e kurrikulës për histori, arsimin për qytetari demokratike, gjuhë etj.
- Trajnimin e mësimeve (trajnimi i trajnerëve të mësimeve për të ofruar trajnime "kaskadë" p.sh. mësimeve e multi-kulturalizmit përmes historisë dhe edukatës qytetare dhe të drejtave të njeriut,
- Standardet dhe elementet e praktikave më të mira evropiane (Korniza Evropiane e Referencës për Mësimin e Gjuhës, rekomandimi i Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në shekullin e 21, dokumentet e procesit të Bolonjës, etj.

<http://ibp-kosovo.org/?cid=2,2>

Projekti "Iniciativa Rajonale për Arsimin Gjithëpërfshirës", implementuar nga Këshilli i Evropës në shtatë vende të Ballkanit, filloi në vjeshtë të vitit 2012. Në Kosovë, projekti është zbatuar në 7 shkolla (3 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, 2 të mesme të larta dhe 2 AAP). Programi trevjeçar është përqendruar në rritjen e kohezionit social në rajon përmes promovimit të arsimit gjithëpërfshirës dhe trajnimit. Ai ka synuar të promovojë konceptin e arsimit gjithëpërfshirës, si dhe politika dhe praktika relevante në sistemin formal të arsimit në nivelin parauniversitar në Ballkanin Perëndimor përmes rritjes së vetëdijesimit, të mësuarit reciprok dhe masave për ngritjen e kapaciteteve.

Projektet pilot që janë duke u zbatuar në rajon formojnë bazën për aktivitetet e kampanjave vetëdijesuese dhe aktivitetet rrjetëzuese. Çështja kryesore është se si të lëvizet nga pilotimi në reforma të përgjithshme dhe programi do të propozojë mekanizma efikas për të siguruar këtë.

http://www.coe.int/t/democracy/migration/jp-eu-education_en.asp

Projekti Rritja e qasjes në arsim dhe e mirëkuptimit ndër-kulturor: Mbështetje e BE-së / KE-së në fushën e arsimit për të kthyerit me forcë dhe për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (ACCESS), ka filluar në korrik të vitit 2013 dhe është implementuar deri në fund të vitit 2015. Objektivi i projektit ishte që të sigurojë kohezion më të lartë shoqëror dhe besim ndërmjet komuniteteve dhe promovim të zhvillimit socio-ekonomik për të kthyerit në situatë të pafavorshme dhe komuniteteve RAE, duke mbështetur masa aktive për integrimin dhe përfshirjen e komuniteteve RAE në arsimin e Kosovës.

Rezultatet e pritshme të projektit ishin, si në vijim:

1. Regjistrimi dhe vijimi i rregullt i shkollimit të fëmijëve të kthyer me moshë shkollore dhe të fëmijëve të pakicave në situatë të pafavorshme në përgjithësi, me vëmendje të veçantë ndaj romëve, ashkalive dhe egjiptianëve;
2. Rritja e kapaciteteve të sistemit arsimor për të siguruar mundësi më të mëdha për arritje shkollore të fëmijëve të kthyer dhe të fëmijëve të komunitetit RAE;
3. Përmirësimi i statusit të gjuhës romë si lëndë në shkollat e Kosovës;
4. Integrimi i fëmijëve të kthyer në mesin e shokëve në shkollë dhe në komunitetin lokal;
5. Shqyrtimi i politikave dhe përmirësimi i politikave arsimore për romët, ashkalitë dhe egjiptianët, dhe për të kthyerit me forcë.

Arritjet deri në muajin qershor të vitit 2015 kanë qenë si në vijim:

- Zhvillimi i metodologjisë së trajnimit brenda "Programit të përfshirjes sociale" dhe zbatimi në 11 shkolla pilot.



- 6 Trajnerë në Institutin Pedagogjik të Kosovës të trajnuar.
- 66 mësimdhënës të trajnuar.
- 11 shkolla kanë marrë grande për të zhvilluar plane zhvillimore shkollore.
- Përpilimi i materialeve pedagogjike për "orë shtesë për të kthyerit". Mësimdhënës të trajnuar dhe Trajnimi i trajnerëve në përgatitje.
- Zhvillimi i modulit të trajnimit të mësuesve për klasat në gjuhën rome.
- Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit për stafin e Qendrave Mësimore (QM).
 - Gjashtë muaj trajnim në shkathtësi për ndërmjetësim dhe 4 muaj trajnim për përfshirje sociale.
- Dy studime të realizuara në Programin e ndërmjetësimit (botuar në shkurt 2015) dhe për ndikimin e qendrave mësimore (publikuar në shtator 2015).
- Takime koordinuese me OJQ-të që drejtojnë qendrat mësimore dhe krijimi i një grupi punues MASHT- OJQ për hartimin e udhëzimeve administrative për rolin e qendrave mësimore.

Mbështetje tjetër e ofruar nga BE-ja: BE-ja ka dhënë 1 milion € për zbatimin e Strategjisë për RAE në Kosovë e cila e mbështetë krijimin e 6 qendrave mësimore për fëmijët e komunitetit RAE dhe bursa për nxënësit e komunitetit RAE për arsimin e mesëm dhe të lartë.

(http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/education_for_the_future_en.pdf)

Projektet që mbështesin gjithëpërfshirjen në arsimin dhe aftësimin profesional SIVET – Gjithpërfshirja sociale në Arsimin dhe aftësimin profesional

Projekti SIVET i financuar nga Ministria Federale Austriake për Arsim dhe Çështje të Grave i implementuar nga KulturKontakt Austria, e ka mbështetur MASHT-in për të zbatuar përfshirjen sociale në AAP dhe për të mbështetur një qasje të barabartë në arsimin dhe aftësimin profesional për të gjithë. Projekti u zbatua në pesë pilotë shkolla - urbane dhe rurale - në dy faza gjatë vitit 2011 - 2013.

Projekti synonte krijimin e parakushteve për një mjedis shkollor dhe një klimë shkollore miqësore dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët. Komponentët e projektit ishin 1) Trajnimi i mësimdhënësve, 2) Krijimi i një klime të shkollës gjithëpërfshirëse; dhe 3) Pajisja e klasave model për të lehtësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien gjithëpërfshirëse. Rezultatet e projektit kanë qenë si më poshtë:

1. Akreditimin e programeve të trajnimit të mësimdhënësve nga MASHT-i dhe njohjen e trajnimeve SIVET si arsimim i mëtejshëm i nevojshëm për përtëritjen e licencës së mësimdhënësit.
2. 25 mësimdhënës (të gjuhës shqipe dhe angleze, dhe të matematikës) të trajnuar në mësimdhënie gjithëpërfshirës dhe metodologjitë e të mësuarit. Kënaqësi e lartë e përgjithshme e menaxhmentit të shkollës, mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve me rezultatet e përdorimit të metodologjive SIVET në klasë: rezultate më të mira në mësim, vijim më i mirë, nxënës më të motivuar në mësim dhe më shumë kohë për mësimdhënësit për të ndarë për nxënësit me ndonjë lloj vështirësie në të nxënë.
3. Rregullorja e shkollës për gjithëpërfshirje nga secila prej pesë shkollave pilote e përgatitur dhe miratuar.
4. Materiale të tilla si fletëpalosje dhe postera për promovimin e gjithëpërfshirjes nga secila shkollë të përgatitura;
5. Pajisja e klasave model të shkollave pilot për të lehtësuar zbatimin e metodave gjithëpërfshirëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies;



6. Shpërndarja e njohurive tek mësimdhënësit e tjerë në shkollat e tyre dhe shpërndarja e planifikuar për shkollat e tjera të AAP-së në Kosovë.
7. Rekomandime për të nxitur arsimin gjithëpërfshirës në AAP janë përgatitur;
8. Rekomandime për hartimin e Udhëzimit Administrativ për arsimin gjithëpërfshirës në AAP janë përgatitur.

ALLED – Harmonizimi i arsimimit me nevojat e tregut të punës

Projekti ALLED (Shkurt 2015 – Shtator 2017) i financuar nga Bashkëpunimi për Zhvillim i BE-së dhe ai Austriak e forcon cilësinë dhe rëndësinë e programeve të arsimit dhe lidhjen midis arsimit dhe tregut të punës, si një parakusht për punësim dhe zhvillim ekonomik. Ai kërkon për të avancuar bashkëpunimin dhe dialogun në mes të institucioneve arsimore dhe partnerëve social. Ai fokusohet në harmonizimin e arsimit me nevojat e tregut të punës në tre sektorë: bujqësi , makineri dhe përpunim të ushqimit.

Tri rezultatet kryesore të synuara dhe aktivitetet e tyre janë si në vijim:

1. Forcimi i lidhjes në mes të Arsimit të lartë (AL) dhe tregut të punës përmes zhvillimit, modernizimit dhe reformimit cilësor të programeve të Arsimit të lartë për të përmbushur nevojat e tregut të punës;
 - a. Vlerësimi i nevojave të tregut të punës dhe analiza se si të adaptohen programet e AL-së dhe AAP-së sipas tregut të punës;
 - b. Modernizimi i dy programeve të arsimit të lartë nga sektorët me prioritet, në bazë të nevojave të tregut të punës;
 - c. Përgatitja e programit për trajnimin e mësimdhënësve për mësimdhënësit për AAP;
 - d. Përmirësimi i orientimit të tregut të punës në plotësimin me diploma;
 - e. Zhvillimi i kapaciteteve në fushën e trajnimit të mësimdhënësve para shërbimit.
2. Përkujdesja që Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) të zbatohet me kualifikime të validuara që ofrohen me sukses nga institucionet e akredituara në nivelet 2-5 të kornizës:
 - a. Zhvillimi i profileve të sektorit që tregon kërkesën për kualifikime në nivele të ndryshme;
 - b. Zhvillimi i kapaciteteve lokale për zhvilluesit e standardeve profesionale , zhvilluesit e kualifikimeve dhe mësimdhënësve që i kthejnë ato në kurrikula;
 - c. Zhvillimi i kapaciteteve lokale për sigurimin e cilësisë dhe të proceseve të validimit, rishikimit dhe vlerësimit të standardeve dhe kualifikimeve profesionale;
 - d. Zhvillimi dhe pilotimin i programeve përkatëse të tregut të punës në institucionet e AAP-së (shkollat dhe qendrat e trajnimit për të rritur), përfshirë kualifikimet për personat me nevoja të veçanta arsimore , në veçanti ata me vështirësi në të nxënë;
 - e. Vlerësimi i efektivitetit të funksionimit të marrëveshjeve të sigurimit të cilësisë për kualifikimet e AAP-së.
 - f.
3. Përmirësimi i cilësisë së praktikës dhe mësimdhënies dhe mësimnxënies në arsimin dhe aftësimin profesional të shkollave/institucioneve në sektorët kryesor profesional që janë të rëndësishëm për nevojat e tregut të punës.
 - a. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve të lëndëve praktike të AAP-së ("trajnerët/instruktorët").
 - b. Pajisja e shkollave të përzgjedhura.
 - c. Përgatitja e materialeve të trajnimit dhe atyre mësimore për mësim me nxënësin në qendër
 - d. Trajnim praktik për përdorimin e pajisjeve të AAP-së.



Mbështetje Reformës së arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë (KSV/015)

Projekti KSV/015 (2009 – 2017) i financuar nga Qeveria e Luksemburgut e mbështet MASHT-in në pilotimin e reformës së sektorit të AAP-së në dy nga pesë Qendra të Kompetencës (QK). Projekti përqendrohet në themelimin e QK-ve për kujdesin shëndetësor në Ferizaj dhe për tregti dhe biznes në Prizren.

QK-të do të ofrojnë AAP në arsimin e mesëm, do të punojnë për së afërmi me kompanitë private në sektorët e tyre përkatës për të përgatitur mundësi mësimore “në bazë të punës” për nxënësit e AAP-së, dhe do të ofrojnë trajnime brenda institucionit dhe shërbime të mësimin gjatë tërë jetës për bizneset.

Projekti e mbështetë ndërtimin dhe pajisjet e QK-ve, si dhe përfshin edhe përgatitjen e kurrikulës me trajnim përkatës të trajnerëve dhe ndërtimin e kapaciteteve të personelit të QK-ve.



Shtojca 4

Udhëzimet administrative për arsimin special dhe gjithëpërfshirës

Nr. 24/2014 Kthimi i klasave të bashkangjitura në dhoma burimore
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/24_2014_UA_1.pdf

Nr. 26/2013 Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukativo-arsimore. (përfshinë psikologët, pedagogët etj.)
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/26_2013_UA.pdf

Nr. 18/2013 Përdorimi i planit individual arsimor
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/18_2013_UA.pdf

Nr. 22/2013 Numri maksimal i nxënësve në klasë dhe proporcioni mësimdhënës - nxënës
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/22_2013_UA.pdf

Nr. 23/2013 Qendrat burimore
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/23_2013_UA.pdf

Nr. 26/2012 Kualifikimet e personelit që punon më nxënës me nevoja të veçanta
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/UA_26_2012_neë.pdf

Nr. 12/2012 Kriteret për zgjedhjen e asistentëve dhe instruktorëve për arsimin gjithëpërfshirës dhe obligimet e tyre
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/UA_12_2012_neë.pdf

Nr. 07/2012 Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Udhezim_administrativ_07_2012_anglisht.pdf

Nr. 19/2012 Themelimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalimin e braktisjes së shkollimit dhe mos-regjistrimit në arsimin e obligueshëm
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/UA_19_2012_new.pdf

Nr. 7/2011 Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollimit dhe mos-regjistrimit në arsimin e obligueshëm
http://www.masht-gov.net/advCms/documents/07_UA.pdf



Shtojca 5

Standardet për shkollat miqësore për fëmijë

Shkollë miqësore për fëmijë është shkolla që ofron arsim cilësor për të gjithë fëmijët, duke i adresuar të gjitha çështjet, të cilat ndikojnë në mirëqenien, të drejtat dhe mje-disin miqësor gjatë të mësuarit për secilin fëmijë. Standardet për shkollat miqësore për fëmijë paraqesin një qasje gjithëpërfshirëse që i ndërlidh të gjitha aspektet e reformave në arsim dhe e cila e vë nxënësin në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen nga shkolla. Koncepti bazohet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. (Standardet për Shkollat mike për Fëmijë , 2012.)

Standardet për Shkollat miqësore për fëmijë janë zhvilluar në vitin 2012 nga Instituti Pedagogjik i Kosovës me mbështetjen e UNICEF-it dhe MASHT-it për t'i përmbushur nevojat që dolën si rezultat i ndryshimeve në fushën e kurrikulës, në përkrahje të synimit të krijimit të shkollave efektive, të shëndetshme, mbrojtëse dhe gjithëpërfshirëse, me një pjesëmarrje aktive të prindërve dhe të komunitetit.

Qëllimi i përcaktimit të standardeve për shkollat miqësore për fëmijë është:

- të sigurohet një dokument që përfshin dhe integron të gjithë komponentët dhe treguesit e cilësisë së arsimit që ndikojnë në bërjen e shkollës miqësore për fëmijë dhe
- të sigurohen kërkesa matëse specifike, të cilat e ndihmojnë shkollën dhe institucionet e arsimit të rrisin pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në jetën shkollare dhe në procesin e të mësuarit.

Standardet për shkollat mike për fëmijë funksionojnë si instrument për vetë-vlerësimin e performancës së shkollës. Bazuar në standarde, shkollat kohë pas kohe, bëjnë analiza të detajuara të përparësive që duhet të mbahen dhe të forcohen më tej dhe aspekteve që duhet të përmirësohen në shkollë.

Standardet e ShMF-ve (Shkollave mike për fëmijë) kombinojnë parimet dhe dimensionet e shkollave miqësore për fëmijët të cilat mund të gjenden në dokumente të ndryshme të Republikës së Kosovës (p.sh. në Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, PSAK 2011 - 2016 dhe KKK) përmes gjashtë dimensioneve, të cilat nëse merren të gjitha së bashku, japin një pasqyrë të arsimit cilësor për të gjithë fëmijët, dhe shërbejnë si një kornizë veprimi për zhvillimin e shkollës miqësore për fëmijë.

Standardet për Shkollat mike për Fëmijë (ShMF) përbëhen prej gjashtë dimensioneve: (1) Arsimi gjithëpërfshirës; (2) Efektiviteti i mësimdhënies dhe mësim-nxënies; (3) Shëndeti, mjedisi dhe siguria; (4) Pjesëmarrja demokratike; (5) Barazia gjinore; (6) Diversiteti kulturor. Këto dimensionet janë përcaktuar posaçërisht për shkak të nevojave të shoqërisë. Çdo dimension përfshin 2 - 4 standarde të cilat janë deklarata të përgjithshme për të përcaktuar pritjet të cilat duhet të arrihen në arsim. Standardet janë përdorur për vlerësimin dhe vetë-vlerësimin e progresit dhe efektivitetit në shkollë.

Secili standard përmban indikatorë të cilët janë veprime, sjellje të dukshme dhe të matshme që përdoren për vlerësimin e progresit dhe arritjen e standardeve. Ata përshkruajnë çka duhet të ketë apo të bëjë shkolla në mënyrë që të arrihen standardet. Treguesit për çdo standard janë organizuar në tre komponentë: Menaxhim dhe udhëheqje, Kapaciteti shkollor dhe Kurrikula e procesit mësimor.



Standardet për Shkollat miqësore për Fëmijë janë shoqëruar me një udhëzues me instrumente të vlerësimit. Pas vlerësimit në shkollë, i cili bëhet nga një ekip i mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe anëtarëve të Këshillit drejtues të shkollës, shkolla përgatit plan-et e veprimit me standardet e përzgjedhura për të përmirësuar shkollën dhe për ta bërë më miqësore për fëmijë.

Standardet dhe Udhëzuesi u janë shpërndarë DKA-ve dhe shkollave.

http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Standards_for_child_friendly_schools.pdf



Shtojca 6

Indeksi për gjithëpërfshirje në Kosovë

Indeksi për gjithëpërfshirje është një pako materialesh të cilat drejtojnë shkollat përmes procesit të zhvillimit të shkollës gjithëpërfshirëse. Materialet ndihmojnë dhe mbështesin identifikimin e shtigjeve drejt arsimit gjithëpërfshirës duke eksploruar tre dimensione të ndërlydhura që krijojnë kulturë gjithëpërfshirëse, duke prodhuar politika gjithëpërfshirëse dhe duke zhvilluar praktikave gjithëpërfshirëse.

Indeksi mund të përdoret në shkolla 1) për miratimin e qasjes vetë-rishikuese për të analizuar kulturat, politikat, praktikat e tyre, dhe për të identifikuar pengesat për mësim dhe pjesëmarrje që mund të ndodhin brenda secilës prej këtyre fushave, 2) për të vendosur prioritetet e veta për ndryshim dhe për të vlerësuar përparimin e tyre, dhe 3) si një pjesë integrale e politikave të zhvillimit ekzistues, inkurajimin e ekzaminimit të gjerë dhe të thellë për çdo gjë që e ndërton një aktivitet të shkollës.

Indeksi bazohet në modelin social të aftësisë së kufizuar. Ai bazohet në praktikën e mirë, dhe pastaj organizon punën e Indeksit rreth një cikli të aktiviteteve që i drejton shkollat nëpër fazat e përgatitjes, hetimit, zhvillimit dhe rishikimit. Ai përmban tregues dhe udhëzime për të ndihmuar shkollat në reduktimin e barrierave për mësim dhe pjesëmarrje, ku shkollat i shqyrtojnë të gjitha aspektet e situatës së tyre në kontekstin e pengesave për mësim dhe pjesëmarrje, vendosin prioritetet vijuese për zhvillim, dhe punojnë për zbatimin e tyre në partneritet me komunitetin.

Indeksi për gjithëpërfshirje është përshtatur në kontekstin e Kosovës në vitin 2007 nga Save the Children, dhe është përfshirë në Planin Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2010-2015. Aktualisht 7 shkolla parashkollore dhe 7 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta janë duke e aplikuar Indeksën për gjithëpërfshirje.

Publikimi "Indeksi për gjithëpërfshirje - faktet dhe mendimet" paraqet:

- Procesin e zbatimit të Indeksit në institucionet parashkollore dhe në shkolla;
- Praktikën e mira të fituara nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, prej zbatimit të Indeksit;
- Ndryshimet institucionale, ndryshimet në qëndrimin dhe punën e mësimdhënësve, dhe ndryshimet në aktivitetet e shkollës, të cilat i ka shkaktuar përdorimi i Indeksit;
- Rekomandimet nga mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për zbatimin e mëtejshëm;
- Sfidat e hasura gjatë zbatimit të Indeksit; dhe
- Rekomandimet për zgjerimin e përdorimit të indeksit në sistemin arsimor në Kosovë.



Shtojca 7

Detyrat e zyrtarëve të DKA-ve për arsimin gjithëpërfshirës, mësimdhënësve, edukatorëve mbështetës dhe asistentëve të shkollave

Detyrat kryesore të zyrtarit për arsim gjithëpërfshirës në komuna

- Të zbatojë politikat e MASHT-it mbi arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Së bashku me Drejtorin e Drejtorisë Komunale të Arsimit të zhvillojë një politikë gjithëpërfshirëse për aktivitete të ndryshme që janë në harmoni me politikat e MASHT-it për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Të mbikëqyrë dhe koordinojë punën e të gjithë mësimdhënësve që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore dhe aktivitetet e tyre në fushat përkatëse;
- Të koordinojë dhe planifikojë aktivitetet e ekipit komunal për vlerësim dhe mbështetje;
- Ndihej në ritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar me fokus të veçantë në fëmijët që janë jashtë sistemit të arsimit;
- Koordinon dhe bashkëpunon me shkolla speciale/Qendrat Burimore dhe institucione të tjera në krijimin e kushteve për gjithëpërfshirjen e fëmijëve e me nevoja të veçanta arsimore në sistemin e arsimit;
- Punon në përpilimin e planeve, bazuar në politikat dhe strategjitë për monitorim dhe promovim të arsimit gjithëpërfshirës në nivel komunal;
- Koordinon punën me shkollat gjithëpërfshirëse dhe klasat e bashkangjitura që funksionojnë në kuadër të shkollave të rregullta në krijimin kushteve të përshtatshme për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Planifikon dhe koordinon trajnime profesionale për mësimdhënës në fushën e arsimit gjithëpërfshirës;
- Monitoron cilësinë e procesit të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha nivelet shkollore;
- Bashkëpunon ngushtë me Divizionin e Arsimit Special në MASHT;
- Bashkëpunon me organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, posaçërisht me organizatat e personave me aftësi të kufizuar;
- Inicion programe dhe projekte të cilat do të përmirësojnë gjendjen në arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, dhe promovon arsimin gjithëpërfshirës duke bashkëpunuar me komunat tjera, shkollat dhe OJQ-të;
- Planifikon dhe koordinon punën e identifikimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Përkujdeset për organizimin e transportit të përshtatshëm për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;

Detyrat dhe roli i mësimdhënësve mbështetës

- Vëzhgon klasat e rregullta në bashkëpunim me mësimdhënësit e klasave të nxënësve të nivelit të ulët (posaçërisht faza kalimtare nga klasa para fillore në klasën e parë dhe nga klasa e pestë në klasën e gjashtë) për të identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Mbështetë nxënësit që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësi në të nxënë në klasa të rregullta;
- Planifikon dhe organizon bashkë-mësimdhënie me mësimdhënësit që japin mësim në klasa të rregullta ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore;
- Kur ka nevojë për punë individuale me ndonjë fëmijë dhe kur vlerësohet se kjo është e domosdoshme, atëherë punon me të individualisht jashtë grupit;



- Përpilon planin individual të arsimit bashkë me mësime dhënësin e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerët të ekipet të PIA-s, dhe kur është e mundshme edhe me vetë nxënësin me nevoja të veçanta arsimore;
- Përkujdeset që plani individual i arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të rishikohet dhe vlerësohet në periudha të rregullta kohore dhe kohë pas kohe të ripunohet nëse ka nevojë;
- Këshillon dhe ndihmon mësime dhënësit e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si të menaxhohet me klasën gjithëpërfshirëse;
- Harton materiale mësimore alternative bashkë me mësime dhënësit e klasës së rregullt të cilat do të përdorën në mësime dhënënie me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- Ndhmon në vetëdijesimin e stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes;
- Ndhmon drejtorin e shkollës dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- Bashkëpunon me Qendrat Burimore për integrimin e fëmijëve me NVA nga Qendra Burimore në shkollë të rregullt, përgatit dhe mbështet procesin e integritit të fëmijës në klasë të rregullt;
- Bashkëpunon me mësime dhënësin e klasës së bashkangjitur në shkollën ku punon dhe planifikojnë së bashku mbështetjen për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore që janë në klasa të rregullta. Në bashkëpunim me mësime dhënësin e klasës së bashkëngjitur e bëjnë integrimin e nxënësve nga klasa e bashkëngjitur në klasë të rregullt të atyre fëmijëve që janë të gatshëm me integrim;
- Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësime dhënënie, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore varësisht nga nevojat specifike që paraqiten në shkollë;
- Planifikon në baza javore dhe mujore dhe i raporton drejtorit të shkollës ku punon për punën e bërë.

Detjrat dhe roli i edukatorit mbështetës (parashkollor)

- Vrojton grupet e fëmijëve të institucionit parashkollor në bashkëpunim me edukatorët e grupeve për të identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta;
- Mbështet fëmijët që kanë nevoja të veçanta sipas grup-moshave
- Planifikon dhe organizon aktivitete të përbashkëta me edukatorët e grupeve ku ka fëmijë me nevoja të veçanta;
- Kur ka nevojë për punë individuale me ndonjë fëmijë dhe kur vlerësohet se kjo është e domosdoshme, atëherë punon me të individualisht jashtë grupit;
- Përpilon planin individual të arsimit bashkë me edukatorët e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerët të ekipet të PIA-s;
- Përkujdeset që plani individual i arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta të rishikohet dhe vlerësohet në periudha të rregullta kohore dhe kohë pas kohe të ripunohet nëse ka nevojë;
- Këshillon dhe ndihmon edukatorët e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta dhe si të menaxhohet me punën me gjithë grupin;
- Harton materiale alternative bashkë me edukatorët e tjerë, të cilat do të përdorën në punën me fëmijët me nevoja të veçanta;
- Ndhmon në vetëdijesimin e stafit të Institucionit parashkollor për procesin e gjithëpërfshirjes;
- Ndhmon drejtorin e Institucionit parashkollor dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të punës, materialeve edukative dhe rreth mbështetjes së nevojshme për fëmijët me nevoja të veçanta varë-



sisht nga nevojat specifike të fëmijës;

- Planifikon në baza javore dhe mujore dhe i raporton drejtorit të Institucionit parashkollor ku punon për punën e bërë.

Detyrat e asistentëve të gjuhës së shenjave dhe instruktorëve në arsimin gjithëpërfshirës, siç parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2012:

- Të punojë në mënyrë profesionale, në bashkëpunim me kolegët dhe prindërit në planifikimin e mbështetjes për arritjen e qëllimeve të nxënësit;
- Të mbështesë mësimdhënësin në përgatitjen dhe zbatimin e kurrikulës për t'i arritur objektivat për arsim cilësor në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët;
- Të identifikojë stilet e të mësuarit të nxënësve, të përdorë teknika të ndryshme dhe të raportojë për arritjet e nxënësve tek mësimdhënësit dhe prindërit;
- Të monitorojë dhe mbajë shënime për arritjet e nxënësit;
- Të organizojë aktivitete jashtëmësimore dhe të përkujdesjes për mirëqenien e nxënësve gjatë këtyre aktiviteteve;
- Të ndihmojë në përgatitjen e materialeve didaktike.

Roli i asistentit të nxënësve:

- T'i ofrojë ndihmë teknike fëmijës me NVA, mësimdhënësit dhe klasës në tërësi sipas nevojave;
- Të ofrojë ndihmë në lexim, shkrim, ushtrime, shpjegime në përgatitjen e çantës, lëvizjes, etj.
- Të sjellë nxënësin në shkollë, t'i ndihmojë atij gjatë ecjes dhe sipas nevojës, të ndihmojë fëmijët me karroca, ose ata që nuk janë në gjendje të lëvizin vetë;
- Të shkruajë njësitë, fjalët kyçe, konceptet e reja apo veprimet në matematikë nëse /kur të jetë e nevojshme;
- Të mbështesë zbatimin e punës praktike sipas udhëzimit të mësimdhënësit dhe bazuar në nevojën e nxënësit.

Roli i asistentit të gjuhës së shenjave:

- Të mbështesë mësimdhënësin në gjuhën e shenjave;
- Të mbështesë punën individuale të nxënësve, apo grupeve të vogla në procesin e nxënies në situata të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës;
- Të mbështesë punën e mësimdhënësve;
- Të planifikojë bashkë me mësimdhënësit në përputhje me nevojat e nxënësve;
- Të ofrojë mësimdhënie të gjuhës së shenjave për nxënësit, kur kërkohet;
- Të mbështesë zhvillimin e gjuhës së shenjave për personelin;
- Të marrë pjesë në zhvillimin e materialeve mësimore për nxënësit.

Roli i instruktorëve të gjuhës së shenjave:

- T'i mësojë mësimdhënësit, nxënësit dhe edukatorët për përdorimin e gjuhës së shenjave;
- T'i mbështesë dhe mësojë mësimdhënësit dhe nxënësit për përdorimin e Brajlit.

Roli i instruktorit për mobilitet dhe shkathtësi ditore:

- T'i mësojë nxënësit e verbër për shkathtësitë e mobilitetit;
- T'i mësojë nxënësit me probleme në të parë për shkathtësitë e aktiviteteve ditore;
- T'i përgatisë nxënësit për integrim më të mirë dhe më të suksesshëm në shoqëri.

Shtojca 8

Ligjet kryesore përkatëse për ofrimin e arsimit për pakicat

<p>Ligjet e zbatueshme relevante në arsim</p>	<p>Nenet dhe veprimet që duhet të respektohen nga zyrtarët komunalë për të përmbushur obligimin ligjor</p>
<p>Kushtetuta e Republikës së Kosovës</p>	<p>Neni 124.6: Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të zbatojnë obligimet e përshkruara në Kushtetutë dhe vendimet gjyqësore. <p>Neni 5: Gjuhët zyrtare</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe. - Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin. <p>Neni 47: E drejta në arsimim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Secili fëmijë në komunën tuaj gëzon të drejtën për shkollim themelor. Secili fëmijë në komunën tuaj gëzon të drejtën për mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj <p>Nenet 59.2-59.4: Të drejtat e posaçme arsimore për pakicat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërin nga gjuhët zyrtare, sipas zgjedhjes së tyre; - Secili fëmijë në komunën tuaj të marrë arsimim publik para-fillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj.
<p>Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L-021</p>	<p>Neni 1 Qëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. <p>Neni 11: Mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në Ministri dhe Komuna</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij Ligji.

<p>Ligji Nr. 05/L -020 për Barazinë Gjinore</p>	<p>Neni 20: Ndalimi i diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë</p> <ul style="list-style-type: none">- Ndalohet diskriminimi mbi bazë gjinore në institucione arsimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë qasjen në arsimim, procesin e pranimit, qasjen në shërbime, mjete dhe përfitime si bursat, rezultatet e vlerësimit, marrjen e diplomave dhe titujve shkencor, qasjen në trajnime profesionale, ndjekjen e arsimimit, sporteve dhe fushave tjera. <p>Neni 21: Edukimi për barazinë gjinore</p> <ul style="list-style-type: none">- Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore mjetet mësimore të përdorura duhet të bazohen në barazinë gjinore dhe edukimi për barazinë gjinore duhet përfshirë në kurrikulat shkollore në të gjitha nivelet.- Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor – edukativ, hartimi i materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimi i materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektives gjinore dhe eliminimin e stereotipave negative, paragjytimeve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore.- Përfshirja e aktiviteteve edukative dhe trajnuese në programet e shkollave që synojnë sensibilizimin e të rinjve për barazinë gjinore dhe përgatitjen e tyre për qytetari demokratike.- Të ketë përfshirje të barabartë të femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimit profesional dhe joprofesional dhe këshillimit për ato profesione të cilat konsiderohen tradicionalisht vetëm për femra dhe vetëm për meshkuj.
<p>Ligji për përdorimin e gjuhëve Nr. 02/L-37</p>	<p>Nenet 19-24: Përdorimi i gjuhëve në arsim</p> <ul style="list-style-type: none">- Të sigurohet mësimdhënie përkatese në gjuhën zyrtare të zgjedhur nga personi. Në komunat ku gjuha e zgjedhur zyrtare e personit nuk përdoret nga asnjë shkollë në mësim, do të bëhen përpjekje përkatese për të siguruar mësimin e duhur në gjuhën e tyre të zgjedhur zyrtare.
<p>Ligji për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040</p>	<p>Neni 17: Kompetencat vetanake të komunave në arsim</p> <ul style="list-style-type: none">- Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; <p>Neni 4: Përgjegjësitë e komunave</p> <ul style="list-style-type: none">- Zbatojnë politikën dhe praktikën e tyre për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të tyre dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjithë komuniteteve për t'i shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore..

<p>Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-047 (I amendamentuar me Ligjin Nr. 04/L-020)</p>	<p>Neni 8: Të drejtat e komuniteteve në arsim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të mundësohet e drejta në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare. - Programet dhe tekstet shkollore të përmbajnë historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve.
<p>Ligji për arsimin parashkollor Nr. 02/L-52</p>	<p>Neni 5: Gjuha</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në vendet me popullsi të përzier, të sigurohet arsimim parashkollor në gjuhët e pakicave, në përputhje me ligjin.
<p>Ligji për arsimin paruniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032</p>	<p>Neni 40: Arsimi gjithëpërfshirës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkollat dhe institucionet e tjera mësimore duhet të respektojnë parimin e arsimit gjithëpërfshirës duke akomoduar të gjithë fëmijët, pavarësisht nga kushtet e tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera; dhe promovimin e integritit dhe kontaktit ndërmjet fëmijëve. <p>Neni. 3.5: Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësisve të tyre në kuadër të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore apo ato aftësuese do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Respektojnë dhe avancojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi; - Kultivojnë njohuritë për kulturën, historinë, dhe gjuhën e të gjitha komuniteteve. <p>Neni. 39: Nevojat e arsimit të veçantë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fëmija nuk duhet të konsiderohet se ka vështirësi në mësim vetëm për shkak se gjuha, ose forma e gjuhës, në të cilën zhvillohet mësimi nuk është e njëjtë me gjuhën, ose me formën e gjuhës, të cilën e përdor në shtëpi të tij ose sepse i takon një komuniteti të caktuar dhe në rastet e tilla komuna duhet të sigurojë që fëmijës t'i ofrohet mbështetje efektive në gjuhën e mësimdhënies.
<p>Ligji për arsim në komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068</p>	<p>Neni 4: Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Komunave në Arsim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ofrojë arsim fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve. - Bashkëpunim i mirë me komunat dhe institucionet e tjera në fushën e arsimit. <p>Neni 6: Përgjegjësitë administrative të komunave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi dhe raportimi lidhur me menaxhimin dhe vepërtaritet arsimore.



Shtojca 9

Institucionet e nivelit qendror përgjegjëse për arsimimin e minoriteteve në Kosovë

Institucionet qendrore përgjegjëse në mënyrë të drejtpërdrejt, apo të tërthortë për arsimimin e minoriteteve

Institucioni	Përgjegjësitë
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)	<ul style="list-style-type: none"> - Misionin e zhvillimit të një sistemi arsimor efikas që do të kontribuojë në rritjen e mirëqenies së shoqërisë kosovare duke ofruar një arsimim me cilësi të lartë dhe kërkim shkencor, me mundësi të barabarta për të gjithë. - Hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë kurrikulën kombëtare, standardet e mësimdhënies, kualifikimet profesionale dhe sistemet e provimeve. - Promovimin e një sistemi arsimor jo-diskriminues që siguron qasje të barabartë në arsimin cilësor për të gjithë dhe mbron grupet e cenueshme. - Disenjimin e formave efektive dhe të paanshme të administrimit arsimor dhe menaxhimit shkollor, dhe përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të arsimit në të gjitha nivelet. - Ndarjen e buxheteve të komunave për kryerjen e funksioneve të tyre për arsimin parauniversitar (Neni 28). - Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e masave nën komponentin arsimor të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009 - 2015.
Ministria për komunitete dhe Kthim (MKK)	<ul style="list-style-type: none"> - Ministria kyçe përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. - Zhvillimin dhe promovimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve për të arritur integrimin e barabartë të të gjitha komuniteteve; - Kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur dhe refugjatëve; - Përkujdesja që politikën në nivel qendror dhe komunal të përmbajnë dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë ato në fushën e arsimit, shërbimeve publike komunale dhe përdorimin e gjuhëve.
Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (ZK-QMÇGJ)	<ul style="list-style-type: none"> - Funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZK) - Shqyrton legjislacionin, politikën dhe procedurat për përputhshmëri me standardet dhe praktikën e aplikueshme të qeverisjes së mirë dhe bën rekomandime për Kryeministrin dhe ministritë . - Involvimi dhe angazhimi me komunitetet për të mbrojtur dhe adresuar qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështjet gjinore. - Rolin kyç për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015.

<p>Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - E themeluar në kuadër të Zyrës së Kryeministrit; - Zbatimin e legjislacionit dhe politikave në lidhje me komunitetet përmes monitorimit dhe koordinimit, dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre; - Dhënia e kontributit në arsimin e minoriteteve përmes shqyrtimit të legjislacionit, monitorimit dhe koordinimit të zbatimit të arsimit të pakicave dhe me mbështetje të programeve që kanë për qëllim përmirësimin e arsimit të minoriteteve, duke përfshirë programet e bursave.
<p>Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organ i mandatuar me kushtetutë që vepron në kuadër të Zyrës së Presidentit; - Përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve në Kosovë, dhe nga Qeveria, Zyrës së Presidentit dhe agjencie përkatëse; - Shqyrton politikat dhe merret me shqetësimet e komunitetit; - Raporton, të paktën, një herë në vit Presidentit të Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës; - I autorizuar për të krijuar grupe specialiste që punojnë për çështje të caktuara p.sh. arsim; - Takime mujore - Ndihmë në artikullimin e këndvështrimeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet me rëndësi të veçantë publike për ta; - Cakton një forum për koordinim dhe konsultim në mes të komuniteteve, - Ofron mekanizëm për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore; - Ofron mundësi për komunitetet për të marrë pjesë në një fazë të hershme në iniciativat legjislative dhe politike dhe për të sugjeruar iniciativa - Mundëson që komunitetet të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u kushtohen pjesëtarëve të tyre; - Jep rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare apo të ndara nga buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që synojnë komunitetet apo interesat e tyre të veçanta; - Raporton në Qeverinë e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; dhe - Punon në ngritjen e vetëdijesimit lidhur me shqetësimet e komunitetit dhe në krijimin e marrëdhënieve të mira ndërmjet komuniteteve



Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (KDIK)	<ul style="list-style-type: none">- Një organizëm politik i krijuar për të siguruar koordinimin ndërmjet sektorëve qeveritar dhe jo-qeveritar në realizimin e aktiviteteve të parapara me Planin e Veprimit,- Komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës i kryesuar nga zëvendëskryeministri,- Vepron si mbrojtës i interesave të komuniteteve në procesin legjislativ;- Përbëhet nga anëtarë të Kuvendit të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo garantuara për komunitetin serb, komunitetet tjera pakicë, dhe komunitetit shumicë.- Shqyrton legjislacionin dhe jep rekomandime të bazuara në të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe mund të propozojë ligje për të adresuar shqetësimet e komuniteteve.
Këshilli i Prindërve të Kosovës	<ul style="list-style-type: none">- I themeluar nga MASHT-i (Ligji për arsimin parauniversitar, Neni 16).- Të inkurajojnë dhe të rrisë rolin e prindërve si akterë kryesorë në promovimin e një sistemi cilësor arsimor;- Të përcjellë në MASHT mendimet e prindërve për çdo aspekt të arsimit parauniversitar; dhe- Të jetë kanali kryesor i komunikimit dhe konsultimit ndërmjet MASHT-it, institucioneve arsimore dhe/ose aftësuese dhe prindërve.
Mekanizmi i koordinimit, monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009 - 2015 dhe Planit të Veprimit	
Grupi teknik i punës për Implementimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë (PVGT)	<ul style="list-style-type: none">- Organ teknik i përbërë kryesisht nga institucionet ekzekutive, duke përfshirë ZKQM (Kryesues), ZÇK (Zëvendës Kryesues), ministritë e linjës (MKK, MASHT, etj.) dhe organizatave donatore.- Kryesisht përgjegjës për monitorim dhe koordinim: është e nevojshme për të monitoruar zbatimin e Planit të Veprimit, draft raportet që dokumentojnë progresin dhe të rekomandohen ndryshime, si dhe për të koordinuar investimet nga qeveria dhe donatorët në këtë fushë.
Komiteti Drejtues Ndër-institucional për zbatimin e Planit të Veprimit (KDNPV)	<ul style="list-style-type: none">- Organ politik i kryesuar nga zëvendësministri, i cili, përpos institucioneve ekzekutive, përbëhet nga institucionet shtetërore, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe KKK, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.- Organi kryesor përgjegjës për formulimin dhe priorizimin e politikave; merr vendime me rekomandim nga PVGT.- Përkujdeset që dokumentet e qeverisë (p.sh. programet, strategjitë dhe planet e veprimit) të marrin parasysh dhe të jenë të koordinuar me aktivitetet e përshkruara në Planin e veprimit, dhe të sigurohen që këto aktivitete të jenë të mbuluara financiarisht nga buxheti i Kosovës.

Mekanizmat dhe organet e nivelit lokal për çështje e minoriteteve

Mekanizmat dhe organet e nivelit lokal për çështje e minoriteteve	
Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)	<ul style="list-style-type: none"> - Ofrimi i arsimit parauniversitar; - Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës arsimore; - Menaxhimi dhe trajnimi i stafit arsimor.
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)	<ul style="list-style-type: none"> - Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve; - Qasje të barabartë në arsim, shëndetësi, dhe shërbime të tjera publike në nivel lokal; dhe - Krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, të zhvendosurve dhe të riatdhesuar.
Komiteti për Komunitete (KK)	<ul style="list-style-type: none"> - Komision i përhershëm i Kuvendit Komunal (KK); - Anëtarët e KK-së dhe përfaqësues nga të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë; - Shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht; - Rekomandimin e masave në Kuvendin Komunal për të siguruar zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me të drejtat dhe nevojat e komuniteteve.
Drejtoria Komunale e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit	<ul style="list-style-type: none"> - Kontrollin e buxhetit për arsimin në komunë, të ndarë si grand specifik nga buxheti qendror i Kosovës; - Shpërndarjen e granteve midis institucioneve të ndryshme arsimore.
Personi qendror komunal	<ul style="list-style-type: none"> - Raportimi në ZKQMDNj lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit në nivel lokal.
Grupet Punuese për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit Komunal	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi dhe zbatimi i planeve përkatëse komunale të veprimit; - Mbledhja e informacioneve nga drejtoritë relevante; - Ofrimi i këshillave dhe përpilimi i raporteve.
Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM)	<ul style="list-style-type: none"> - Parandalimin dhe uljen e braktisjes nga arsimi parauniversitar dhe mos-regjistrimit në shkollën fillore; - Këto ekipe duhet të krijohet në shkollë dhe në nivel komunal; - Zhvillimin e një strategjie shkollore dhe planit të punës kundër braktisjes dhe mos-regjistrimit; - Komunikimi dhe koordinimi mes shkollave, mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe faktorëve të jashtëm; dhe - Menaxhimin e rasteve konkrete të braktisjes së shkollës.
Task Forca për Parandalimin e Abuzimit dhe për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi	<ul style="list-style-type: none"> - Organ koordinues që synon parandalimin e abuzimit dhe mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi; - I përbërë nga punëtorë social, psikologë të shkollave, dhe përfaqësues të DKA-ve, Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Policisë së Kosovës.



Mekanizmat dhe akterët në nivel shkollë	
Drejtori i shkollës	<ul style="list-style-type: none">- Ofrimin e arsimit të cilësisë së lartë dhe mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit, sidomos vajzat dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë;- Krijimin e një mjedisi pozitiv dhe mbështetës të të nxënit dhe mbikëqyrjen e menaxhimit financiar të shkollës;- Menaxhimin e mësimdhënësve dhe zhvillimin e tyre profesional;- Promovimin e angazhimit aktiv të prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre dhe përkujdesja që nxënësit të gëzojnë të drejtën për arsimim.
Këshilli i shkollës	<ul style="list-style-type: none">- I përbërë kryesisht nga prindërit, mësimdhënësit dhe, në nivelin e mesëm, nxënësit.- Përfshirja në hartimin e planit zhvillimor të shkollës, emërimin e drejtorit dhe alokimin e fondeve jashtë buxhetit të komunës;- Përkujdesja për barazi për të gjithë që janë të përfshirë në shkollë, pa marrë parasysh gjininë apo komunitetin.
Këshilli i nxënësve	<ul style="list-style-type: none">- Në të gjitha shkollat e mesme me, të paktën, një përfaqësues nga çdo klasë;- Kontribut në përmirësimin e mjedisit mësimor shkollor dhe përfaqësimin e interesave të nxënësve tek drejtori i shkollës dhe këshillit të shkollës.
Mësimdhënësit	<ul style="list-style-type: none">- Kontribut në zhvillimin arsimor dhe social të të gjithë nxënësve dhe ruajtjen e standardeve të larta mësimore;- Është e nevojshme për të ndërmarrë trajnim të duhur profesional dhe zhvillim;- Përgatitjen e planeve mësimore dhe orëve, drejtimin dhe monitorimin e të nxënit dhe sjelljen e çdo nxënësi, duke promovuar interesat e nxënësve për të qenë nxënës të pavarur;- Përkujdesja për të gjithë nxënësit pa marrë parasysh gjininë e tyre, komunitetin ose aftësinë dhe bashkëpunimi me prindërit për progresin e fëmijëve të tyre.
Prindërit	<ul style="list-style-type: none">- Përkujdesen që fëmijët e tyre të ndjekin shkollën rregullisht;- Mbështetjen e edukimit të fëmijëve të tyre, duke theksuar rëndësinë e arsimit, duke ndihmuar me detyrat e shtëpisë dhe monitorimin e progresit të fëmijëve të tyre

Shoqëria civile	
Organizatat e shoqërisë civile	<ul style="list-style-type: none">- Veprojnë në nivel lokal dhe qendror;- Mbikëqyrjen e institucioneve qeveritare dhe plotësimin e mangësive në shërbimet që qeveria nuk mund t'i menaxhojë;- Avokimi për të drejtat dhe interesat e komunitetit të tyre në sistemin arsimor;- Ofrimi i shërbimeve për të mbushur boshllëqet në ofrimin e arsimit në komunë;- Ndërtimi i kapaciteteve të komunitetit të tyre për t'u angazhuar në sistemin arsimor dhe aktorëve të tjerë në komunitetin e tyre për çështjet e arsimit.



Shtojca 10

Nevojat për trajnim në arsimin gjithëpërfshirës

Meqenëse arsimi gjithëpërfshirës është parimi kryesor i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011 - 2016 dhe KKK-së, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave dhe profesionistët e arsimit në të gjitha nivelet kanë nevojë për trajnim lidhur me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe lidhur me atë se si mendohet që arsimi gjithëpërfshirës të funksionojë në Kosovë. Kështu, arsimi gjithëpërfshirës duhet të jetë i ngulitur në të gjitha trajnimet e mësimdhënësve para shërbimit dhe në shërbim me qëllim që t'u ofrojë mësimdhënësve mjete pedagogjike për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse.

Përmbajtjet si të menaxhohet një klasë gjithëpërfshirëse duhet të përfshihen në të gjitha trajnimet e mësimdhënësve para dhe në shërbim.

Trajnimet e nevojshme lidhur me arsimin gjithëpërfshirës mund të përmbajnë, me sa vijon:

1) Arsimi gjithëpërfshirës

- Çka është arsimi gjithëpërfshirës? Hapat për të ndërmarrë drejt arsimit gjithëpërfshirës.
- Deklaratat ndërkombëtare, Ligji për Arsimin Parauniversitar, PSAK, KKK dhe udhëzimet administrative.
- Çka është një shkollë gjithëpërfshirëse dhe si të krijohet ajo?
- Ndryshimet e nevojshme në shkollë.

2) Si të menaxhohet klasa gjithëpërfshirëse?

- Si të kapërcehen vështirësitë me të cilat një mësimdhënës mund të përballë në një klasë gjithëpërfshirëse
- Kërkesat për mësimdhënësit për t'i përmbushur nevojat e ndryshme në klasë
- Si të diferencohet programi mësimor?
 - Përmbajtja;
 - Strategjitë e mësimdhënies (p/sh. Bashkëpunues, mësimdhënie në grup dhe tutorim nga shokët e klasës, zgjidhja e problemit më bashkëpunim, grupim heterogjen, stilet e të mësuarit);
 - Materialet;
 - Vlerësimi.
- Rrjetet mbështetëse (ekipet komunale të vlerësimit, qendrat burimore, mësimdhënësit udhëtues, mësimdhënësit mbështetës, ekipet mbështetëse të shkollës).
- Përfshirja e prindërve dhe komunitetit

3) Përmbushja e nevojave të veçanta arsimore në klasë dhe planeve individuale arsimore (PIA).

- Nevojat e veçanta arsimore dhe si të ndihmohen nxënësit
 - Me vështirësi në lexim dhe shkrim;
 - Ne vështirësitë në matematikë;
 - Me aftësi të kufizuara; dhe
 - Nxënësit e talentuar.
- Të vërejturit e vështirësive në të nxënë
- Çka është PIA dhe si të përgatitet ai?
- Vlerësimi i nxënësve me NVA

4) Si të mbështeten nxënësit nga komunitetet pakicë (prodhimi materialeve trajnuese nga projektet e financuara nga Këshilli i Evropian)



-
- 5) Si të parandalohet braktisja e shkollës (IPK dhe UNICEF të mbështesin në planifikimin e trajnimit)?
 - 6) Edukimi për barazi gjinore (materialet e përgatitura nga USAID-i dhe projekti ACCESS).
